RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

RAPORTI VJETOR I PUNËS
I RADIOTELEVIZIONIT TË KOSOVËS
PËR VITIN 2025

Prishtinë
Mars 2026

PËRMBAJTJA

1.KORNIZA LIGJORE 4

2. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT 5

3. FUSHËVEPRIMI QË E MBULON INSTITUCIONI 6

3.1 Përshkrimi dhe përbërja e Bordit të RTK-së 6

3.2 Kompetencat e Bordit të RTK-së 6

3.3 Drejtori i Përgjithshëm 7

3.4 Drejtorët 8

3.5 Kryeredaktorët 8

3.6 Redaktorët 8

3.7 Nivelet organizative 8

3.8 Burimet njerëzore 10

4. AKTIVITETI PËR PERIUDHËN RAPORTUESE 11

4.1 RTK1, RTK2, RTK3, RTK4, RTK SAT 11

4.2 RTK1 11

4.3 RTK2 25

4.4 Programi satelitor 26

4.5 RTK3 29

4.6 RTK4 56

4.7 Radio Kosova 60

4.8 Radio Kosova 2 106

5. SHËRBIMI I ADMINISTRATËS DHE BURIMEVE NJERËZORE 144

6.SHERBIMI I FINANCAVE 153

7. MEDIET ONLINE 154

8. DEPARTAMENTI I PROKURIMIT 166

9.ZYRA LIGJORE 172

10.DEPARTAMENTI I TEKNOLOGJISË INFORMATIVE (RTK-IT) 177

11.DEPARTAMENTI PËR STRATEGJI DHE ZHVILLIM (DSZH) 181

12.DEPARTAMENTI PËR MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE DHE KOMUNIKIM ME PUBLIKUN 186

13.DEPARTAMENTI I MARKETINGUT 189

1.KORNIZA LIGJORE

Baza ligjore e cila rregullon funksionimin e RTK-së:

Ligji nr.04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës;

Statuti nr.0001/22 i Radiotelevizionit të Kosovës i datës 16.01.2022 i Ndryshuar dhe Plotësuar me: Vendimin nr.0094/22 të datës 17.05.2022, Vendimin 0006/24 të datës 12.02.2024,

Ndryshim Plotësimi i Statutit të RTK-së nr.0008/24 të datës 12.02.2024, Vendimi nr.0031/24 të datës 13.05.2024 dhe Aneks Statuti i Radiotelevizionit të Kosovës me nr.0103/24 i datës 31.10.2024; dhe Rregulloret e Brendshme të RTK-së.

Përmirësimet e bazës ligjore gjatë vitit 2024:

Statuti nr.0001/22 i Radiotelevizionit të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me: Vendimin 0006/24 të datës 12.02.2024, Ndryshim Plotësimin e Statutit të RTK-së nr.0008/24 të datës 12.02.2024, Vendimin nr.0031/24 të datës 13.05.2024 dhe Aneks Statutin e Radiotelevizionit të Kosovës me nr.0103/24 i datës 31.10.2024;

Metodologjia e përcaktimit te ndërlikueshmërisë së vendeve te Punës 1363/18 i datës 26.10.2018 i Ndryshuar me Ndryshim Plotësimin 0131/24 të datës 28.11.2024;

Rregullore për Procedurat dhe Kriteret në Përzgjedhjen e Përmbajtjeve Audiovizuele me nr.1327/18 të datës 10.10.20218 i ndryshuar me Ndryshim Plotësimin nr.0029/24 të datës 07.05.2024;

Miratimi i Statutit për Funksionimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm me nr.0009/24 i datës 12.02.2024

Miratimi i Rregullores së Festivalit të Këngës në RTK nr.0034/24 e datës 22.05.2024

Rregullore nr.0022/24 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në RTK e datës 25.04.2024 e ndryshuar me Ndryshim Plotësimin nr.0102/24 të datës 31.10.2024 dhe Ndryshim Plotësimin nr.0128/24 të datës 20.11.2024;

Miratimi i Marrëveshjes Kolektive e RTK -së nr.1998/24 e datës 09.09.2024.

Vështirësitë Ligjore:

Amendamentimi i Ligjit për RTK-në duhet të konsiderohet prioritet gjatë vitit vijues, në mënyrë që të rritet pavarësia dhe integriteti i Radiotelevizionit të Kosovës, të garantojë transparencë dhe të promovojë standardet më të larta profesionale në fushën e medias. Përfshirja e gjerë e akterëve në këtë proces, është e rëndësishme për të siguruar që ndryshimet e propozuara të reflektojnë nevojat dhe sfidat aktuale të transmetuesit publik.

Një pjese e rregullativës te brendshme duhet të plotësohen/ndryshohen dhe amandamentohen me rregullore të reja për shkak se disa prej tyre nuk janë në harmoni me ligjet aktuale të zbatueshme në Republikën e Kosovës.

2. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT



Radiotelevizioni i Kosovës është transmetues publik i Kosovës. RTK është person juridik joprofitabil, me status të institucionit të pavarur publik me rëndësi të posaçme, i cili i ofron shërbim publikut në fushën e veprimtarisë mediale, të përcaktuar me këtë ligj dhe aktet e tjera përkatëse ligjore dhe nënligjore.

Aktualisht Radiotelevizioni i Kosovës përbëhet nga: Dy (2) kanale të Radios dhe Katër (4) kanale televizive, prej të cilave kanali i dytë (RTK TV 2) është kanal televiziv në gjuhën serbe.

Kanali televiziv RTK TV1 dhe RTK TV2 janë të detyruara të ndajnë 15% të skemës së tyre programore për gjuhët e komuniteteve të tjera të Kosovës. RTK ofron edhe programe satelitore për kosovarët që jetojnë jashtë Kosovës.

Transmetuesi Publik i Kosovës ka mision informues, edukues, kulturor dhe argëtues dhe detyrohet:

- të nxisë, të kultivojë, të avancojë, të prodhojë e të bashkëprodhojë të gjitha modalitetet dhe përmbajtjet e krijimtarisë audio-vizuale, të cilat i kontribuojnë zhvillimit dhe avancimit të kulturës, artit, shkencës dhe të gjitha vlerave të tjera sublime të qytetarëve te Kosovës dhe t`i afirmojë ato vlera jashtë Kosovës;

- të sigurojë kushte dhe mundësi për arritjet maksimale në krijimtarinë audio-vizuale;

- të përgatisë dhe të emetojë programe të tilla, që përshkohen me vlera, me të arritura profesionale dhe etike e që janë në përputhje të plotë me standardet dhe kodekset etike të gazetarisë hulumtuese, objektive, të lirë dhe të pavarur;

- t`i kontribuojë avancimit të demokracisë, lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të harmonisë e koekzistencës në Kosovë dhe më gjerë;

- të kultivojë respektin ndaj dinjitetit, integritetit dhe privatësisë së individit; nderit dhe mirëqenies socio-ekonomike të tij/saj;

- të sigurojë të drejtën e përgjigjes së qytetarëve të interesuar;

- të mos transmetojë programe me intonacione, qoftë edhe diskrete dhe as dykuptimëshe, sidomos të natyrës, animit dhe karakterit propagandues politik, fetar dhe/ose etnik.

- të veprojë sipas detyrimeve të përcaktuara me ligje të veçanta.

3. FUSHËVEPRIMI QË E MBULON INSTITUCIONI

Radio Televizioni i Kosovës përbëhet nga organet drejtuese dhe të udhëheqjes: Bordi i RTK-së dhe Drejtori i Përgjithshëm.

3.1 Përshkrimi dhe përbërja e Bordit të RTK-së

Bordi i Radio Televizionit të Kosovës është organ kolegjial - drejtues i transmetuesit publik. Ky organ përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) anëtarë. Përbërja e Bordit të RTK-së pasqyron karakterin shumetnik dhe gjinor të Kosovës. Anëtarët e Bordit të RTK-së emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, në bazë të procedurave të hapura dhe transparente, të cilat janë të përcaktuara me Ligjin për RTK-në, 2012/04-L-046.

Gjate vitit 2025, perberja e Bordit të RTK-së ka qene si ne vijim:

Gjatë vitit 2025, përbërja e Bordit të RTK-së ka qenë prej katër (4) anëtarëve:

- Dardan Beqiri – Nënkryetar
- Biroll Urcan – Anëtar
- Radojica Mrdjinac – Anëtar
- Ilir Bytyçi – Anëtar

Mandatet e anëtarëve të Bordit:

- Z. Biroll Urcan është zgjedhur anëtar i Bordit të RTK-së më datë 11.05.2022, me mandat tre (3) vjeçar, i cili ka përfunduar më datë 11.05.2025.
- Z. Dardan Beqiri është zgjedhur anëtar i Bordit të RTK-së më datë 27.07.2024, me mandat tre (3) vjeçar.
- Z. Radojica Mrdjinac është zgjedhur anëtar i Bordit të RTK-së më datë 27.07.2024, me mandat katër (4) vjeçar.
- Z. Ilir Bytyçi është zgjedhur anëtar i Bordit të RTK-së më datë 12.09.2024, me mandat dy (2) vjeçar.

3.2 Kompetencat e Bordit të RTK-së

Bordi i Radio Televizionit të Kosovës (RTK) punën e vet e kryen në përputhje me dispozitat e Ligjit, Statutit të RTK-së, dhe Rregullores për Punën e Bordit. Kompetencat e Bordit të RTK-së janë të përcaktuara me Ligjit e RTK-së, konkretisht me nenin 29 janë:

• E aprovon statutin e RTK-së;

• E aprovon Rregulloren e punës së Bordit, si dhe rregulloret tjera të përcaktuara me Statut;

• Shqyrton dhe miraton programet, bazat dhe standardet programore në përputhje me politikën programore, ligjin dhe standardet ndërkombëtare të informimit publik sipas propozimit të Drejtorit të Përgjithshëm;

• Shqyrton dhe miraton projekt–programin e produksionit të RTK-së, i cili duhet të jetë në përputhje me mundësitë financiare të RTK-së; • Shqyrton dhe miraton Skemën e përgjithshme programore;

• Emëron dhe shkarkon Drejtorin e Përgjithshëm të RTK-së;

• Emëron dhe shkarkon zëvendësdrejtorët e Përgjithshëm, drejtorët e Radiove dhe Televizioneve dhe udhëheqësin e Shërbimeve të Përbashkëta me shumicë të thjeshtë votash, sipas propozimit të Drejtorit të Përgjithshëm;

• Miraton strukturën organizative dhe konceptin programor të RTK-së;

• Shqyrton dhe miraton buxhetin vjetor dhe skemën për pagat e menaxhmentit dhe të personelit tjetër dhe siguron që shpenzimet e RTK-së nuk i tejkalojnë burimet e tyre financiare. Buxheti i RTK-së është dokument publik, i cili pas shqyrtimit në Bord i adresohet themeluesit për shqyrtim dhe miratim;

• Shqyrton dhe publikon më së largu deri më 31 mars të çdo viti raportin financiar vjetor të të hyrave dhe të shpenzimeve për vitin paraprak të përgatitur nga menaxhmenti i RTK-së, i cili i nënshtrohet një auditimi të jashtëm të pavarur. Raporti në fjalë më pas i dërgohet Themeluesit për trajtim dhe veprim;

• Miraton planprogramin vjetor, sipas propozimit të Drejtorit të Përgjithshëm, në përputhshmëri me ligjin dhe standardet ndërkombëtare dhe mandatin e RTK-së siç është përcaktuar me këtë ligj;

• Miraton Kodin e Mirësjelljes për RTK-në dhe siguron zbatimin efektiv të saj;

• Mbikëqyrë paanshmërinë, objektivitetin dhe saktësinë e informacionit në programin e RTK-së;

• Miraton kriteret kryesore profesionale për punësimin e personelit, politikave dhe procedurave të vlerësimit të përmbushjes së detyrave;

• Siguron që janë ndërmarrë masat korrigjuese pas konstatimit nga ana e tij ose KPM-së se ka pasur shkelje të standardeve, rregulloreve dhe ligjeve të aplikueshme; dhe

• Vendos edhe për çështje të tjera të rëndësishme në përputhje me autorizimet dhe kompetencat që ka me ligj dhe statut.

3.3 Drejtori i Përgjithshëm

Drejtorin e Përgjithshëm të RTK-së e emëron Bordi, në bazë të ligjit dhe sipas procedurave të caktuara, të parapara me konkurs publik. Drejtori i Përgjithshëm i RTK-së emërohet dhe shkarkohet me 2/3 e votave të anëtarëve të Bordit. Mandati i tij është tre (3) vjet, me mundësi të rizgjedhjes, në bazë të konkursit, vetëm edhe për një mandat pasues.

Bordi i RTK-së e zgjedh drejtorin e kanalit televiziv në gjuhën shqipe, drejtorin e kanalit televiziv në gjuhën serbe, drejtorin e Radios dhe udhëheqësin e Shërbimeve të Përbashkëta, në bazë të kualifikimeve profesionale, pas procesit të hapur dhe transparent të punësimit dhe duke marrë në konsiderim rekomandimin e Drejtorit të Përgjithshëm të RTK-së.

3.4 Drejtorët

Drejtori i kanalit televiziv në gjuhën shqipe, drejtori i kanalit televiziv në gjuhën serbe si dhe drejtori i Radios e udhëheqin pjesën profesionale të programit të institucionit dhe harmonizojnë punën e kryeredaktorit. Drejtorët zgjidhen për tre (3) vjet, me mundësi të rizgjedhjes.

3.5 Kryeredaktorët

Secili kryeredaktor i RTK-së zgjidhet nga Drejtori i Përgjithshëm i RTK-së, në bazë të konkursit publik dhe sipas rekomandimit të drejtorit të kanalit televiziv në gjuhën shqipe, drejtorit të kanalit televiziv në gjuhën serbe si dhe drejtorit të Radios. Kryeredaktorët e RTK-së shkarkohen nga Drejtori i Përgjithshëm i RTK-së, në pajtim me procedurat e përcaktuara me Statut. Drejtori i Përgjithshëm i RTK-së i raporton Bordit në mënyrë të detajuar lidhur me procedurat dhe mënyrën e emërimit të kryeredaktorit.

3.6 Redaktorët

Me rekomandimin e kryeredaktorit, redaktorin përgjegjës dhe redaktorin e njësisë përkatëse programore e zgjedh dhe e shkarkon drejtori i kanalit televiziv në gjuhën shqipe, drejtori i kanalit televiziv në gjuhën serbe si dhe drejtori i Radios, me miratimin e Drejtorit të Përgjithshëm, në pajtim me procedurat e përcaktuara me Ligjin dhe Statutin e RTK-së.

3.7 Nivelet organizative

1	2	3	4	5
				SHERBIMET PUBLIKE
				RADIO DHE TELEVIZIONI I KOSOVES
				NJESIA PROGRAMORE
				SEKTORI
				PROGRAMI
				SHERBIMI
				REDAKSIA
				GRUPI, NJESIA
				VENDI I PUNES

NIVELI I PARË

RTK është një tërësi e vetme programore, ekonomike, teknike-teknologjike, punuese dhe organizative, e cila e kryen veprimtarinë e prodhimit dhe të emetimit të radioprogramit dhe atij televiziv me rëndësi për qytetarët e Kosovës, të përcaktuar në Ligjin për RTK-në. Drejtori i Përgjithshëm, në përputhje me ligjin, me rregullore dhe aktet e tjera, e organizon dhe udhëheq procesin e punës dhe punët e RTK-së.

NIVELI I DYTË

Njësia programore është një tërësi programore, punuese dhe funksionalisht e rrumbullakuar, në të cilën kryhen punët e ndërlidhura dhe të ndërvarura, të cilat e sigurojnë realizimin e programit dhe të funksioneve të tjera të përcaktuara me Ligjin për RTK-në.

Njësia programore është njësia redaktuese-programore e përbërë nga dy kanalet e Radios dhe katër kanalet e Televizionit, në të cilën, sipas rregullave, përfshihen fushat programore, siç janë programet dhe redaksitë.

Në sektorë janë të organizuara Shërbimet e Përbashkëta, ku hyjnë Financat, Burimet Njerëzore, Administrata dhe Zyra Ligjore.

NIVELI I TRETË

Programi është tërësia, në përbërje të njësisë punuese, e cila e siguron realizimin e programit të llojit dhe tematikës së caktuar. Programin mund ta përbëjnë disa redaksi. Në nivel të njësisë programore janë të organizuara Shërbimi Programor, Produksioni, Teknika dhe Mirëmbajtja. Në përbërjen e tyre janë sektorët apo grupet punuese.

NIVELI I KATËRT

Redaksia është një tërësi programore që siguron realizimin e emisioneve të llojit të caktuar të fushave tematike. Redaksia, në përbërjen e saj mund të ketë më shumë rubrika.

NIVELI I PESTË

Vendi i punës është niveli themelor i procesit të punës, përmbajtja e të cilit përcaktohet me tërësinë e detyrave të punës. Të gjitha vendet e punës janë të përshkruara me saktësi në Katalogun e vendeve të punës, i cili është pjesë përbërëse e Aktit mbi sistematizimin.

3.8 Burimet njerëzore

Tabela 1 – Burimet Njerëzore / Të punësuarit me kontrata të rregullta në RTK

Sektori/Shërbimi	Numri i të punësuarve më 01.01.2025	Numri i të punësuarve më 01.01.2026	Ndryshimi
Drejtoria	**89**	**85**	**-04**
- Menaxhmenti i lartë	4	4	0
- Departamenti për strategji dhe zhvillim	7	7	0
- Departamenti për marrëdhënie me jashtë dhe komunikim	6	6	0
- Marketingu	12	10	-02
- Prokurimi	9	10	+01
- TI	18	15	-03
- Mediet Online	29	29	0
- Auditori	4	4	0
RTK 1 – TV	**305**	**294**	**-11**
RTK 2 - TV	**69**	**61**	**-08**
RTK 3 - TV	**68**	**67**	**-01**
RTK 4 - TV	**8**	**8**	**0**
Radio Kosova	**122**	**116**	**-06**
Shërbimet e Përbashkëta	**51**	**49**	**-02**
TOTALI	**712**	**680**	**-32**

4. AKTIVITETI PËR PERIUDHËN RAPORTUESE

4.1 RTK1, RTK2, RTK3, RTK4, RTK SAT

Radiotelevizioni i Kosovës, përmes kanaleve në gjuhën shqipe: RTK1, RTK3 dhe RTK4,RTK SAT si dhe RTK2 në gjuhën serbe e ka përmbushur në mënyrë optimale misionin e tij si transmetues publik në të gjitha fushat e veprimtarisë. Kjo është dëshmuar në raportimin e lajmeve ditore, në edicionet qendrore, në emisionet informative, si dhe në programet e ndryshme që mbulojnë fusha të tilla si arsimi, edukimi, shkenca, politika dhe kronikat e jetës nga të gjitha komunitetet.

4.2 RTK1

Programi i RTK1 ka realizuar program të rregullt bazuar në skemën programore, me ndryshime të caktuara në varësi edhe të zhvillimeve që kanë karakterizuar vitin si dhe të transmetimeve të rëndësishme. Përveç skemës së rregullt, janë realizuar programet zgjedhore në tri palë zgjedhje: Zgjedhjet parlamentare (9 shkurt dhe 28 dhjetor) dhe zgjedhjet lokale (dy raunde votimi).
RTK ka bërë një mbulim gjithëpërfshirës dhe korrekt, të balancuar për të gjitha subjektet politike. Programi zgjedhor i RTK-së, është përcjellur me interes të madh nga audienca.
Gjatë vitit 2025, edhe pse RTK u ballafaqua me probleme financiare, bllokada e sfida të tjera, ka arritur të realizojë skemën programore dhe të përmbush misionin si transmetues publik. Disa riorganizime që janë bërë, kanë ndikuar në rritjen e efikasitetit në punë, angazhimin më të mirë të stafit dhe si rrjedhojë edhe një cilësi më të lartë. Politika editoriale e RTK-së, është unifikuar, ndërsa në mënyrë të veçantë Dhoma e Lajmeve, është angazhuar dhe përkushtuar, që RTK ta kryejë si duhet misionin e vet informativ. Sfiduese mbetet programi argëtues dhe ai edukativ e arsimor, ku duhet të ketë më tepër investim dhe vëmendje. Kemi planifikuar krijimin e formateve të reja dhe me realizimin e skenografive respektive, gjatë vitit vijues, skema duhet të rishikohet dhe të shënojmë një hap serioz përpara në ngritjen e cilësisë. Kete vit duhet ta stabilizojmë skemënm programore, por nevojitet rekrutim i stafit të nevojshëm dhe vazhdim i riorganizimit brenda RTK-së.

AKTUALITETET

Emri i emisionit	Nr i njësive	Nr i të intervistuarve	Sex/F	Sex/M
RTK Prime	100	300	55	245
Ekonomiks	35	182	32	150
Toka	30	100	82	18
Sense	35	35	8	27
RTK Green	23	55	12	43
Udhëve	19	74	15	59

AKTUALITETET

Gjatë vitit 2025, emisioni **"**RTK PRIME" ka trajtuar zhvillimet kryesore në vend, rajon dhe botë.

Duke pasur parasysh se ky ka qenë vit me shumë palë zgjedhje, janë trajtuar në mënyrë të zgjeruar procese tejet të rëndësishme për vendin, duke pasur në studio përfaqësues të të gjitha partive politike, analistë dhe personalitete të ndryshme, me qëllim që shikuesve t'u ofrohej një perspektivë shumëdimensionale.

Meqë viti 2025 u karakterizua nga kriza më e gjatë institucionale dhe u mbajtën tri palë zgjedhje, këto zhvillime dominuan skenën mediale dhe, rrjedhimisht, edhe përmbajtjen e emisionit "RTK PRIME".

Po ashtu, kemi trajtuar çështje të rendit dhe sigurisë, duke realizuar intervista me ministrat përkatës të resorëve, si dhe me analistë e ekspertë të këtyre fushave.

Forca e Sigurisë së Kosovës ka qenë temë e trajtuar në mënyrë konsistente, për shkak të zhvillimeve të rëndësishme që lidhen me sigurinë dhe armatimin.

Siguria është trajtuar edhe në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, sidomos për shkak të zhvillimeve në veri të vendit, ku disa herë janë zhvilluar aksione policore.

Gjykata Speciale ka qenë një nga temat që e kemi përcjellë vazhdimisht, duke pasur parasysh rëndësinë e madhe të proceseve që po zhvillohen atje.

Po ashtu, kemi trajtuar çështje ekonomike, të drejtësisë, kulturës, zhvillime lokale me rëndësi, si dhe sportin, i cili ka zënë një vend të veçantë në "PRIME".

Gjatë vitit 2025 janë realizuar rreth 100 emisione të "RTK PRIME", me mesatarisht tre mysafirë për emision, që nënkupton rreth 300 të ftuar të profileve të ndryshme.

Në emision kemi realizuar intervista me liderë institucionalë e partiakë, përfaqësues të institucioneve të pavarura, si dhe me ambasadorë të akreditуar në Kosovë.

Zhvillimet rajonale janë përcjellë gjithashtu me vëmendje, përmes debateve dhe intervistave, veçanërisht për ngjarjet në Maqedoninë e Veriut dhe Shqipëri, por edhe në shtete të tjera.

"EKONOMIKS"

Është realizuar me rregull dhe ka trajtuar aktualitetin ekonomik vendor, por edhe ndërkombëtar. Janë realizuar intervista, storie, mbulime të ngjarjeve të rëndësishme, etj. Gjithsejt janë bërë 35 emisione me 182 të ftuar. Emisioni ka qenë gjithpërfshirës dhe ka pasur një larmi tematikash.

"RTK TECH"

Emisioni RTK TECH edhe gjatë vitit 2025 ka vazhduar të transmetohet në Radiotelevizionin e Kosovës në terminet e rregullta javore, duke sjellë informacione, storje ekskluzive dhe tema të shumta inovative nga fusha e shkencës, teknologjisë dhe automobilizmit.

Disa prej emisioneve kanë prezantuar inovacionet dhe risitë e sjella nga kompanitë dhe startup-et kosovare në arenën vendore dhe ndërkombëtare, me qëllim të promovimit të Kosovës si destinacion i ri për investime në teknologji dhe inovacion.

Ekipi i emisionit RTK TECH, përkatësisht gazetarët Driton Beqiri dhe Poliksena Zenelaj, me ftesë të organizatorëve të eventeve më të mëdha globale, kanë përcjellë nga afër shumë konferenca dhe panaire ndërkombëtare, falë partneritetit të ekipit të emisionit me ta.

Ekipi i emisionit RTK TECH ka mbuluar ngjarjen më të madhe vjetore të teknologjisë dhe industrisë, Hannover Messe, në Hannover, ku shteti i Kosovës, nën organizimin e KIESA-s, është përfaqësuar nga dhjetëra biznese dhe startup-e në një stendë të veçantë. Gazetari i emisionit RTK TECH, Driton Beqiri, i mbështetur nga KIESA, ka mbuluar këtë ngjarje me një emision ekskluziv 30-minutësh, duke promovuar shtetin e Kosovës si organizator, si dhe të gjitha bizneset pjesëmarrëse.

Si partner medial për Kosovën, ekipi i emisionit RTK TECH, tradicionalisht, si çdo vit tjetër, edhe në vitin 2025 është ftuar në konferencën globale për media të panairit më të madh në botë për teknologji dhe industri, Hannover Messe Press Preview, e organizuar nga Deutsche Messe. Ky mbulim medial i kësaj ngjarjeje globale është mundësuar nga organizatori Deutsche Messe.

Emisioni RTK TECH edhe në vitin 2026 do të vazhdojë të informojë publikun lidhur me risitë shkencore dhe teknologjike, por edhe të promovojë sektorin e teknologjisë dhe inovacionit në Kosovë.

"TOKA"

Emisioni Toka ka trajtuar me rregull sektorin bujqësor, blegtoral, duke sjellë histori interesante, problematika me interes publik. Gjatë vitit 2025 janë realizuar 30 emisione me rreth 100 të intervistuar. Emisioni është realizuar e transmetuar me rregull, përjashto rastet kur ka pasur ndryshime në skemën programore.

"RTK GREEN"

Emisioni për ambjentin është realizuar dhe transmetuar me rregull, përjashto rastet e ndryshimeve në skemën programore për shkak të transmetimeve sportive apo programeve zgjedhore. Janë trajtuar tema me interes publi dhe ka pasur dhjetëra të ftuar nga sektorë të ndryshëm. Janë bërë 23 emisione, me 55 të ftuar dhe 23 kronika të realizuara. Rekomandimi për vitin në vijim është që të ketë më tepër terren e më pak studio.

"SENSE"

Gjate vitit 2025 jane realizuar 31 emisione, ndersa jane transmetuar 28, ku mysafirë 8 kane qene gra. Gjate disa javeve nuk kishim transmetim te Sens eper shkak te transmetimit te live te ngjarjeve sportive, si dhe ne kohen e fushatave zgjedhore.

"UDHËVE"

Gjatë viti 2025 në redaksinë hulumtuese janë transmetuar 19 episode premierë të emisionit "Udhëve". Janë trajtuar tema të ndryshme me interes publik. Në këtë emision javor kanë marrë pjesë 95 të ftuar, 59 burra dhe 17 gra dhe 19 përgjigje janë pranuar me email. Emisioni duhet të rishikohet pasi ka ngelur pa staf (vetëm një redaktor që është angazhuar në lajme).

PROGRAMET E PËRBASHKËTA

Programi i Mëngjesit "Mirëmëngjesi Kosovë" dhe Emisioni "Pasdite"

Gjatë vitit 2025, Programi i Mëngjesit "Mirëmëngjesi Kosovë" dhe Emisioni "Pasdite" kanë përfaqësuar dy formate të rëndësishme të programacionit ditor të Radio Televizionit të Kosovës, duke kontribuar në mënyrë të vazhdueshme në realizimin e misionit të transmetuesit publik.

Përmes një përmbajtjeje të gjerë informative, kulturore, sociale dhe argëtuese, këto programe kanë reflektuar zhvillimet aktuale në vend, rajon dhe më gjerë, duke trajtuar tema me interes publik dhe duke ofruar hapësirë për informim, debat dhe promovim të vlerave shoqërore e kulturore.

Me përdorimin e kronikave, reportazheve, lidhjeve të drejtpërdrejta dhe pjesëmarrjes së mysafirëve të shumtë në studio, Programi i Mëngjesit dhe Emisioni "Pasdite" kanë ruajtur standardet profesionale, editoriale dhe etike të RTK-së, duke forcuar rolin e institucionit si burim i besueshëm informacioni për publikun.

Programi i Mëngjesit

"Mirëmëngjesi Kosovë"

Përmbajtja programore dhe linjat editoriale

Gjatë vitit 2025, Programi i Mëngjesit "Mirëmëngjesi Kosovë" ka ruajtur kontinuitetin editorial dhe dinamikën programore, duke ofruar një përmbajtje të balancuar informative, kulturore, sociale dhe argëtuese. Si emisioni që hap ditën televizive në RTK, ai ka pasur për mision informimin në kohë reale, edukimin dhe shoqërimin e shikuesve me temat kryesore të aktualitetit vendor dhe ndërkombëtar.

Programi ka trajtuar tema nga fusha politike, sociale, ekonomike, kulturore dhe shëndetësore, duke i kushtuar rëndësi të veçantë informimit të saktë dhe të verifikuar, në përputhje me standardet profesionale të transmetuesit publik.

Aktualiteti vendor dhe ndërkombëtar

Përmes kronikave, lidhjeve të drejtpërdrejta dhe diskutimeve në studio, shikuesit janë mbajtur të informuar për zhvillimet më të rëndësishme në Kosovë, rajon dhe në arenën ndërkombëtare, me theks të veçantë në çështjet që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve.

Showbizi, kultura dhe arti

Programi ka pasqyruar risitë nga fusha e shoëbiznesit vendor dhe ndërkombëtar, si dhe ka promovuar aktivitetet kulturore dhe artistike, me fokus të veçantë tek artistët shqiptarë. Rubrika "Ciceroni kulturor" ka ofruar informacione të rregullta mbi ngjarjet kulturore të organizuara në vend.

Rubrikat tematike

Rubrika “Kronika e librit” ka kontribuar në promovimin e kulturës së leximit dhe botimeve në gjuhën shqipe. Informacionet mbi kushtet e motit kanë qenë pjesë e rregullt e emisionit, në bashkëpunim të vazhdueshëm me Institutin Hidrometeorologjik të Kosovës.

Kronikat, mysafirët dhe lidhjet e drejtpërdrejta

Gjatë vitit 2025 janë realizuar rreth 180 kronika me tematikë sociale, ekonomike, kulturore dhe shëndetësore. Në studio janë ftuar mbi 1000 mysafirë, ndërsa lidhjet e drejtpërdrejta nga terreni kanë qenë element i përditshëm i programit, duke rritur aktualitetin dhe dinamizmin e tij.

Edicionet speciale

Programi i Mëngjesit ka realizuar edicione speciale në kuadër të zgjedhjeve komunale dhe të përgjithshme, si dhe në data të rëndësishme shtetërore, përfshirë Ditën e Pavarësisë së Kosovës dhe Ditën e Flamurit – 28 Nëntorin.

Vlerësim dhe rekomandime

Programi vlerësohet si një nga formatet me shikueshmëri të lartë në RTK. Megjithatë, rekomandohet që gjatë vitit 2026 të trajtohet me prioritet investimi në përditësimin e skenografisë, me qëllim të ruajtjes së identitetit vizual dhe rritjes së cilësisë së prezantimit.

Emisioni “Pasdite”

Tematika dhe përmbajtja programore

Gjatë vitit 2025, emisioni “Pasdite” ka trajtuar një gamë të gjerë temash me interes publik, duke përfshirë kulturën, artin, trashëgiminë kulturore, sportin, temat sociale, familjen, raportet gjinore, të rinjtë, shëndetësinë, kinematografinë, muzikën, turizmin dhe aktualitetet nga vendi dhe bota.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar përfshirjes së mysafirëve nga diaspora dhe realizimit të lidhjeve të drejtpërdrejta nga vende të ndryshme.

Realizimi dhe treguesit kryesorë

Gjatë vitit janë realizuar gjithsej 242 emisione, me 918 të intervistuar, prej të cilëve 406 femra dhe 512 meshkuj. Në total janë trajtuar 586 tema, si në studio ashtu edhe përmes lidhjeve të drejtpërdrejta.

Kronikat dhe emisionet nga terreni

Pas shtimit të stafit gazetaresk, është rritur ndjeshëm numri i kronikave nga terreni, me transmetime pothuajse të përditshme. Përmbajtja ka përfshirë ngjarje kulturore dhe artistike, aktualitete, reportazhe

tematike, lidhje të drejtpërdrejta, si dhe rubrika të rregullta për muzikën rok ndërkombëtare dhe kinematografinë.

Mbulesat speciale dhe lidhjet ndërkombëtare

Emisioni "Pasdite" ka realizuar mbulime të shumta të festivaleve kulturore dhe artistike, përfshirë Etno Fest, PriFest, Prizren Fest, Festivalin e Këngës në RTK, si dhe festivale teatrore në Kosovë dhe rajon. Po ashtu, janë realizuar lidhje të drejtpërdrejta nga diaspora, Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi.

Ndërprerjet e transmetimit

Disa emisione nuk janë transmetuar për shkak të transmetimeve sportive, debateve zgjedhore dhe ngjarjeve shtetërore, ndërprerje këto të arsyetuara dhe në funksion të programacionit të përgjithshëm të RTK-së.

PROGRAMI KULTUROR EDUKATIV, ARSIMOR DHE DOKUMENTAR (PKADF)

Prodhimi i Redaksive ndaras gjatë vitit 2025 është si vijon:

Redaksia e dokumentarëve:

"GJURMË" , "Paradigma", "Memorie", Dokumentarë të huaj, "ARKIVI"

Nga kjo redaksi në total janë ideuar, planifikuar realizuar dhe transmetuar 95 dokumentar/emisione/reportazhe gjatë vitit 2025.

Redaksia për fëmijë dhe të rinj:

"Aventurat tona,, - 44 emisione premierë

,,Kutia magjike,, - 0 emisione premierë

"NE"- 20 emisione premierë

,,Tingujt magjik,,- 47 emisione premierë

Nga kjo redaksi në total janë ideuar, planifikuar realizuar dhe transmetuar 111 emisione premierë gjatë vitit 2025.

Redaksia e Arsimit:

" Kriter", -45 emisione premierë

"Medika" – 34 emisione premierë

" Voyage" –26 emisione premierë

Nga kjo redaksi në total janë ideuar, planifikuar realizuar dhe transmetuar 105 emisione premierë gjatë vitit 2025.

Redaksia e Kulturës:

"ArtTema" – 51 emisione premierë

"Autokton" – 16 emisione premierë

"Qyteti i librave"- 32 emisione premierë

Nga kjo redaksi në total janë ideuar, planifikuar realizuar dhe transmetuar 99 emisione premierë gjatë vitit 2025.

Në total nga Redaksitë e PKADF-së gjatë vitit 2025 janë realizuar e transmetuar 410 përmbajtje televizive premierë.

Puna në njësinë programore PKADF në 2025

Programi Kulturor, Edukativ, Arsimor dhe i Dokumentarëve në kuadër të RTK 1, gjatë vitit 2025 ka realizuar pothuajse të gjitha objektivat.

Pavarësisht mungesës së vazhdueshme të stafit profesional dhe presioneve të konsiderueshme, redaksia ka arritur të mbajë funksionalitetin bazë të saj dhe të realizojë programin e planifikuar. Megjithatë, ky funksionim është arritur në kushte jo të përshtatshme pune.

Mungesa e kushteve elementare teknike, përfshirë ditët e mjaftueshme për xhirim dhe montazhë, ka ndikuar drejtpërdrejt në punën e redaksive. Edhe në këto rrethana, objektivat janë përmbushur, dhe e gjithë kjo falë angazhimit dhe përkushtimit të stafit ekzistues.

Shumica e emisioneve vazhdojnë të realizohen sipas modelit një ditë xhirim dhe një ditë montazh, një praktikë kjo që nuk përputhet me standardet profesionale të prodhimit televiziv dhe kufizon ndjeshëm mundësinë për përgatitje cilësore.

Përveç në Redaksinë për Fëmijë ku reprizat janë diktuar nga mungesa e stafit, në Redaksitë e tjera reprizat janë derivate I ndryshimeve në skemën programore të shkaktuara nga procese zgjedhore, transmetim I ngjarjeve sportive dhe në jo shuë raste edhe transmetime nga ngjarje të caktuara.

Pavarësisht, gjatë vitit 2025, Redaksitë e PKADF-së kanë punuar me kapacitet të plotë duke sjellë premiera thuajse në të gjitha terminet dhe duke ngritur cilësinë programore të përmbajtjeve televizive që realizohen nga Redaksitë.

Në kuadër të Redaksisë së dokumentarëve si rezultat i marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit janë siguruar dhe transmetuar edhe dokumentar të huaj me të drejta të plota të transmetimit dhe pa asnjë kosto financiare. Numri I dokumentarëve të huaj të transmetuar është 29.

VËSHTIRËSITË

Duke pasur parasysh që dokumentari si zhanër i gazetarisë është më specific, Redaksia e Dokumentarëve punon në kushte minimale pune. Problemet me mungesën e termineve sidomos të montazhit janë pjesë e vazhdueshme e problemeve që përcjellin punën e kësaj redaksie.

Xhirues të pa trajnuar mire për këtë zhaner gazetarie, është një prej vështirësive thelbësore me të cilën përballet Redaksia e Dokumentarëve. Mungesa e STEADICAM, mungesa e mikrofonave për xhirim siç janë: mikrofona(bubë), mikrofon (TOP) ose i njohur si (BOOM), si dhe mungesa e Mikromanit, padyshim se ndikojnë në cilësinë e produktit final.

Mungesa e termineve të montazhit si dhe ndrrimi i montazherëve gjatë realizimit të një teme, janë një problem shumë I madh dhe e vështirson punën e gazetarëve gjatë realizimit të dokumentarëve.

Redaksia për Fëmijë dhe të Rinj

Gjatë vitit 2025, përkundër mungesës së stafit profesional kjo Redaksi mbulon 7 ditë të javës me emisione. Vetëm gjatë vikendit transmetohen 6 emisione javore për fëmijë dhe të rinj, ndërsa gjatë ditëve tjera keto emisione premierë i kanë hapësirat e reprizës. Gjatë vitit 2025 nga kjo redaksi janë realizuar dhe transmetuar 111 emisione.

1.,,Aventurat tona,, është emision javor i rregullt në skemën programore të RTK-së, transmetohet çdo të shtunë në orën 10:00. Realizohet nga gazetarja Anisa Ismajli. Gjatë muajit realizohen 4 emisione premierë. Emisioni është i konceptuar të përfshijë tema që i dedikohen grup moshës nga parashkollorë deri në moshën 10 vjeçare. Emisionet realizohen me përkushtim dhe kujdes çdo herë duke pasur parasysh misionin edukativ dhe argëtues për fëmijët e moshave të vogla. Sa i përket sasisë dhe cilësisë, ky emision përmbush objektivat e Redaksisë për femijë dhe të rinj. Gjatë vitit 2025 janë realizuar 47 premiera.

2. ,,Kutia magjike,, është emission javor I rregullt në skemën programore të RTK-së, transmetohet çdo të dielë në orën 10:00. Emisioni është I konceptuar të përfshijë tema që I dedikohen grup moshës së fëmijëve të ciklit të ultë të lartë, respektivisht nga mosha 11 deri në moshën 14 vjeçare. Emisioni është I konceptuar të përfshijë tema kryesisht arsimore duke përfshirë të arriturat e nxënësve nga shkollat dhe procesi mësimor. Gjatë vitit 2025 termini I emisionit është mbuluar me repriza pasi pas pushimit të lehonisë gazetarja Vlora Çitaku ka marrë vendim për shkëputje të kontratës së punës me RTK-në.

3. ,, NE,, është emission javor I prodhuar nga Redaksia për Fëmijë dhe të Rinj, nga asistent Redaktorja Albana Haxhimustafa Murseli. Emisioni është I përjavëshëm me termin të transmetimit çdo të shtunë në orën 18:30. Emisioni është I konceptuar të përfshijë tema që kanë të bëjnë me të rinjët, gjithmonë duke pasur parasysh misionin edukativ. Gjatë vitit 2025 janë realizuar 20. Në dhjetor të vitit 2025 asistent Redaktorja Haxhimustafa ka aderuar në një subject politik duke u bërë pjesë e garës për zgjedhjet parlamentare ndaj emisioni nuk është realizuar për mungesë të stafit. Gjatë 4 muajve të parë të vitit termini I emisionit është mbuluar me materiale nga arkiva deri në rikthimin në pozitën e saj të gazetares Albana Haxhimustafa.

4. ,,Tingujt magjik,, është emision muzikor, që kryesisht përmban Festivalet e këngës për fëmijë nga Komunat e ndryshme, dhe poashtu në kuadër të këtij emisioni përfshihen edhe prodhimet e RTK-së siç janë emisionet festive të Vitit të Ri dhe emisionet e realizuara me rastin e festave si Dita e Pavarësisë së Kosovës, 28 Nëntori etj. Emisioni ,,Tingujt magjik,, transmetohet 8 herë në muaj, kryesisht mbulohet me material premierë. Emisioni " Tingujt Magjik" nuk ka gazetarë dhe realizohet nga Redaktorja e Redaksisë dhe Producenti Fatos Malsori. Sa i përket sasisë, pra 8 emisione (e shtunë dhe e dielë ora e transmetimit 11:10) përmbushë objektivat e Redaksisë ndërsa sa I përket cilësisë, emisioni ka problem në realizim pasi xhirimi me kamera

tereni paraqet problem sa i përket arritjes së objektivit të cilësisë minimale. Janë realizuar gjatë kësaj periudhe 44 emisione.

Në përgjithësi përkundër kushteve, Redaksia ka përmbushur objektivat e punës. Kjo është arritur vetë falë angazhimit të stafit në Redaksi. Në total kjo redaksi gjatë vitit 2025 ka realizuar dhe trasnmetuar 111 emisione premierë.

Në vazhdën e kërkesave të përsëritura dhe të dokumentuara drejtuar menaxhmentit për sigurimin e stafit profesional në Redaksinë e Fëmijëve, mungesa e reagimit konkret ndaj kësaj çështjeje tashmë ka marrë përmasa alarmante dhe po e dëmton drejtpërdrejt funksionimin normal të redaksisë.

Pas dorëheqjes së fundit nga puna të gazetares Vlora Çitaku, e cila ishte e angazhuar në realizimin e emisionit "Kutia Magjike", Redaksia e Fëmijëve aktualisht funksionon vetëm me dy të angazhuar: gazetaren Anisa Ismaili, e cila realizon emisionin "Aventurat tona", dhe asistent redaktoren Albana Haxhimustafa, e angazhuar në realizimin e emisionit "NE". Ky kapacitet minimal njerëzor është krejtësisht i pamjaftueshëm për përmbushjen e obligimeve programore që ka kjo redaksi.

Redaksia për fëmijë dhe të rinj ka obligim të mbulojë pesë termine të rregullta javore, të miratuara në skemën programore të RTK-së. Këto termine nuk janë thjesht hapësira transmetimi, por kërkojnë përgatitje editoriale, realizim profesional, mbulim të vazhdueshëm dhe respektim të standardeve të programit për fëmijë. Në rrethanat aktuale, kjo barrë pune po bie mbi një staf tejet të reduktuar, duke krijuar mbingarkesë serioze, rrezik për cilësinë e përmbajtjes dhe pamundësi reale për zhvillim të mëtejmë programor.

REKOMANDIME

Angazhimi I stafit professional, të paktën 4 deri në 5 gazetarë, për realizimin e emisioneve ekzistuese dhe jetësimin e të paktën dy ideve për emisione të reja, një për grup moshat e vogla dhe një për adoleshentë dhe vazhdimin e realizimit të emisioneve aktuale në skemën programore.

Rritja e numrit të termineve të xhirimit dhe montazhës.

Gjatë vitit 2025 nga Redaksia për Fëmijë dhe të Rinj janë ideuar e propozuar project ide për emisione të reja për të pasuruar programin për fëmijë, por nuk është shprehur gatishmëri e menaxhmentit për angazhim të stafit për realizimin e emisioneve të reja.

Në mënyrë të shpejtë të intervenohet për të ngritur seriozitetin e qasjes se produksionit përballë kësaj Redaksie, sepse RTK obligohet me ligj për ofrimin e përmbajtjes programore cilësore për fëmijë dhe të rinj.

Redaksia e Arsimit

Emisioni arsimor KRITER realizohet nga gazetarja Valbona Tahiri, transmetohet çdo të shtunë nga ora 16:00 në RTK 1. Është realizuar me rregull, me përjashtim kur ka qenë gazetarja në pushim vjetor.

Emisioni " Medika" është emisioni tjetër i redaksisë së Arsimit i cili është realizuar nga gazetarja Vjosa Beqiri. Ky emision i dedikohet sferës së shëndetësisë realizohet në teren në mbarë teritorin e Kosovës. Gjatë muajit realizohen dhe transmetohen 4 emisione të rregullta. Emisioni transmetohet çdo të dielë në terminin 16:30. Gjatë vitit 2025 janë ideuar dhe realizuar 34 emisione.

“Voyage”

“ Voyage” është emission i rregullt që realizohet nga gazetari Korab Lecaj. Emisioni trajton tema të natyrave të ndryshme të karakterit historik, shkencor, kulturor e Arsimor. Emisioni është transmetuar cdo të dielë në orën 20 e 10 minuta. Gjatë vitit 2025 janë realizuar 26 premiera.

Njësoj si edhe redaksitë e tjera edhe Redaksia e Arsimit përballet me vështirësi dhe atë kryesisht teknike gjatë realizimit të emisioneve.

Mungesa e termineve të mjaftueshme për xhirim dhe me theks të veçantë për montazhë janë problem që përcjellin punën e përditshme të Redaksisë së Arsimit.

Duke pasur parasysh rëndësinë e kësaj redaksie për edukim audience e krijim opinioni, konsideroj se Redaksia ka nevojë për një ristrukturim, respektivisht shtim të numrit të emisioneve.

Të intervenohet me staf professional të cilët do të realizojnë emisione për shkencën në një dimension atraktiv, për sigurinë, emisione lidhur me Artin dhe Zanatin, Zoologjinë, Ambientin, etj.

REDAKSIA E KULTURËS

Redaksia e Kulturës, e cila funksionon në kuadër të PDKAF-së aktualisht realizon tri emisione të rregullta të cilat transmetohen një herë në javë: Art Tema, Qyteti I Librit, Autokton.

“ArtTema”

Në vitin 2025, janë transmetuar 51 emisione Art Tema premierë dhe asnjë reprizë. Gjatë këtij viti, në emisionin Art Tema janë realizuar 126 storie.

“Qyteti i librit”

Emisioni “Qyteti i librave” është emision i rregullt javor. Në koncept, emisioni I dedikohet ekskluzivisht librit, botimeve, leximit dhe problematikave rreth tyre. Koncepti nuk përjashton realizimin e portreteve të shkrimtarëve e albanologëve si dhe promovimin e librave të rinj që botohen nga shtëpitë tona botuese.
Emisioni në fjalë realizohet nga gazetarja Drita Miftari, e cila mban po ashtu edhe pozicionin e asistent redaktores. Emisioni transmetohet çdo të shtunë në terminin 15:15. Gjatë vitit 2025 janë realizuar 41 emisione premierë.

“Autokton”

Emisioni “Autokton” është një emision i përjavshëm i dedikuar trashëgimisë kulturore dhe elementëve që shënojnë autoktoninë e këtij vendi. Emisioni realizohet tërësisht në teren në mbarë teritorin e Kosovës dhe sjell për audiencën fakte mbi ekzistencën e pasurive të ndryshme të trashëgimisë, shumë prej tyre ta pa trajtuara në aspektin medial më herët. Emisioni realizohet nga gazetarja Rabije Kryeziu, e cila mban pozitën e reporteres televizive. Emisioni transmetohet çdo të mërkurë në termin 22:00. Janë realizuar gjatë kësaj periudhe 33 emisione premierë.

Redaksia e kulturës, përballet me vështirësi të shumta që ndikojnë realisht në mbarëvajtjen dhe cilësinë e punës. Për shkak të vështirësive të shumta, kryesisht teknike (probleme me sigurimin e kamerave dhe montazhit, cilësinë e xhirimit etj) si dhe vështirësive në gjetjen e bashkëbiseduesve, të cilët jo gjithmonë

janë në dispozicion të termineve që ofrojmë ne për xhirime, është pothuaj e pamundur që emisione të tilla si “Autokton” dhe “Qyteti i librave” mund të realizohen cilësisht brenda një jave.
Pra kushtet janë minimale në të cilat realizohet emisionet e kulturës nga ky sektor shumë specific dhe me rëndësi. Një tjetër problematikë e ngritur në kontinuitet është cilësia e emisionit Qyteti I librit.

PROGRAMI ARGËTUES, MUZIKA, SERIALE DHE FILMA (PAMS)

Programi Argëtues, Muzika, Seriale dhe Filma (PAMS) në kuadër të RTK-së ka zhvilluar aktivitetet e tij programore në përputhje me skemën vjetore, rregulloret e brendshme dhe rrethanat specifike shoqërore e politike të vitit. Aktivitetet janë realizuar përmes tri redaksive funksionale: Redaksia e Filmit dhe Serialeve, Redaksia e Argëtimit dhe Redaksia e Muzikës. Viti është karakterizuar nga ndërprerje të pjesshme të skemës programore për shkak të fushatave zgjedhore nacionale dhe lokale, si dhe nga angazhime të shtuara për programet festive dhe programin veror.

Aktivitetet programore gjatë vitit

Redaksia e Filmit dhe Serialeve

Gjatë vitit 2025, kjo redaksi ka realizuar dhe transmetuar emisionin javor “Telekino”, duke trajtuar tema të filmit vendor dhe ndërkombëtar, premierat kinematografike, festivale filmike dhe intervista me profesionistë të fushës.Janë realizuar dhjetëra njësi programore me intervista, kronika dhe analiza tematike.Është përcjellë Prifest, si dhe ngjarje të tjera të rëndësishme filmike. Është asistuar programi edhe përmes rimontimeve dhe emisioneve tematike në raste të veçanta (homazhe, ditë përkujtimore)

Në fund të vitit ka nisur edhe bashkëpunimi për serialin e ri “Baresha”.

Redaksia e Argëtimit

Redaksia e Argëtimit ka realizuar emisionin “N’ZA”, si dhe përmbajtje të tjera argëtuese dhe speciale festive.Emisioni “N’ZA” ka sjellë mysafirë nga fusha e muzikës, artit, sportit dhe jetës publike

Gjatë verës dhe fundvitit është angazhuar intensivisht në programin e verës dhe programin festiv të Vitit të Ri. Janë realizuar emisione speciale dhe “Best Of” për mbulimin e hapësirave programore

Redaksia e Muzikës

Redaksia e Muzikës ka qenë një nga shtyllat kryesore të programit gjatë vitit 2025.

Janë realizuar dhe transmetuar emisionet:

“Rock n’Bllok”

“Fjalë dhe Tinguj”

“RTK Klasik”

Janë përcjellë dhe transmetuar koncerte, festivale dhe ngjarje muzikore vendore dhe ndërkombëtare

Gjatë vitit janë përfshirë qindra artistë, instrumentistë dhe interpretues, përfshirë:

Filharmoninë e Kosovës

Operën dhe Baletin e Kosovës

Koncerte te muzikes klasike si Fihamonia e Vjenës, Parisi dhe rajoni

Programi veror "Verë në RTK" ka pasur rol të veçantë në lidhjen me diasporën

Programi i Verës dhe Diaspora

Programi veror "Verë në RTK", i transmetuar disa herë në javë, ka qenë një nga projektet më të rëndësishme të vitit. Ai ka përfshirë:

Emisione të drejtpërdrejta dhe të xhiruara

Mysafirë nga diaspora shqiptare

Reportazhe, muzikë live dhe biseda tematike

Emisionin special "E diela e mërgatës"

Programi Festiv i Fundvitit

Gjatë muajit dhjetor janë transmetuar dhjetëra programe festive të realizuara nga PAMS, përfshirë:

Programin Qendror Festiv,

Koncerte festive

Emisione speciale

Kolazhe muzikore

Këto programe kanë garantuar një mbulim të pasur dhe cilësor për festat e fundvitit.

Sfidat

Ndërprerjet e skemës për shkak të fushatave zgjedhore

Pamundësia e raportimit statistikor për muajt ku programet nuk janë transmetuar

Angazhimi paralel i stafit në disa projekte madhore

PËRMBLEDHJE STATISTIKORE VJETORE – 2025

Njësi programore të transmetuara (vjetore)

Gjatë vitit 2025, në kuadër të PAMS janë transmetuar gjithsej:

Mbi 150 njësi programore (emisione, speciale, koncerte, dokumentarë)

Mbi 121 emisione premierë (argëtim, muzikë, film)

Dhjetëra programe speciale (verë, fundvit, zgjedhje, diaspora)

Të intervistuar / pjesëmarrës në emisione

Në programet e realizuara dhe transmetuara gjatë vitit 2025 kanë marrë pjesë:

Mbi 400 të intervistuar / mysafirë

Meshkuj: rreth 60%

Femra: rreth 40%

Përveç kësaj:

Në koncerte, seriale dhe ngjarje muzikore ka pasur pjesëmarrje masive artistësh dhe interpretuesish, të cilët nuk janë evidentuar nominalisht, sipas praktikës standarde raportuese.

TABELA 1

PASQYRË E PËRGJITHSHME E AKTIVITETEVE PROGRAMORE – 2025

Programi Argëtues, Muzika, Seriale dhe Filma (PAMS)

Përshkrimi	Totali vjetor
Njësi programore të transmetuara (emisione, koncerte, speciale)	150+
Emisione premierë	60+
Programe speciale (verë, fundvit, zgjedhje)	30+
Emisione LIVE	20+
Kronika dhe storie tematike	40+

PROGRAMI ARGËTUES, MUZIKA, SERIALET DHE FILMAT (PAMS)								
REDAKTOR PËRGJEGJËS: XHYMRET VELIU								
REDAKSIA E FILMIT DHE SERIALEVE								
REDAKTORE E REDAKSISË: MIRJETA BARALIU, PRODUCENT: Bekim Qyqalla				TERMINI I EMISIONIT "TELEKINO": E shtunë (ora 22:00)				
EMISIONET	NJËSI	XHIRIM	LIVE	TË INTERVISTUAR			KRONIKA	LIDHJE LIVE

TELEKINO (J)	24	24	-	46			-	-
BARESHA (M)	3	-						

REDAKSIA ARGËTUESE

REDAKTOR I REDAKSISË: XHEVDET SFARÇA; ASISTENT REDAKTORE: SHKURTE HYSENI (pushim te lindjes) GAZETAR: ARBËR ZEKA; GAZETARE/MODERATORE: EGZONA RAFUNA; PRODUCENT: ARMEND BËRBATOVCI	TERMINI I EMISIONIT "N'ZA": E shtunë (ora 20:15)

EMISIONET	NJËSI	XHIRIM	LIVE	TË INTERVISTUAR			KRONIKA	LIDHJE LIVE
N'ZA(J)	24	24		57+				
MASTER SERVICE Chef(J)	2	2	-				-	-
Programi i verës	23	23						
Total Red. Argëtuese	49	49						

REDAKSIA E MUZIKËS

REDAKTORE E REDAKSISË: ADRIANA MORINA (autorizim) REDAKTORË: JETA ÇITAKU, HIVZI KABASHI, BASHKËPUNTORE E MUZIKËS: DAFINA SMAJLI PRODUCENTË: SHEHRIJE AVDIU, FATMIR OSMANI	TERMINËT E EMISIONIT "ROCK N'BLLOK": E diel (ora 17:50), "FJALË DHE TINGUJ": E diel (ora 22:30 – emision dyjavor) RTK KLASIK: E diel (ora 22:30 – emision dyjavor)

EMISIONET	NJËSI	XHIRIM	LIVE	TË INTERVISTUAR			KRONIKA	RITRANSMETIM
FJALË DHE TINGUJ (D-J)	12	12		47				
RTK KLASIK (D-J)	12	12		13				
ROCK N'BLLOK(J)	18	18		21				
Post Festival	3	1	2	32				

4.3 RTK2

RTK2, si kanal i RTK-së, ka për detyrë të sigurojë informim objektiv, të paanshëm dhe gjithëpërfshirës, me fokus komunitetet. Gjatë vitit 2025, programi u orientua në forcimin e programit informativ, përcjelljen profesionale të proceseve zgjedhore, rritjen e produkcionit vetanak, forcimin e dialogut dhe ruajtjen e karakterit multietnik e shumëgjuhësor.

Gjatë vitit 2025, RTK2, pavarësisht sfidave të theksuara kadrovike dhe teknike, i realizoi me sukses objektivat programore dhe e konfirmoi rolin e tij si shërbim publik i dedikuar komuniteteve në Kosovë. Programi u karakterizua nga raportimi intensiv gjatë proceseve zgjedhore, rritje e prodhimit vetanak, shënimi i 12-vjetorit të kanalit me emisione speciale dhe transmetim i vazhdueshëm i përmbajtjeve shumëgjuhësore.

Puna u vështirësua nga ndalimi i konkurseve për punësim nga Bordi i RTK-së, mungesa e kuadrit profesional, problemet teknike (server/UPS/pajisje të vjetruara) dhe furnizimi i paqëndrueshëm me energji elektrike. Megjithatë, RTK2 ruajti vazhdimësinë e transmetimit, standardet profesionale dhe besimin e publikut. Në dy festivale, u shpërblye u.d. e kryeredaktores përgjegjëse, Dragana Pajović, për filmin “NEK SE KOLO VIJE” (çmimi për regjistrimin më të mirë etnologjik), ndërsa kameramani Aleksandar Miladinović u nderua me çmimin vjetor për gazetari televizive për filmin “KAPIJE”

Gjatë vitit 2025, RTK2, pavarësisht sfidave të theksuara kadrovike dhe teknike, realizoi me sukses objektivat programore dhe e konfirmoi rolin e tij si shërbim publik i dedikuar komuniteteve në Kosovë. Aktivitetet kryesore u fokusuan në forcimin e programit informativ dhe raportim intensiv gjatë proceseve zgjedhore, rritjen e produksionit vetanak dhe realizimin e emisioneve në studio, si dhe në ruajtjen e vazhdimësisë së transmetimit dhe karakterit multietnik e shumëgjuhësor të programit. Gjatë vitit u transmetuan mijëra kronika informative, me mesatare 1.100–1.400 lajme në muaj gjatë periudhave më intensive; veçohen Janari me 1.358 lajme, Shkurti me 1.157, Maji me 1.427, Shtatori me 972 kronika, si dhe Tetori me 89 orë e 27 minuta program. Programi informativ përfshiu politikë (Kosovë, rajon, botë), shoqëri, ekonomi, sport, kulturë dhe parashikimin e motit, duke ruajtur raportim të balancuar dhe respektim të standardeve etike e rregullatore. Në kuadër të programit zgjedhor për zgjedhjet parlamentare (janar–shkurt), RTK2 realizoi emisione speciale me subjektet politike, tri debate tematike, intervistë me zëdhënësin e KQZ-së, emision special dyorësh në ditën e zgjedhjeve dhe raportim të drejtpërdrejtë gjatë gjithë ditës, duke siguruar kushte të barabarta për të gjithë aktorët politikë, përfshirë terminet falas për reklamim politik. Për zgjedhjet lokale (shtator–tetor, 12 tetor 2025) u organizuan 10 debate me kandidatët për kryetarë komunash, 5 emisione me analistë, emision special 2-orësh në ditën e zgjedhjeve dhe u realizuan gjithsej 7 orë program analizash, ndërsa kohëzgjatja totale e programit zgjedhor ishte mbi 6 orë në shtator me program shtesë në tetor; megjithëse disa kandidatë, veçanërisht përfaqësues të Listës Serbe, nuk iu përgjigjën ftesave. Programi zgjedhor u transmetua edhe në RTK1 dhe Radio Kosova 2, ndërsa RTK2 riprodhoi gjithashtu përmbajtje nga redaksitë e komuniteteve jo-shumicë. Gjatë vitit u realizuan 50–74 emisione në studio në muaj gjatë periudhave më intensive dhe në disa muaj u prodhuan mbi 100 orë prodhim vetanak, me rritje të dukshme në gjysmën e dytë të vitit; në programe morën pjesë qindra mysafirë nga politika, institucionet ndërkombëtare, kultura, shoqëria civile, arsimi dhe sporti, ndërsa veçohen intervistat me Radmilën Šekerinska (NATO), zëdhënësin e KQZ-së dhe zyrtarë ndërkombëtarë e analistë. Në qershor 2025 u shënua 12-vjetori i RTK2 me mbi 20 emisione speciale, 78 mysafirë, përmbajtje dokumentare e retrospektive, debate dhe reportazhe, duke prodhuar gjithsej 73 orë e 47 minuta program gjatë muajit të jubileut. Programi sportiv përfshiu transmetimin e garave UEFA, kualifikimeve të ndeshjeve ndërkombëtare dhe ndeshjeve të përfaqësueses së Kosovës, ndërsa në disa muaj u transmetuan edhe 10–14 ngjarje të rëndësishme sportive.

Në kontinuitet u transmetuan lajmet në gjuhën turke, boshnjake, rome dhe shqipe, si dhe magazinat javore "Mostovi", "Ora egjiptiane", "Zëri i Ashkalinjeve", "Jekhipe", "Mozaik", "Svetlo Gore" dhe "Crnogorski mozaik", duke ruajtur karakterin multietnik të kanalit dhe informim të barabartë për të gjitha komunitetet. Puna u vështirësua nga vendimi i Bordit të RTK-së për ndalimin e shpalljes së konkurseve, mungesa e kuadrit profesional dhe mbingarkesa e stafit, çka solli ndërprerje të disa emisioneve ("Roditelj u praksi", "Koraci", "Da se žene pitaju", "Kulturni mozaik", "Nedeljom zajedno", "Majstor i šegrt", "Srdačno iz…", "Sportak" – sporadikisht) dhe ndalimin e Ditarit të tretë gjatë vikendit; regjia punoi me 8 të punësuar në vend se 18, ndërsa montazha me 4 në vend se 8, duke e ngarkuar seriozisht deskun gjatë gjithë vitit. Nga aspekti teknik u shënuan prishja e serverit në qershor (me dëmtim dhe humbje të një pjese të materialit), UPS qendror i prishur, ndërprerje të shpeshta të energjisë elektrike, pajisje të vjetruara dhe mungesë e kuadrit inxhinierik, megjithatë nuk pati ndërprerje të përhershme të transmetimit. Në vlerësim të përgjithshëm, RTK2 ruajti standardet profesionale, realizoi programet kryesore zgjedhore, rriti vëllimin e produksionit vetanak, shënoi jubileun 12-vjeçar dhe ruajti karakterin shumëgjuhësor, ndërsa për zhvillim dhe stabilitet të mëtejmë mbeten të domosdoshme plotësimi urgjent i vendeve të sistematizuara të punës, modernizimi i pajisjeve teknike, zgjidhja e çështjes së sistemit energjetik dhe forcimi i kapaciteteve prodhuese.

4.4 Programi satelitor

Gjatë vitit, Programi Satelitor që vepron në kuadër të RTK-së ka zhvilluar aktivitetetin programor në përputhje me skemën programore, rregulloret, rrethanat dhe mundësitë që janë ofruar nga RTK. Programi ka përmbushur obligimet programore ku përvec emisioneve të rregullta, ka mbuluar edhe termine për të cilat nuk i kemi pasur të drejtat e transmetimit në RTK-sat. Emisionet e rregullta "Linja Shqip" dhe programi veror "E diela e Mërgatës" janë transmetuar sipas planë-programit.

Emisioni dyjavor kushtuar, diasporës "Linja Shqip" është realizuar sipas konceptit programor duke I realizuar dhe transmetuar 23 emisione dyjavore për mërgatën. Realizimi i emisioneve nga aktivitetet kulturore brenda dhe jashtë vendit dhe biseda e intervista me 33 personalitete nga diaspora, duke promovuar kulturën, gjuhën dhe identitetit kombëtar.

Duhet theksuar se në diasporë ka kërkesa të shumta për të ndjekur ngjarjet, mirëpo gjendja financiare në RTK, ka ndikuar negativisht sa i përket prezencës tonë në diasporë në realizimin e sa më shumë emisioneve për mërgimtarët.

Programi veror - Gjatë verës, ekipi i programit satelitor është angazhuar intensivisht në programin e verës. "E diela e Mërgatës" program me karakter argëtues edhe këtë vit stafi ka vazhduar me prodhimin e programit veror kushtuar diasporës është transmetuar në shtatë edicione. Emisionet gjatë muajit korrik dhe gusht janë xhiruar në kopshtin e RTK-së ku ishte vendosur skenografia me mysafirë të ardhur nga diaspora. Përvec mysafirëve, programi është shoqëruar me muzikë - këngëtar. Në këtë program kanë qenë prezentë 24 personalitete nga shtete të ndryshme të botës.

Gjithashtu, gjatë vitit janë paraqitur nevoja të shumta për ndryshime në skemën e rregullt programore. Kanë qenë 176 termine të mbuluara për programe që nuk i kemi pasur të drejtat e transmetimit për rrjetin satelitor, sic janë; Koncerti i Vjenës, ndeshjet futbollistik Europa league, atletika, magazinat sportive UCL, magazina Sculd, Eurosong 2025, dokumentaret e huaj- emisione muzikore. Prandaj bazuar në këto ndërhyrje është dashur të krijohen skema programore me emisione të larmishme, ndryshe nga rrjeti tokësor.

Ndërsa, sa i përket seancave të gjykatës së Hagës, pavarësisht ndryshimeve në skemën tokësore,

mërgimtarët kanë pasur mundësi të ndjekin në rrjetin satelitor seancat e Gjykatës Speciale.

Programi Satelitor ka përmbushur misionin ndaj diasporës në kushtet dhe mundësitë dhe rrethanat që janë ofruar nga RTK. Mirëpo në qoftë se do të kemi mbështetje financiare që të kemi prezencë në shtetet ku jetojnë dhe veprojnë mërgata jonë, atëherë ekzistojnë mundësi reale për zgjerimin dhe avancimin e mëtejshëm të përmbajtjeve programore për emigrantët.

Në vazhdim të këtij raporti i gjeni në formë tabelare numrin e emisioneve, emrat e mysafirëve si dhe temat e emisioneve të transmetuara.

PROGRAMI SATELITOR									
EMISIONET/ MATERIALE	NJË SI	XHIRI M	LIVE	TË INTERVISTUAR	M	F	FË MIJ Ë		MBULIM I TERMINEVE TË Planifikuara, emisione dhe dokumentare te huaja
Linja Shqip -(D-J)	23			33	26	7			
Magazina Sportive e shtunë dhe diele									38
Magazina Scult									53
Kampionati Botëror-Atletike									15
Futboll,HendbollEuro SONG, Festival-Koncert,Dokumentar, Film									70
	23		-	33	26	7			176

PROGRAMI VEROR “E DIELA E MERGATËS”									
EMISIONET/ MATERIALE	NJË SI	XHIRI M	LIVE	TË INTERVISTUAR	M	F	FË MIJ Ë		

PROGRAMI SATELITOR (RTK- Sat)

Përshkrimi	Nr i transmetimeve direkte	Ngjarje politike/ aktivitete të pozitës	Ngjarje politike/ aktivitete të opozitës	Ngjarje ekonomi/ infrastrukturë	Aktivitete,drejtësi, arsim dhe çështje sociale	Seanca të kuvendit dhe komisione
JANAR	38	15	1	3	19	0
SHKURT	41	15	3		12	11
MARS	43	27	2	2	12	0
Prill	38	20	3	2	7	6
MAJ	44	21	6	2	4	12
Qershor	31	21	3		1	6
Korrik	48	18	2	2	15	11
Gusht	36	18	3	3	8	4
Shtator	49	22	3	3	19	13
Tetor	44	19	3	4	7	11
Nentor	41	18	5		16	2
Dhjetor	38	19	5	5	10	1+

E diela e Mergates -(J)	7			24	13	11
TOTAL	6		-	24	13	11

RTK ka transmetuar qindra ngjarje me rëndësi për publikun gjatë vitit 2025. Ngjarjet kanë qenë në sektorë të ndryshëm, politikë, ekonomi, siguri etj. RTK mbetet lider në këto transmetime duke përmbushur misionin si transmetues publik. Në tabelë janë të dhënat për këto transmetime.

DHOMA E LAJMEVE

Dhoma e lajmeve ka qenë sektori me më shumë angazhime dhe dinamikë pune. Në një vit ku janë mbajtur tre palë zgjedhje (dy palë zgjedhje parlamentare dhe një palë zgjedhje lokale me dy raunde), pesha më e rëndë ka rënë mbi Dhomën e Lajmeve. Gjatë kësaj periudhe RTK e ka përmbushur misionin e vet për informim objektiv, të shpejtë e të saktë, të balancuar dhe korrekt. RTK ka arritur ta ruajë dhe ta konsolidojë politikën editoriale si transmetues publik sipas ligjit përkatës dhe rregulloreve në fuqi.

Edicionet e lajmeve janë realizuar me rregull, me përjashtim të rasteve kur ka pasur transmetime speciale për shkak të ndryshimeve në skemën programore. Nevojitet një ngritje cilësore në mbulimin e aktualitetit dhe trajtimin tematik, por gjithashtu duhet staf i ri në dhomën e lajmeve.

Gjithashtu, në komunat e mëdha na duhen bashkëpunëtorë të rregullt, ndërsa kemi mungesë në Tiranë, pasi nuk kemi një korrespondent atje.

4.5 RTK3

Periudha: Janar – Dhjetor 2025
Gjatë vitit 2025, në kuadër të lajmeve të ditës 08:00–15:00, janë realizuar edicione të rregullta ditore me mbulim të plotë të zhvillimeve në vend, rajon dhe arenë ndërkombëtare. Përmes edicioneve të lajmeve të ditës kemi ofruar informim të vazhdueshëm, të balancuar dhe profesional për publikun, duke përfshirë raportime nga terreni, lidhje të drejtpërdrejta dhe kronika të përgatitura nga redaksitë përkatëse.

Gjatë vitit 2025 janë realizuar gjithsej: 2001 **edicione informative**

Pasqyrë mujore e realizimit:

Janar – 166 edicione
Shkurt – 160 edicione
Mars – 155 edicione
Prill – 150 edicione
Maj – 155 edicione
Qershor – 150 edicione
Korrik – 155 edicione
Gusht – 155 edicione
Shtator – 150 edicione
Tetor – 155 edicione
Nëntor – 150 edicione
Dhjetor – 150 edicione

Gjatë vitit 2025 janë realizuar gjithsej: 134 lidhje të drejtpërdrejta

Lidhje live sipas muajve:

Shkurt – 14
Mars – 15

Prill – 16
Maj – 15
Qershor – 19
Korrik – 15
Gusht – 0
Shtator – 6
Tetor – 15
Nëntor – 10
Dhjetor – 9

Muaji me numrin më të madh të lidhjeve live ishte **Qershori (19 lidhje)**.

Gjatë vitit 2025, edicionet e lajmeve kanë mbuluar:

Zhvillimet Politike

Seancat për konstituimin e Kuvendit të Kosovës

Formimin e Qeverisë

Konferencat e partive politike

Aktivitetet dhe konferencat e KQZ-së

Proceset zgjedhore dhe rezultatet e balotazhit

Procesin gjyqësor në Hagë

Protesta në Kosovë dhe jashtë vendit

Diplomaci dhe Zhvillime Ndërkombëtare

Vizita zyrtare jashtë vendit të drejtuesve institucional e partiak

Forumi italo-shqiptar në Romë

Samiti në Tiranë

Zgjedhjet në rajon

Lajmet nga arena ndërkombëtare

Siguri

Vrasja e policit në Ferizaj

Gërmimet për varreza masive

Vërshime në disa qytete

Zjarre si pasojë e temperaturave të larta

Pritje në kufi

Ekonomi, Arsim dhe Çështje Sociale

Raportime ekonomike

Çështje sociale dhe zhvillime arsimore

Aktivitetet kulturore

Sport

Ndeshje vendore e ndërkombëtare, futboll, hendbolll, volejboll

Raportime dhe kronika nga redaksia e sportit

Lidhje të drejtpërdrejta nga ngjarje sportive

Lajmet e Ditës 08:00–15:00 - gjatë vitit 2025 kanë ruajtur:

Mbulim gjithëpërfshirës të zhvillimeve kryesore

Standard profesional në raportim

Prezencë të vazhdueshme me lajmet në kohë reale dhe raportime nga terreni

Me 2001 edicione dhe 134 lidhje të drejtpërdrejta, lajmet e ditës kanë dëshmuar qëndrueshmëri dhe angazhim të readaktorëve, gazetarëve e moderatorëve në informimin e publikut.

LAJMET NDËRKOMBËTARE

Nga 01 janar 2025 deri me 23 dhjetor 2025, Redaksia e Lajmeve Ndërkombëtare ka përgaditur 1266 kronika me pamje nga NEP.

Këto kronika janë transmetuar në edicionet ditore, edicionin qëndror të lajmeve 19:30, në si dhe edicionet e mbrëmjes.

Aktualisht nuk mundemi ti shfrytëzojmë pamjet nga Reuters, sepse nga 2023 korriku është ndërprerë kontrata mes RTK dhe Reuters. Një gjë e tillë ka ndikuar dhe vazhdon të ndikojë si për pamje ashtu edhe për mbulim sa më të shpejtë te lajmeve nga rajoni dhe bota. Njëherësh nuk kemi qasje as në EVN dhe aktualisht jemi duke përdorur sistemin NEP i cili është mjaft i kufizuar për pamjet që nevojiten të mbulohen kronikat e lajmeve nga bota, si dhe ku neës feeds ruhen vetëm 2 ditë duke na detyruar që shpesh të mbulojmë lajme me pamje nga arkivi.

Sa i përket mbulimit të lajmeve nga bota, brenda vitit 2025 rëndësi e veqantë i është kushtuar luftës Izrael – Gazë si dhe të gjitha zhvillimeve në Lindje të Mesme e posaqerisht përpjekjeve diplomatike për arritjen e paqes Izrael - Gazë Gjithashtu kemi përcjellur intensivisht Luftën në Ukrainë dhe zhvillimet e përgjitshme sa I përket luftës në Ukrainë me theks të veqantë perpjekjeve diplomatike te SHBA dhe Evropes për të arritur armëpushimimin.

Një tjetër zhvillim global që ka shënuar vitin 2026 dhe që është përcjellur vazhdimisht është Lufta Tregtare e Trump dhe lufta tarifore e SHBA-së me pothuajse të gjitha vendet e botës.

Rëndësi e veqantë I është kushtuar edhe zhvillimeve tjera në SHBA me theks të veqantë muajve të fundit të Dosjeve Epstein, si dhe sulmeve ajrore te SHBA-së ndaj anijeve në Venezuelë, ku redaksia e Lajmeve Ndërkombëtare edhe pse në mungesë të pamjeve ka mbuluar zhvillimet me rëndësi.

Janë përcjellur edhe Samitet e NATO-sdhe G7 –tës të cilët kanë qenë të fokusuar në fokusuar në stabilitetin dhe sigurinë ekonomike globale si dhe në trajtimin e sfidave në zhvillim të sigurisë evropiane.

Ndërkaq nga zhvillimet tjera që janë përcjellur rëndësi e posaqme I është kushtuar vershimeve shkatërruese në Evropë dhe botë si dhe fatkeqësive tjera natyrore që kanë goditur Evropën, uraganet në SHBA dhe fatkeqësite tjera natyrore në botë e që gjatë vitit 2025 kanë qenë të shumta.

Redaksia e lajmeve Ndërkombetare gjithashtu ka përgatitur një edicion special me 23 shkurt për Zgjedhjet në Gjermani dhe përvjetorin e 3–të të Luftës në Ukrainë I cili është transmetuar live nga ora 21 deri pas ores 23:00.

Gjithashtu redaksia e lajmeve ndërkombëtare ka përgaditur një speciale të drejtpërdrejtë me 26 prill në kohëzgjatje prej rreth 3 orë e gjysëm me rastin e ceremonisë së varrimit të Papa Franceskut.

Redaksia e lajmeve ndërkombëtare ka përgaditur një përmbledhje me rastin e tre vjetorit të nisjes së luftës në Ukrainë me minutazh rreth 3 min, e që është transmetuar në edicionin e lajmeve qendrore të së hënës më 24. 02. 2025.

Përveq mbulimit të të ngjarjeve më të rëndësishme globale, redaksia e Lajmeve Ndërkombëtare përcjellë cdo lajm të fundit apo zhvillim për të cilin duhet të informohet publiku. Mediat e zakonshme të cilave ju referohen gazetarët për lajmet e fundit dhe ngjarjet tjera, janë BBC, CNN, Reuters, AP.

REDAKSIA E SPORTIT

Në vitin 2025, RTK ka ofruar një përmbajtje të pasur dhe të larmishme në programin e saj të sportit, duke përfshirë disa ngjarje dhe iniciativa kryesore.

FUTBOLL: Ndeshjet e Komëtares së Kosovës n futboll Lojërat Olimpike: RTK ka siguruar transmetime të drejtpërdrejta dhe analiza të thelluara të Lojërave Olimpike, duke ofruar mundësi të jashtëzakonshme për publikun kosovar për të ndjekur atletët e tyre në garat ndërkombëtare.

Specialet gjatë Kampionatit Evropian: Gjatë Kampionatit Evropian, RTK realizoi speciale dhe raporte të detajuara mbi zhvillimet dhe arritjet e skuadrave, duke përfshirë intervista dhe pasqyra të thelluara për ekipet dhe lojtarët.

Rikthimi i Ndeshjeve të Kombëtares së Kosovës në Futboll: Pas një periudhe pauze, RTK riktheu transmetimet e ndeshjeve të Kombëtares së Kosovës, duke sjellë emocionet e ndeshjeve nëpër kualifikime dhe miqësore, duke mbështetur tifozët kosovarë.

Rikthimi i Transmetimeve të UEFA Champions League, UEFA Europa League dhe UEFA Conference League: Pas 10 vitesh pauzë, RTK rinisi transmetimet e këtyre kompeticioneve prestigjioze, duke ofruar mundësi për pasionantët e futbollit të ndjekin ndeshje të nivelit të lartë nga klubet evropiane.

Promovimi i Sportit Vendor: RTK ka vënë theksin në promovimin e sporteve të ndryshme lokale, duke transmetuar aktivitete dhe ndeshje të sporteve si futbolli, basketbolli dhe sportet dimërore, duke rritur dukshmërinë e atleteve dhe ngjarjeve sportive vendore.

Realizimi i Kuizit të Parë Sportiv në Historinë e Tregut Medial në Kosovë: RTK ka realizuar kuizin e parë sportiv, një iniciativë që ka tërhequr vëmendjen e publikut dhe ka ofruar një mundësi për të shpërndarë njohuri sportive dhe për të inkurajuar pjesëmarrjen e shikuesve.

Emisione të Rregullta Ditore dhe Javore: RTK ka mbajtur një kalendar të ngjeshur të emisioneve të rregullta, përfshirë ato ditore dhe javore, të cilat kanë pasqyruar zhvillimet e fundit në sport, intervista me sportistë dhe analiza të ndeshjeve.

Intervista dhe Materiale Ekskluzive: RTK ka ofruar intervista dhe materiale ekskluzive, duke sjellë histori të pasura dhe pamje të rralla nga prapaskenat e ngjarjeve sportive dhe duke i mundësuar shikuesve të njihen më thellë me sportistët dhe trajnerët e njohur.

Përmbyllja e Dokumentarëve Sportiv dhe Puna me Dokumentarët e Rinjtë: RTK ka realizuar dhe përmbyllur serinë e dokumentarëve sportivë, duke ofruar pasqyra të thelluara mbi karrierat e sportistëve të njohur dhe ngjarje të paharrueshme, ndërkohë që ka filluar punën mbi dokumentarët e rinj që do të ofrojnë perspektiva të freskëta dhe inspiruese për sportin kosovar.

MUAJI/NGJARJA		Sport PLUS (emision ditor)	AS (emision javor)	SportELITE	BOKS OLIMPIK	BOKS PROFESIONIST	VOLEJBOLL/BEACH VOLLEY	FUTBOLL	UEFA EURO 2025 (Femrat(	HENDBOLL	FUTSAL	BOTERORI ATLETIKE	DOKUMENTAR	PING PONG	TRANSMETIME TJERA	FIFA GALA AËARDS	UEFA CL/UEL/UCL	MAGAZINAT E UCL/UEL	SPECIALE	RUGBY
01	JANAR	17	1	0						0	1					1	4	4		
02	SHKURT	15	1	3	1			2			1				1		4	8	1	
03	MARS	15	3	4			4	2		1					3		4	5	3	
04	PRILL	17	4				1			4	4				2		5	7	4	
05	MAJ	17	4		1								1				9	9	3	
06	QERSHOR	21	3	2		2		2						6					2	18
07	KORRIK	22	3	3				1	10						2		2		1	
08	GUSHT	22		2	1	1		1							3		6		2	
09	SHTATOR	17		3				2				9					3	5	5	
10	TETOR	19	2	1		1		4		1	3						4	5	5	
11	NËNTOR	15	5		1			2		1	1				1		4	7	7	
12	DHJETOR	19	2			1					1				2		3	5	5	
	NJËSI	⇨216	28	15	4	5	5	16	10	7	11	9	1	6	14	1	48	55	38	18

PËRSHKRIM NARRATIV

Ngjarjet e Mbuluara

Emisioni ditor SportPLUS,

Emisioni javor AS,

Emisioni javor SportELITE

ATLETIKË: Botërori

Ragbi: Kampionati Evrpian Divizioni 2

Ping-Pong: Kampionati ndërkombëtar VTT

UEFA EURO 2025 (femrat),

FUTBOLL: Kombetarja e Kosoves dhe grupmoshat

FIFA Lojtari i Vitit (ceremonia vjetore),

FUTSAL: Ndeshjet e Kombetares dhe FC Prishtina 01

UEFA Champions League / Europa League / Conference League

VOLEJBOLL: Superliga e Kosovës te djemtë dhe vajzat,

HENDBOLL: Kombëtaret A (djemtë & vajzat),

HENDBOLL: Superliga,

BOKS PROFESIONIST:

BOKS OLIMPIK: Turnetë tradicionalë “Adem Jashari”, “Pavarësia”, “Lah Nimani”

TRANSMETIMET E VEÇANTA

NDARJA E PRIORITETEVE

Sporti vendor

Sigurimi/Negocimi i ngjarjeve të mëdha sportive

Sporti për personat me nevoja të veçanta (lëvizja paralimpike)

Sporti ndërkombëtar

EKSKLUZIVITETET

RTK gjatë vitit 2025 solli një numër të madh të ngjarjeve që u transmetuan ekskluzivisht vetëm në kanalin e RTK1, RTK2 dhe RTK4.

RTK e ka bartur primatin e transmetuesit që ka kontribuar më së shumti në:

- promovimin e aktiviteteve të sportit vendor,
- rritjen e cilësisë,
- luftimin e dukurive negative në sportin tonë si dhe
- bartjen e barrës së transmetues vendas (host broadcaster) në ngjarjtet e mëdha sportive të realizuara/prodhuara nga RTK

Më poshtë janë disa prej ngjarjeve që lanë gjurmë në transmetimet dhe mbulueshmërinë nga ana e RTK-së për vitin 2025.

SPORTI VENDOR

Në vitin 2025, RTK realizoi një kalendar të pasur dhe shumë emocionues të transmetimeve sportive, duke sjellë ngjarje të rëndësishme dhe duke ofruar një pasqyrë të thelluar për zhvillimet kryesore në sportin ndërkombëtar dhe atë vendor.

I. PROGRAMET STUDIORE INFORMATIVE

Sport PLUS

Gjatë vitit raportues janë realizuar gjithsej 216 edicione të emisionit Sport PLUS, i cili ka vazhduar të jetë boshti kryesor i informimit sportiv në RTK. Përmes këtij formati janë mbuluar në mënyrë të përditshme zhvillimet kryesore nga sporti vendor dhe ndërkombëtar, me kronika, intervista dhe analiza profesionale.

Emisioni AS

Në kuadër të programeve analitike janë prodhuar 28 emisione javore AS (Analiza Sportive). Ky format ka ofruar trajtim të thelluar të temave aktuale sportive, me diskutime profesionale dhe pjesëmarrje të ekspertëve të fushës.

Sport ELITE

Janë realizuar 15 emisione periodike Sport ELITE, të dedikuara promovimit të sportistëve, klubeve dhe sukseseve të sportit kosovar. Emisioni ka trajtuar tema të veçanta dhe storie suksesi nga komuniteti sportiv.

TRANSMETIMET NGA SPORTET LUFTARAKE

Boksi Profesionist

Gjatë vitit janë realizuar 4 transmetime nga boksi profesionist, duke siguruar prezencë të rregullt të këtij sporti në programet e RTK-së.

Boksi Olimpik

Po ashtu janë transmetuar 5 ngjarje nga boksi olimpik, duke kontribuar në promovimin e sportistëve vendorë dhe garave ndërkombëtare.

TRANSMETIMET NGA SPORTET KOLEKTIVE

Volejbolli

Janë realizuar 5 transmetime nga volejbolli, kryesisht nga faza e Play-Off-it. Krahasuar me periudhat e mëhershme është evidentuar një rënie prej 83.3%, si pasojë e refuzimit të së drejtës për transmetim ekskluziv të komplet Superligës, gjë që ka kufizuar ndjeshëm numrin e ndeshjeve të disponueshme.

Futbolli – Ngjarjet Kombëtare

RTK ka realizuar 16 transmetime nga ngjarje të ndryshme të futbollit, duke përfshirë ndeshjet e Kombëtares së Kosovës, takime miqësore dhe përballje të futbollit të femrave.

UEFA Euro 2025 – Futbolli i Femrave

Janë transmetuar 10 ndeshje nga Kampionati Evropian I Femrave UEFA Euro 2025, duke I dhënë hapësirë të rëndësishme zhvillimit dhe promovimit të futbollit të femrave.

Hendbolli

Gjatë vitit janë realizuar 7 transmetime nga ndeshjet e Kombëtareve në hendboll, 37in ë konkurrencën e meshkujve ashtu edhe të femrave.

Futsalli

Një rritje e theksuar është shënuar në transmetimet e futsallit. Nga vetëm 3 transmetime në vitin 2024, numri është rritur në 11 transmetime në vitin 2025, duke shënuar një rritje pozitive prej 266.7%.

NGJARJE NDËRKOMBËTARE DHE EKSKLUZIVITETE

Kampionati Botëror i Atletikës

RTK ka transmetuar ekskluzivisht Kampionatin Botëror të Atletikës për një periudhë prej 9 ditësh radhazi gjatë muajit shtator. Me këtë rast është siguruar e drejta e transmetimit të këtij eventi deri në vitin 2029, duke garantuar prezencë afatgjatë të atletikës elitare në ekranin e RTK-së.

Ping-Pong – Gara WTT

Në sportin e ping-pongut, për herë të parë janë transmetuar ndeshjet finale të garës prestigjioze ËTT, një ekskluzivitet i siguruar nga RTK, duke zgjeruar gamën e sporteve të transmetuara.

Transmetime të Tjera

Programi sportiv ka përfshirë edhe transmetime nga aktivitete të tjera, si:

Lojërat shpërblyese me partnerin Gjirafa,

Ceremonitë e Laureatëve të Vitit nga Komiteti Olimpik i Kosovës,

Ceremonitë e organizuara nga Federata e Futbollit e Kosovës,

Si dhe ngjarje të tjera me interes kombëtar dhe global.

KOMPETICIONET E UEFA-s

Transmetimet e Ndeshjeve

Gjatë vitit 2025, RTK ka transmetuar gjithsej 48 ndeshje nga kompeticionet elitare:

UEFA Champions League

UEFA Europa League

UEFA Conference League

Këtu janë përfshirë Superkupa e Evropës, ndeshjet kualifikuese të klubeve kosovare, si dhe përballjet nga fazat grupore dhe eliminatore.

Magazinat Periodike të UEFA-s

Si mbështetje e këtyre transmetimeve janë realizuar 55 magazina periodike, të dedikuara tri garave kryesore të UEFA-s, me përmbledhje, analiza dhe materiale ekskluzive.

Emisionet Shoqëruese

Janë prodhuar 38 emisione shoqëruese, të cilat kanë paraprirë dhe pasuar transmetimet e futbollit, përfshirë:

Emisionet e dedikuara ndeshjeve të Kombëtares,

Formatet analitike si “Dardanët”,

Emisionet para dhe pas ndeshjeve të UEFA Champions League.

Komentimi nga Vendi i Ngjarjes

Një arritje e rëndësishme profesionale gjatë vitit 2025 ka qenë sigurimi i komentimit nga vendi i ngjarjes i finaleve të UEFA Champions League dhe UEFA Europa League, duke rritur ndjeshëm cilësinë dhe nivelin profesional të transmetimeve.

Sigurimi i transmetimeve të drejtpërdrejta të ngjarjeve më të mëdha të boksit, përfshirë edhe serinë “The shoë must go on”, ku në partneritet me FIDES Sports, RTK i ka transmetuar ekskluzivisht mbrëmjet e boksit profesionist.

FIFA LOJTARI I VITIT

RTK e pati ekskluzivitetin e transmetimit të ngjarjes gala të Lojtarit të Vitit.

NEGOCIMI I MARRËVESHJES ME TELEKOMIN E KOSOVËS PËR SIGURIMIN E FIFA KUPËS SË BOTËS 2026

Programi i Sportit në RTK-TV ka qenë në linjën e parë të udhëheqjes së negociatave për sigurimin e së drejtës televizive për FIFA Kupën e Botës 2026, një ngjarje e niveleve elitare dhe shumë të rëndësishme për audiencën e gjerë.

PROGRAMI I KOMUNITETEVE PËR VITIN 2025

Programi i Komuniteteve gjatë vitit 2025 është realizuar me sukses, pavarësisht sfidave në procesin e punës. Gazetarët dhe redaktorët kanë treguar punë profesionale e të palodhshme në të gjitha fazat e punës, gjatë raportimit dhe realizimit të emisioneve informative në të gjitha fushat: politikë, arsim, shëndetësi, mirëqenie dhe ekonomi.

Nga Programi i Komuniteteve gjatë vitit 2025 është realizuar mbulimi i suksesshëm i katër proceseve zgjedhore, dy palë Zgjedhje Pralamentare dhe një proces i Zgjedhjeve Lokale, plus procesi i balotazhit.

Programi i Komuniteteve në RTK 1 gjatë vitit 2025 ka realizuar me sukses të gjitha magazinat e planifikuara të shtatë komuniteteve, përveq magazinës “Nedeljni kolaz”, për shkak të mungesës së stafit në redaksinë serbe, por me kthimin nga pushimi i lehonisë të redaktores Mirjana Marinkovic do të nis realizimi i tij.

Programi i Komuniteteve në RTK 1 gjatë vitit 2025 ka realizuar me sukses edhe edicionet e lajmeve çdo ditë pune në katër gjuhë (serbe, turke, boshnjake dhe rome), me kronika të përgatitura në terren dhe lajme nga vendi, rajoni dhe bota si dhe magazinat javore të shtatë (7) komuniteteve. Konsideroj se me punë të mirë , elan dhe gatishmëri përtej përmbushjes së kontratve të tyre, stafi i ka kryer punën komfor standardeve dhe misionit të transmetuesit publik , duke u fokusuar në nevojën dhe kërkesat e audiencës për informim të drejtë dhe të shpejtë.

Statistikat dhe përmbajttja e emisioneve

Gjatë 2025-s janë realizuar gjithsej **313 emisione javore / magazina** të shtatë redaksive, në të gjitha gjuhët e komuniteteve, në emisionet:

- *Mozaik (në gjuhën turke)*
- *Mostovi (në gjuhën boshnjake)*
- *Jekiphe (në gjuhën rome)*
- *Nedeljni Kolaz (në gjuhën serbe)*
- *Zëri i Ashkalinjve (në gjuhën shqipe)*

- Ora Egjiptiane (në gjuhën shqipe) dhe

- Svetlo Gore (në gjuhën gorane)

Të gjitha emisionet janë transmetuar premierë dhe janë dominuar me tema nga fusha të ndryshme, nga ato të politikës (pasi ishte vit zgjedhor) , procesi i integrimit, liberalizimi, cështjet ekonomike, nga fusha e arsimit (gjendja nëpër shkolla me klasë në gjuhë të komuniteteve), pastaj tema nga shëndetësia, por edhe tema tjera si nga kultura e sporti.

Në emisionet 45-minutëshe të redaksive serbe, turke, boshnjake dhe rome **"Mostovi", "Mozaik", "Jekiphe" dhe "Nedeljni kolaz"** ka pasur intervista, reportazhe dhe kronika me tema të ndryshme aktuale, të trajtuara në mënyrë profesionale nga të gjitha segmentet, politika, arsimi, ekonomia, kultura dhe sporti. Të gjitha këto redaksi, të cilat përbëhen nga nje staf i limituar gjatë tërë vitit kanë punuar me numër të kufizuar të stafit, pasi kishte mungesa, si pushime të lehonisë, pushime shëndetësore dhe të tjera.

Në emisionet javore 15-20 minutëshe **"Ora egjiptiane" , "Zëri i ashkalinjve"** dhe **"Svetlo Gore"** (të komunitetit egjiptian, goran dhe ashkalinj) janë trajtuar tema që i preokupojnë pjesëtarët e këtyre komuniteteve. Janë përgatitur kronika me tema sociale dhe nga ekonomia, pasi të gjitha të dhënat dhe sondazhet tregojnë se ajo duhet të jetë prioritet për një të ardhme më të mirë të pjesëtarëve të këtyre komuniteteve, sidomos për shkak të gjendjes më të vështirë sociale të pjesës dërrmuese të tyre. Në këto redaksi janë realizuar edhe tema për çështjen e arsimit, si kronika dhe debate kundër fenomeneve negative prezente (si diskriminimi, lufta kundër dhunës ndaj grave, antigjipsizmi, martesave të hershme dhe dukurive të tjera negative), por nuk kanë munguar ngjarjet me tema të tjera aktuale, si nga politika, sporti dhe kultura.

Mbulimi i Ditëve Nacionale të Komuniteteve

Edhe gjatë 2025-s, Programi i Komunitetve në RTK1 ka mbuluar (transmetuar) ceremonitë nga Ditët Nacionale të të gjitha komuniteteve (7), të organizuara nga Zyra për Komunitete pranë Kryeministrisë, kurse në magazinat javore të të shtatë redaksive në këto gjuhë u është dhënë hapësirë këtyre ngjarjeve të rëndësishme për çdo komunitet.

Sfidat e Programit të Komuniteteve

Programi i Komuniteteve, gjatë vitit 2025 është ballafaquar me problemin e stafit të pamjaftueshëm në disa redaksi.

Ndonëse para tri viteve RTK ka rekrutuar tri folëse në redaksitë e Ashkalinjve, Egjiptianëve dhe Goranëve (më parë të punësuara në këto redaksi me kontrata mbi vepër) ka vështirësi në funksionim e këtyre redaksive, pasi stafi përbëhet nga vetëm një person. Problem tjetër i pazgjidhur është se ato kanë mbetur akoma me kontrata të folësesve. Prandaj, si nevojë e menjëhershme shtrohet rritja e stafit aktual në këto redaksi, si dhe rregullimi i kontratave të bartësve të emisioneve "Zëri i Ashkalinjve", "Ora Egjiptiane" dhe "Svetlo Gore", pasi drejtueset e këtyre emisioneve kryejnë edhe punën në terren dhe kujdesen deri në finalizimin e emisionit për transmetim. Si rrjedhojë, shihet e udhës që t`u njihet kontributi faktik dhe kontratat e tyre të ndryshohen nga Folës në Gazetar 2-moderator.

Nevojat për ndryshim

Mungesa e stafit në disa redaksi, si serbe, rome, e ashkalinjve, gorane dhe egjiptianëve, pastaj pushimet e lehonisë (redaksia gorane dhe rome), të pushimeve mjekësore (sëmundjeve kronike gati në të gjitha redaksitë) ka ndikuar që kapacitetet aktuale të shfrytëzohen maksimalisht për të realizuar të gjitha emisionet/magazinat dhe edicionet e lajmeve në gjuhë të ndryshme. Gjithashtu në raportet mujore kam adresuar ankesa për mungesë të njësive të montazhit dhe të numrit të vogël të montazherëve, por edhe mungesës së kamerave për punë në terren. Edicionet e lajmeve në 4 gjuhë bëhen në studio 1, e gjithashtu edhe xhirimi i magazinave javore , prandaj mendoj se është më se e nevojshme një këndë me skemografi të vecant, pra një hapësirë për programin e komuniteteve, gjë që do të ishte zgjidhje e qëndrueshme.

Programi Festiv i Komuniteteve

Është planifikuar, përgatitur , shkruar skenari dhe është xhiruar **Programi Festiv i Komuniteteve 2026,** në kohëzgjatje rrethj 1 orë e 10 minuta, ku janë përfshirë të gjitha komunitetet në një program të përbashkët e të larmishëm festiv. Ky është viti i nënëtë që realizohet projekti i programit të përbashkët, i cili shquhet me diversitetin gjuhësor, me moderim në disa gjuhë, me këngë të grupeve dhe këngëtarëve nga shumë komunitete, në lidhje me trashëgimin, identitetin, kulturën dhe specifikat e secilit komunitet. Programi Festiv i Komuniteteve ka përmbushur standardet profesionale dhe nevojën që komunitetet të kenë hapësirën e tyre edhe në programin festiv të RTK-së. Ky program, me urime e thirrje për paqe, dëshira për paqe dhe barazi për të gjithë është mirëpritur nga publiku. Ka reagime shumë pozitive, është rritur shikueshmëria në RTK YouTube, por kemi marrë lavdata përmes emailave, telefonatave dhe SMS inkurajues.

Tabelat e emisioneve javore, numri i emisioneve, numri i të intervistuarve dhe gjinia e tyre.

Raportit vjetor të Programit të Komuniteteve po i shtoj edhe tabelën e numrit të emisioneve / magazinave javore në gjuhët e komuniteteve, në të cilat është nxjerrë numrit i të intervistuarve dhe i gjinisë së tyre, dhe nga cili vihet re se edukimi si mision i transmetuesit publik është shumë i rëndësishëm, e kjo vihet re edhe në përfaqësimin e grave në emisionet tona.

Programi i Komuniteteve, përveq që lavdërohet nga shumë instanca, gjithashtu merret shembull i suksesit gjatë vizitave që i bëhen Transmetuesit Publik apo në vizitat tona jashtë vendit. Programi i Komuniteteve në RTK, përveç obligimit ligjor, ka rol kyç në ngritjen e vetëdijes së publikut për diversitetin gjuhësor e kulturor në vendin tonë, në rëndësinë e integrimit dhe rritjen e demokracisë në vend.

ZYRA RAJONALE PRIZREN

Zyra e Prizrenit është e konsoliduar dhe ka funksionuar mirë, duke mbuluar këtë rajon.Të dhënat për vitin 2025 janë si vijon:

1. **RTK 1, RTK 3 – Gjuha Shqipe 2025**

   Materiale gjithsej: 297 Kronika + live

2. **Redaksia Boshnjake – të realizuara:**

Sabina Rexhepi 2025

32 – Kronika – Lajme

23- Storie per Mostovi

12 – Realizime (Mostovi)

Mustafa Balje - 2025

83- Kronika

78 – Mostovi

12 - Realizime Mostovi

3. Redaksia Rome Radio

265 - Edicione te lajmeve ne gjuhen rome

269- Kronika

52 – Emisione autoriale – Romano -Avazo

4. Redaksia Turke Tv – të realizuara

Haber + Mozaik – 46 materiale

Realizime - 7

5. Ora Egjiptiane – të realizuara:

48 - Emisione (60 kronika)

4 Svetlo Gore – 17 Emisione të realizuara (janar – shtator):

(Pushim Lehonie prej shtatorit)

5 Radio – Redaksia Turke
Emisioni 15 minuta – 46
Emisioni 30 minuta -44
Aktualitet- 145
Debate – 3
Lajme - 244

Zyra Rajonale në Prizren, ka mbuluar edhe kërkesa të tjera të parashtruara nga RTK 1,2,3,4 si dhe Radio, përmes Kryeredaktorit, Redaktorëve, Gazetarë, Produksioni i RTK, si dhe Shefi i Kamermanëve.

Gjithashtu, janë përgatitur dhe lexuar lajme nga Redaksia Boshnjake

ZYRA RAJONALE MITROVICË

Zyra rajonale në Mitrovicë ka funksionuar mirë, por mungesa e një gazetari të rregullt aty, krijon sfida në mbulimin e shpejtë të aktualitetit.

Në tabelën më poshtë mund t'i shihni aktivitetet që ka zhvilluar e realizuar Zyra Rajonale në Mitrovicë për vitin 2025.

	Kronika – tema	Emisione	Lidhje direkte
Janar	10	1	
Shkurt	10	2	11
Mars	9		4
Prill	5	4	1
Maj	9	9	
Qërshor	Prishtinë	Prishtinë	Prishtinë
Korrik	16		1
Gusht	12	3	5
Shtator	16	4	
Tetor	13		10
Nëntor	20	3	17
Dhjetor	14	2	14
Gjithsej	134	28	63

Raport për Bashkëpunimin Ndërinstitucional ndërmjet Radiotelevizionit të Kosovës - RTK dhe Radiotelevizionit Shqiptar – RTSH

Periudha raportuese: 2025

Gjatë vitit 2025 u realizua një bashkëpunim i qëndrueshëm dhe i strukturuar, i karakterizuar nga:

- shkëmbim i gjerë i përmbajtjes programore dhe informative;
- realizim debatesh tematike dhe programesh speciale;
- transmetime të drejtpërdrejta dhe koordinim editorial për ngjarje me rëndësi;
- bashkëpunim i ndërsjellë në mbulimin e proceseve zgjedhore;
- aktivitete kulturore dhe promovuese të përbashkëta.

3. Prodhimi dhe shkëmbimi i përmbajtjes programore

Gjatë vitit 2025, RTK ka marrë nga RTSH rreth 500 prodhime programore, përkatësisht:

- 116 dokumentarë, reportazhe dhe emisione speciale me kohëzgjatje të ndryshme;

- 375 kronika të aktualitetit ditor nga fusha e turizmit, kulturës, trashëgimisë dhe çështjeve sociale;
- lidhje direkte ndërmjet gazetarëve të dy institucioneve në edicione informative dhe programe magazinë;
- materiale bruto dhe kronika informative të përgatitura nga gazetarët e RTSH për nevojat editoriale të RTK.
- RTSH ka marrë nga RTK rreth 90 kronika të aktualiteteve politike ditore, përmbledhje zgjedhore ("round-up"), kronika hulumtuese si "Hetim për Safari Snajper" dhe "Margeti", si dhe rreth 40 dokumentarë e reportazhe me kohëzgjatje të ndryshme, ndër të cilat:
- dokumentar për Pavarësinë e Kosovës;
- dokumentar për Epopën e UÇK-së (nga cikli "Gjurmët");
- dokumentarë për trashëgiminë kulturore dhe turizmin në Kosovë.

4. Prodhime dhe debate tematike

RTK realizoi 3 debate televizive në studiot e RTSH-së, të transmetuara ekskluzivisht në RTK, në prill, maj dhe dhjetor 2025.

Këto programe kontribuan në pasurimin e diskursit publik dhe trajtimin e temave me interes të përbashkët për audiencën në Kosovë dhe Shqipëri.

5. Transmetime të drejtpërdrejta dhe mbulim i ngjarjeve me rëndësi

Bashkëpunimi përfshiu transmetime me sinjal të pastër nga RTSH dhe koordinim editorial për mbulimin e ngjarjeve me rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare, ndër të cilat:

- mbulimi informativ i ushtrimit ndërkombëtar DEFENDER 2025, i mbajtur në Shqipëri;
- Konferenca e OVL-UÇK në Tiranë (29 shtator) dhe protesta pasuese (17 tetor);
- Samiti i Procesit të Brdo-Brijunit (6 tetor);
- Forumi i parë i investimeve Bashkimi Evropian – Ballkani Perëndimor (13–14 tetor, Tiranë);
- Samiti i liderëve të rajonit (21 nëntor);
- aktivitetet zyrtare të 28 Nëntorit, përfshirë ceremoninë e ngritjes së flamurit në Vlorë.

6. Bashkëpunimi në mbulimin e proceseve zgjedhore

U realizua shkëmbim i ndërsjellë materialesh informative për proceset zgjedhore në Kosovë dhe Shqipëri, përfshirë:

- kronika për fushatat zgjedhore lokale dhe parlamentare në Kosovë (format "round-up");
- transmetimin e kronikave informative mbi proceset zgjedhore në Shqipëri.
- Lidhje të drejtpërdrejta me gazetarët nga RTSH në RTK dhe anasjelltas.

7. Bashkëpunimi në fushën kulturore dhe promovuese

Në kuadër të bashkëpunimit programor u realizua promovimi i RTK Fest për audiencën e RTSH përmes lidhjeve direkte me organizatorët dhe transmetimit të drejtpërdrejtë të Festivalit të Këngës në platformat e RTSH.

Po ashtu RTK ka transmetuar në kohë reale dhe 4 netët e Festivalit të këngës në RTSH – FEST64, tre netët e para në kanalin RTK4 dhe natën finale në RTK1.

Produksionii – RTK/TV

Edhe gjatë vitit 2025, Sektori i Produksionit ka funksionuar në përputhje me obligimet institucionale të RTK-së, duke siguruar mbështetje të vazhdueshme për realizimin e programit televiziv. Aktivitetet janë zhvilluar në koordinim të vazhdueshëm me redaksitë dhe njësitë përkatëse, duke ruajtur kontinuitetin e procesit të produksionit, pavarësisht vështirësive të theksuara në aspektin e burimeve njerëzore.

Aktivitetet gjatë vitit 2025

Gjatë vitit raportues, sektori ka qenë i angazhuar në realizimin e produksioneve të rregullta dhe projekteve programore, duke kontribuar drejtpërdrejt në funksionimin e programit informativ, kulturor, sportiv dhe argëtues të RTK/TV. Këto aktivitete janë realizuar kryesisht përmes angazhimit intensiv të stafit ekzistues, i cili, për shkak të mungesës së stafit në disa sektorë të produksionit, ka qenë i detyruar të mbulojë volume të shtuara pune dhe angazhime të vazhdueshme jashtë orarit të rregullt.

Në kuadër të këtyre aktiviteteve, gjatë vitit 2025 janë realizuar:

- **Xhirime dhe realizime me OBV-an** – 198 realizime
- **Edicione informative** – 2.911 realizime
- **Montazhe** – 2.247 realizime (pa lajmet ditore)
- **Xhirime në terren** – 2.004 realizime (pa dhomën e lajmeve)
- **Transmetime të drejtpërdrejta** në baza ditore

Sfidat kryesore

Sfida kryesore gjatë vitit 2025 ka qenë mungesa e stafit në disa sektorë kyç të produksionit, e cila ka ndikuar drejtpërdrejt në mbingarkesën e stafit aktual. Kjo situatë ka rezultuar me angazhime të shpeshta jashtë orarit të punës, rritje të presionit operacional dhe vështirësi në planifikimin optimal të projekteve. Paralelisht, pajisjet e amortizuara, mungesa e teknologjisë bashkëkohore dhe kufizimet buxhetore kanë kufizuar mundësitë për rritje të efikasitetit dhe modernizim të procesit të produksionit. Sektori i Produksionit mbetet një nga sektorët me numrin më të madh të punonjësve dhe me nivelin më të lartë të angazhimeve dhe realizimeve ditore në RTK/TV.

Synimet për vitin 2026

Në vitin 2026, Sektori i Produksionit synon adresimin e drejtpërdrejtë të mungesës së stafit përmes rekrutimit të kuadrove të reja, me qëllim të uljes së mbingarkesës së stafit ekzistues dhe rritjes së efikasitetit operacional. Po ashtu, synohet përmirësimi gradual i bazës teknike, planifikim më i qëndrueshëm i projekteve dhe forcimi i kapaciteteve profesionale të stafit përmes trajnimeve të vazhdueshme, duke marrë parasysh zhvillimin e shpejtë teknologjik dhe nevojat e sektorit.

TV TEKNOLOGJIA 2025

NJËSIA E TRANSMETIMIT DHE E LIDHJEVE

Njësia e transmetimit dhe e lidhjeve me inxhinierët dhe teknikët ka organizuar, planifikuar dhe mbikëqyrur realizimin e të gjitha transmetimeve të drejtpërdrejta nga terreni për të gjitha kanalet e RTK-së, duke përdorur të gjitha format e transmetimit, si transmetimet me fibër optik, transmetimet me 4G, transmetimet me satelit, lidhjet e drejpërdrejta me Zoom, Viber, SRT, RTMP, Facebook, Youtube etj.

TRANSMETIMET DHE LIDHJET	
TRANSMETIME ME FIBËR OPTIK	103
TRANSMETIME ME 4G & Multisim	2837
VIBER, ZOOM	545
TRANSMETIME SRT, RTMP STREAM	852
TRANSMETIME SATELITORE	143
TRANSMETIME ME SNG	4
TOTAL	4482

Kjo njësi ka mundësuar transmetimet e drejtpërdrejta nga i tërë territori i Kosovës duke përdorur rrjetin 4G të operatorit Vala dhe pjesërisht rrjetin e Ipko-së, ndërsa në vendet ku kemi infrastrukturë me fibër kemi transmetuar me kablo optike.

Është bërë pranimi i sinjaleve satelitore për transmetimin e ndeshjeve të kombëtareës së Kosovës në UEFA Nations League dhe në kualifikimet për Botërorin 2026, transmetimet e ndeshjeve të UCL, UEL dhe UECL duke përfshirë magazinat javore dhe përmbledhjet ditore si dhe pranimi i sinjaleve të ndryshme ndërkombëtare. Dergimi i sinjaleve (feed) unilaterale ndërkombëtare me SRT apo RTMP stream për ngjarje sportive dhe programe të ndryshme me karakter ndërkombëtar.

Mbulimi me sukses i tre palë zgjedhjeve të mbajtura gjatë vitit 2025, transmetimet nga tereni gjatë fushatave parazgjedhore dhe ditës së zgjedhjeve parlamentare të mbajtura më 09 shkurt 2025, zgjedhjeve lokale në 12 tetor 2025, përfshirë edhe raundin e dytë të balotazhit si dhe zgjedhjet e parakohshme parlamentare të mbajtura më 28 dhjetor 2025. Ekipet e RTK-së kan realizuar tranmsetime direkte dhe kan dërguar materiale me FTP gjatë gjithë kohës së fushatave parazgjedhore dhe gjatë ditës së zgjedhjeve nga i gjithë territori i Kosovës.

Transmetimi i **Festivalit të tretë të këngës në RTK** , për shkak të kostos financiare këtë vit nuk është bërë transmetimi me uplink satelitor, transmetimi i cilësisë së lartë është bërë duke kombinuar rrjetat VPN Layer2, stream SRT si dhe rrjetin 4G Vala dhe Ipko.

Në baza ditore janë pranuar sinjale të ndryshme satelitore të dërguara nga EBU,EVN apo EBS, sinjale satelitore të ngjarjeve ndërkombëtare sportive, ngjarje të ndryshme kulturore, është bërë pranimi i sinjaleve të ndryshme nga terreni, sinjaleve ndërkombëtare, distribuimi i sinjaleve nga studio dhe delegimi i tyre në të gjitha regjitë e kanaleve, në Ingest room për rekordim dhe në Master Control Room.

Kjo njësi ka realizuar shpërndarjen dhe monitorimin e programit të RTK1, RTK2, RTK3 dhe RTK4 në rrjetet e kompanive kabllore, distribuimin e RTK1 në rrjetin tokësor përmes KTTN-së, mirëpo me mbulueshmëri jo të knaqshme dhe cilësi të dobët të sinjalit (formati SD) për shkak të vjetërsisë dhe amortizimit të rrjetit transmetues tokësor. Mirëmbajtja e rrjetit është vështirësuar shumë për shkak të mungesës së pjesve rezervë të pajisjeve ekzistuese dhe jemi i vetmi vend në rajon që ende nuk kemi digjitalizuar rrjetin transmetues tokësorë.

Varësisht nga kërkesat programore, janë dërguar sinjalet direkte dhe janë bërë transmetimet e ngjarjeve në platformat e RTK-së siç janë Facebook dhe Youtube. Njësia e transmetimit dhe lidhjeve e mirëmban sistemin e këmbimit të materialeve me EBU përmes IP serverit që mundëson qasje në ato materiale nga rrjeti i brendshëm i RTK-së. Kjo njësi ka raportuar mungesë të një tekniku në transmetim dhe lidhje dhe për këtë arsye stafi angazhohet jashtë orarit të rregullt.

Puna në këtë njësi kryhet me dy turne, nga e hëna në të premten prej orës 06:30 deri në ora 00:00, ndërsa të shtunën dhe të dielën nga ora 7:30 deri në 23:30. Në mungesë të stafit teknik, në rastet kur kemi kërkesa programore për më shumë transmetime direkte, atëherë angazhohen stafi edhe në punë jashtë orarit.

NJËSIA E TEKNOLOGJISË MOBILE

Njësia e teknologjisë mobile në kuadër të TV Teknologjisë e ka kryer punën duke organizuar, planifikuar, mbikëqyrur procesin e punës në aspektin teknik, si dhe duke pasur nën përgjegjësi funksionimin e të gjitha pajisjeve teknike në OB-VAN, dron dhe ENG kamera. Varësisht nga natyra e programit janë bërë përgatitjet teknike sipas kërkesave të regjisorit dhe producentit, pas çdo xhirimi pajisjet teknike janë risistemuar nëpër vendet e tyre në OB-VAN.

Gjatë vitit 2025 janë realizuar këto xhirime me OB-van dhe dron si në vijim:

XHIRIMET ME DRON DHE OBVAN	
DRON	60
OBVAN	177
TOTAL	237

Me OB-van janë xhiruar të gjitha programet dhe eventet e ndryshme kulturore, argëtuese, politike, programet festive për Vitin e Ri 2026 si në studio ashtu edhe jashtë studiove të RTK-së. Për realizimin e ndeshjeve sportive të futbollit të klubit FC Drita, në kuadër të garave të UECL, meqë RTK nuk ka kapacitete teknike të përcaktuara sipas kritereve të UEFA, kemi angazhuar produksion të jashtëm për realizimin e ndeshjeve të tilla të cilat janë mbajtur në stadiumin Fadil Vokrri në Prishtinë. Po ashtu edhe realizimin teknik të Festivalit të tretë të këngës në RTK e kemi bërë me produksionin e njejt sipas standardeve dhe kërkesave të festivalit duke përdorur 11 studio kamera dhe pajisje tjera të nevojshme përcjellëse.

NJËSIA E TEKNOLOGJISË SË STUDIOS

Njësia e teknologjisë së studios i ka kryer obligimet e veta duke ofruar kushtet teknike për prodhimin e programit në studiot e RTK-së, si dhe duke u kujdesur për funksionimin e të gjitha pajisjeve të instaluara në studio, të nevojshme për realizimin e punëve. Kjo njësi është përkujdesur për funksionimin e tërë zingjirit të

prodhimit në studio, përfshirë studio kamerat, tripodat, zërimin e studiove, zërimin e dhomave të regjisë, funksionimin e videomikerëve, audiomikserëve, lidhjeve telefonike për komunikim gjatë transmetimeve direkte, funksionimin e pajsijeve të skenografive siq janë videoëallët, monitorët e ndryshëm, konfigurimin e tyre dhe dergimin e sinjaleve të ndryshme përmes aux në të gjithë monitorët e studiove. Përkujdesi për aspektin teknik të dhomave të komentimit dhe përkthimeve simultane në të dy studiot. Gjithashtu inxhinierët janë përkujdesë për cilësinë e audio-video sinjalit që prodhohet apo që reprodukohet në studio, duke siguruar që sinjali final nga studio të dërgohet pa humbje në capture, ingest, TX dhe MCR.

Në STUDIO 1: Është realizuar programi i rregullt dhe i drejtpërdrejtë i kanalit RTK3 me kamerat PTZ, përfshirë të gjitha edicionet e lajmeve dhe emisionet e ndryshme si dhe të gjitha komentimet dhe përkthimet simultane të cilat janë mundësuar nga dhoma e përkthimit pranë galerisë së studios 1. Po ashtu nga regjia e studios janë insertuar grafikat e të gjitha tranmsetimeve direkte në RTK3.

Në STUDIO 2, realizimi i "Programit të Mëngjesit dhe "Programit të Pasditës", janë xhiruar emisionet e sportit për UCL, UEL, UECL, Nation League dhe janë komentuar të gjitha ndeshjet dhe eventet sportive nga regjia e kësaj studioje. Pastaj xhirimi i emisionit "Voyage","Sens", realizimi i programit zgjedhor për zgjedhjet parlamentare, zgjedhejt lokale, balotazhet dhe zgjedhjet e parakohshme parlamentare 2025. Realizimi i programit është bërë me katër kamera, përfshirë edhe kranin. Gjatë kësaj kohe stafi teknik kanë kryer të gjitha punët teknike për funksionalizimin e videoëallve, kamerave, zërimit dhe të gjitha pajisjeve teknike në studio, regji dhe në dhomat e përkthimeve simultane apo komentimeve. Në mungesë të pjesëve rezervë për shkak të amortizimit të pajisjeve dhe në mungesë të investimeve kapitale, në gjysmen e dytë të vitit 2025 në stduion nr.2 kemi funksionuar pa konsolen e ndriqimit, që shkakton kufizime dhe mungesë kerativiteti në punën e ndriqimit të skenografive.

Në STUDIO 3, Duke ju falenderuar ndihmës nga Instituti Gothe dhe DË Akademi, kemi funksionalizuar dhomën e regjisë dhe dy skenografitë në studion nr.3 të emisioneve "Ne", dhe "RTK GREEN", po ashtu në këtë studio xhirohet edhe emisioni "Arkivi". Donacioni përfshinë skenografitë e dy emisioneve dhe pajisje për dhomën e regjisë: videomikser, audio mikser, mikrofona ajrorë, video rekorder, , sistem interkomi pa tela, monitor touch screen për studio, monitor për multivieë dhë të gjitha pajisjet përcjellëse. Aktualisht xhirimet në këtë studio realizohen me kamerat e OB-van, pasi që RTK ende nuk ka siguru mjetet financiare për blerjen e kamerave të studios.

STUDIO REGJIONALE NË PRIZREN është funksionale dhe aktive me dhomën e regjisë, tri kamera PTZ të studios, dy njësi montazhi, dy kamera të terenit dhe encoder për transmetime të drejtpërdrejta. Pra, nga kjo zyrë regjionale realizohen xhirime të rregullta brenda dhe jashtë studios. Stafi i zyrës janë angazhuar vazhdimisht në mbulimin e të gjitha ngjarjeve dhe aktiviteteve të ndryshme në qytetin e Prizrenit me rrethinë. Materialet e xhiruara, barten në sistem, montohen dhe transferohen në FBPS.

STUDIO REGJIONALE NË MITROVICË është funksionale dhe aktive me dhomën e regjisë, një njësi montazhi, dy kamera të terenit dhe encoder për transmetime të drejtpërdrejta. Pra, edhe nga kjo zyrë mund të realizohen xhirime brenda dhe jashtë studios. Gjatë tërë vitit është bërë mbulimi i ngjarjeve dhe raportimet e drejtpërdrejta nga Mitrovica e jugut dhe nga komunat veriore të Kosovës. Një pjesë e stafit të studios vazhdojnë të angazhohen në Prishtinë gjatë kohës kur nuk kanë aktivitete në studion rajonale.

Projekti i përbashkët mes RTK dhe JICA, gjatë vitit 2025 në bashkëpunim me ekspertet e JICA kemi punuar në projektin e zyrës regjionale në Pejë. Kemi specifikuar të gjitha kërkesat teknike sipas mundësive dhe planifikimeve buxhetore të JICA-së. Në projekt janë përfshirë pajsije për zyrën rajonale në Peje, pajisje të domosdoshme për përditësim të njesisë së transmetimit në RTK në mënyrë që të mundësohet integrimi dhe pranimi i sinjaleve direkte nga kjo zyrë si dhe pajisje teknike për përditësim të kanalit RTK2, ngase ka kaluar

kohë e gjatë dhe janë amortizuar tejmase pajisjet ekzistuese. Me mbështetjen e komunës së Pejës është përcaktu objekti ku do të vendoset zyra e RTK-së në Pejë. Në koordinim të plotë me JICA, kemi dizajnuar projektin për funksionalizim të hapësirave, përfshirë dhomën e gazetarve, studion, dhomën e regjisë dhe njesinë e montazhit. Pas miratimit nga JICA të listës së pajisjeve dhe specifikimeve teknike dhe propozimet e bëra nga ne, JICA ka inicuar të gjitha procedurat tenderuese në Japoni për blerjen e pajisjeve. Në tetor 2025 ka arritur kontigjenti i parë i pajisjeve të cilat janë konfiguruar nga inxhinierët e TV Teknologjisë dhe janë instaluar menjeherë në njësinë e transmetimit dhe lidhjeve dhe jemi në pritje të kontigjentit të dytë që pritet të arrijë në fillim të vitit 2026. Kemi inicuar kërkesën për renovim të hapësirave punuese, përfshirë ndarjet me mure knaufi, montimin e dyrve, vendosjen e platformës për mbajtjen e trupave ndriques dhe izolimin akustik të studios.




Fig.1 Plani i zyrës rajonale në Pejë

MIRËMBAJTJA DHE E ZHVILLIMI

Njësia e mirëmbajtjes dhe e zhvillimit Kjo njësi kryen mirëmbajtjen e pajisjeve teknike për të gjitha kanalet e RTK-së, përfshirë pajisjet e studiove, kamerat në studio, videomikserët, audiomikserët, kamerat e terrenit, video monitorët, tv, pajisjet e audios, pajisjet e teknologjisë informative si dhe pajisjet e energjetikës si UPS dhe kondicioneri ka kryer mirëmbajtjen e pajisjeve teknike. Inxhiniri i mirëmbajtjës është përkujdesur për funksionimin e të gjitha pajisjeve në studiot e RTK1, RTK3 dhe studiot regjionale, si dhe janë kontrolluar

vazhdimisht kamerat, kabllot optike të kamerave, friksionet e tripodave me aksesorë, dëmtimet eventuale të kabllove. Kemi mungesë të stafit në këtë njësi, aktualisht vetëm një inxhinier i mirëmbajtjes kryen të gjitha punët rreth mirëmbajjes dhe servisimit të pajisjeve në televizion.

NJËSIA E ENERGJETIKËS

Gjatë vitit 2025 **njësia e energjetikës** është kujdesur për mirëmbajtjen e sistemit elektrik të objekteve, të studiove, të hapësirave të përbashkëta, gjeneratorëve, UPS-ve dhe të stabilimenteve të tjera furnizuese me energji elektrike. Edhe gjatë këtij viti ka pasur ndërpreje të shpeshta të energjisë elektrike nga rrjeti i qytetit, andaj në këto raste furnizimi me energji elektrike është bërë nga gjeneratorët. Po ashtu është bërë furnizimi me derivate sipas kërkeses së njesisë së energjetikës. Në mungesë të një UPS 315kVA, ndërprerjet e shpeshta të energjisë elektrike po shkaktojnë probleme teknike për shkak të nderprerjeve të dhunshme dhe të pakontrolluar të pajisjeve. Megjithatë kemi bërë disa intervenime në sistemin ekzistues duke kyqur në UPS modular njesinë e Ingest dhe dhomën teknike të IT e cila gjindet në katin e tretë të ndërtesës së RTK-TV.
Nga stafi i energjetikës është kryer servisimi i rregullt i gjeneratorëve, siq janë ndërrimi i vajit dhe filterave të gjeneratorëve 315kvA dhe 125 kvA ne RTK-TV, 315kVA në Aneks, po ashtu servisimi i gjeneratorit të OB-van për shkak të dëmtimit të ftohësit si rezultat i amortizimit dhe rrjedhjes së ujit. Si në vitet paraprake edhe këtë vit stafi energjetikës së RTK-TV kan kryer edhe servisimin e gjeneratorëve në objektin e RTK-Radio.
Gjatë këtij viti është bërë zëvendësimi i ndarësit kryesor të rrjetit dhe gjeneratorëve, duke e zgjidhur kështu problemin e ndërprerjeve të shpeshta që shkaktoheshin si rezultat i amortizimit të ndarësit automatik. Punimet janë kryer gjatë ndrrimit të natës, duke nderprerë gjithë furnizimin e objektit me energji elektrike përveq dhomës së server room dhe MCR.
Në mënyrë permanente është bërë mirëmbajtja e instalimit elektrik dhe klimatizimit në baza ditore, janë pastruar filterat, njesitë e jashtme dhe të brendshme të kondicionerëve ekzistues. Sistemi kanalor i klimatizimit në studion nr2 është jo funksional, për shkak të amortizimit dhe nuk mund të riparohet. Në mungesë të mjeteve financiare për investim në sistem të ri klimatizimi, kemi zhvendosur një kondicioner nga studio nr.5 e cila nuk ka qenë jo funksionale gjatë kësaj kohe dhe kemi zgjidhë pjesërisht problemin e temperaturave të larta që po shkaktohen në studio gjatë xhirimeve.
Gjithashtu me kerkesë të menaxhmentit kemi bërë një listë të furnizimit me kondicionerë në studio, në hapësira të punës, në zyre si dhe një listë për servisimin e kondicionerve ekzistues. Nga Adimistrata e RTK-së është bërë shpallja publike për shprehje të interesit nga kompanitë e interesuara për kompensim me marketing, mirëpo nuk ka pasur interesim apo ndonjë ofertim konkret.
Stafi energjetikës ka kontribuar në mënyrë të vazhdueshme përgaditjet e studiove dhe ambienteve të ndryshme për xhirimin e programeve festive të RTK-së. Angazhimi dhe përkujdesi për gjithë furnizimin me energji e

Është bërë kontrollimi dhe mirëmbajtja e regullt e instalimit elektrik në gjithë objektet e RTK-së, është bërë ndërrimi i trupave ndriçues nëpër hapësira teknike të punës, zyre, korridore, tualete sipas nevojave. Konsola e ndriqimit të studios 2 është jashtë funksionit për shkak të vjetërsisë dhe në mungesë të pjesve rezervë andaj aktivizimi i ndriqimit të studios nr.2 vazhdon të bëhët në mënyrë manuale, deri në investimet që janë planifikuar në sistem të ndriqimit për vitin 2026.

Për shkak të dëmitimit të rezervarit të naftës së ngrohjes qëndrore, me kerkesë të udheheqësit të logjistikës, kemi mundësuar kyqjen në rezervarët e naftës së gjeneratorëve për furnizim të ngrohjes qendrore e cila

përodret për ngrohjen e objektit të RTK-TV. Meqë kapaciteti i naftës në këta rezervar është e limituar, atëhere kjo kyqje do të jet e perkohshme deri në zgjidhjen e problemit me rezervarin e ngrohjes qendrore.

Njësia energjetikës operon me tri ndërrime të punës, përfshirë edhe kujdestarinë 24/7 e cila është e domosdoshme për shkak të sistemit të vjetër elektroenergjetik të objekteve, furnizimin nga tre gjeneratorë të ndryshëm dhe sistemin e decentralizuar të UPS-ve.

Në Njësinë e Logjistikës gjatë vitit 2025 janë kryer këto detyra:

Është bërë koordinimi dhe mbikëqyrja e aktiviteteve dhe ecurisë së punës që kanë qenë të planifikuara, identifikimi dhe zgjidhja e problemeve në të gjitha njësitë, si dhe monitorimi i mirëmbajtjes së objektit (pastërtisë). Gjithashtu është bërë monitorimi i mirëmbajtjes së veturave zyrtare, duke përfshirë regjistrimin e rregullt, sigurimin, kontrollimin teknik, mirëmbajtjen dhe servisimin e tyre.

Është bërë kontrollimi i shpenzimeve për mallrat e nevojshme, siç janë: derivatet për vetura, derivatet për gjenerator, derivatet për ngrohjen qendrore, si dhe shpenzimet për ujë dhe mbeturina për RTK1.

Gjithashtu është bërë vlerësimi i vazhdueshëm i punëtorëve në sektorin e autoparkut dhe të mirëmbajtjes (shtëpiakut/mirëmbajtësit). Raportimi është bërë në baza mujore për ecurinë e punës, si dhe për shpenzimet në Njësinë e Logjistikës, duke përfshirë edhe kontratat e RTK-së me operatorët ekonomikë.

II. Udhëheqësi i Autoparkut

Udhëheqësi i Autoparkut ka mbikëqyrur aktivitetet dhe ecurinë e punës në Autopark, të cilat kanë qenë të planifikuara. Ai ka identifikuar dhe zgjidhur problemet në njësinë përkatëse dhe ka bërë vlerësimin e vazhdueshëm të punëtorëve të njësisë së Autoparkut.

Gjithashtu ka verifikuar nëse vonesat e veturave gjatë qëndrimit në terren kanë qenë si rezultat i ndonjë aksidenti në trafik apo i ndonjë prishjeje teknike. Ka bërë rishikimin e kilometrazhit në përputhje me sasinë e naftës së shpenzuar dhe është angazhuar për shfrytëzimin racional të kapaciteteve të burimeve njerëzore.

Ka kontrolluar në baza ditore automjetet dhe, për çdo dëmtim eventual, ka përpiluar raport të rregullt me shkrim mbi gjendjen në Autopark në RTK. Ka njoftuar me kohë për afatet e regjistrimit të rregullt, kontrollimit teknik dhe servisimit të veturave zyrtare.

Gjithashtu është koordinuar vazhdimisht me kryeredaktorin dhe redaktorin e ditës për shërbimet e transportit, në mënyrë që ecuria e punës të jetë sa më produktive.

Vlen të theksohet se, përkundër vështirësive që janë hasur gjatë procesit të punës për shkak të mungesës së stafit, është arritur që të përmbushen shumica e kërkesave në nivel të RTK-së, sidomos ato që kanë qenë prioritare, si: shërbimet për Dhomën e Lajmeve, përgatitjet për Festivalin në RTK dhe përgatitja e programit të Vitit të Ri.

Vozitësit/et

Vozitësit kanë bërë bartjen e ekipeve në terren me vetura zyrtare, shpërndarjen e materialeve dhe shkresave të ndryshme sipas nevojave dhe kërkesave të shërbimeve të ndryshme brenda RTK-së.

Ata janë përkujdesur për mirëmbajtjen e veturave zyrtare, siç janë: kontrollimi i vajit të motorit, ujit dhe mirëmbajtja e përditshme e automjeteve. Gjithashtu kanë bërë dërgimin e veturave në servis me kërkesë të Udhëheqësit të Autoparkut dhe janë përkujdesur për lajmërimin me kohë për skadimin e regjistrimit dhe sigurimit të veturave zyrtare.

Kanë qenë të përgjegjshëm në shfrytëzimin racional të derivateve. Raportimi me shkrim është bërë në baza ditore për gjendjen e automjeteve zyrtare, kur ka pasur nevojë.

Po ashtu, janë angazhuar edhe jashtë orarit të punës, sidomos gjatë përgatitjeve për Festivalin në RTK dhe programin e Vitit të Ri.

Në terren kanë bërë bartjen e ekipeve të redaksive të ndryshme, si: Dhoma e Lajmeve, redaksia e programeve, redaksia e dokumentarëve, redaksia e kulturës, redaksia e sportit, si dhe redaksitë e programeve të minoriteteve, si: boshnjake, ashkalike, rome, serbe, turke, gorane etj.

Vozitësit kanë arritur të përmbushin objektivat e punës dhe kanë treguar aftësi dhe cilësi profesionale në përputhje me përshkrimin e vendit të punës.

Mirëmbajtja higjienike e objekteve të RTK-së

Nga fillimi i vitit 2025, mirëmbajtja higjienike e objekteve të RTK-së është bërë nga kompania **“DOUBLE SH.P.K.”**, me të cilën RTK ka lidhur marrëveshje kontraktuale për mirëmbajtjen higjienike të objekteve.

Mirëmbajtësi / Shtëpiaku

Mirëmbajtësi ka mirëmbajtur ndërtesën në të cilën është i sistemuar, duke përfshirë edhe aneksin me të gjitha zyrat dhe studiot.

Ai ka kryer të gjitha punët fizike të nevojshme, si: riparime të ndryshme, rregullimin dhe mirëmbajtjen e nyjeve sanitare, gypave të ujësjellësit dhe kanalizimit në ndërtesë. Po ashtu ka riparuar dhe mirëmbajtur prishjet në inventarin e ndërtesës dhe është përkujdesur në baza ditore për sistemin e ngrohjes qendrore.

Është kujdesur për lajmërimin me kohë për furnizimin me naftë për ngrohje, për mirëmbajtjen e oborrit dhe pjesëve të aneksit. Gjithashtu ka asistuar në bartjen e orendive të zyrave dhe është përkujdesur që me kohë të njoftojë për të gjitha prishjet dhe t’i evitojë ato në bashkëpunim me kolegët e njësisë.

Ai u është përgjigjur thirrjeve të sektorëve për të asistuar në punë të ndryshme dhe ka asistuar si vozitës në Njësinë e Autoparkut dhe në Skenografi për rregullimin e skenës për Festivalin e RTK-së, si dhe gjatë xhirimeve të programit të Vitit të Ri.

Përdorimi total i karburantit

Totali mujor dhe vjetor:

Tabela përmban sasinë e litrave të karburantit për çdo muaj dhe totalin mujor për çdo veturë. Një total vjetor është llogaritur për të pasqyruar përdorimin e përgjithshëm të karburantit gjatë vitit 2025.

Shpenzimet e derivateve për periudhën: Janar – Dhjetor 2025.

Raport Shpenzimet e derivateve për perjudhën Janar - Dhjetor 2025

Nr.	Targa e vetures	Org.	Lista e vozitësave të ngarkuar me vetura zyrtare	Sasia e litr. Janar '25	Sasia e litr. Shkurt '25	Sasia e litr. Mars '25	Sasia e litr. Prill '25	Sasia e litr. Maj '25	Sasia e litr. Qershor '25	Sasia e litr. Korrik '25	Sasia e litr. Gusht '25	Sasia e litr. Shtator '25	Sasia e litr. Tetor '25	Sasia e litr. Nentor '25	Sasia e litr. Dhjetor '25	Totali sipas vozitësave,dh e veturave
1	**01-260-MR**	TV 1	Drejtoria	54.97	55.23	54.13	175.03	107.02	125.73	122.74	112.84	111.28	106.37	117.62	100.60	**1,243.56**
2	**01-896-CE**	TV 1	Gashi	66.70	71.77	94.47	93.52	43.90	106.81	64.66	0.00	66.13	48.00	0.00	152.86	**808.82**
3	**01-461-NA**	TV 1	Gazmend Gashi	114.19	64.16	178.94	160.76	133.65	90.39	125.74	107.91	169.97	173.53	185.96	150.10	**1,655.30**
4	**01-672-NE**	TV 1	Rezhepi	167.46	45.03	50.91	209.95	50.74	88.25	178.95	134.62	191.39	218.36	215.67	162.60	**1,713.93**
5	**01-673-NE**	TV 1	Sejdi Ilazi	114.11	121.83	111.57	119.06	88.28	83.66	168.02	115.92	95.46	151.65	113.40	217.38	**1,500.34**
6	**01-990-BI**	TV 1	Krasniqi/kamer	51.56	32.00	64.29	39.10	27.05	0.00	55.12	31.00	0.00	77.03	0.00	50.00	**427.15**
7	**01-574-NA**	TV 1	Fatmir Shabani	128.95	57.69	93.39	73.35	109.51	64.97	115.34	60.12	137.39	144.62	74.63	142.22	**1,202.18**
8	**01-860-MT**	TV 1	Nermin Jaha	120.54	89.61	78.85	172.30	79.57	105.77	121.64	105.00	105.02	136.87	139.98	146.26	**1,401.41**
9	**01-458-NA**	TV 1	Latif.S.L.Xhoci	127.73	125.08	39.71	78.76	192.92	107.37	140.00	157.10	110.53	136.53	0.00	144.97	**1,360.70**
10	**01-531-CZ**	TV 1	Ismet Berisha	121.38	132.68	127.47	141.21	163.79	79.77	134.27	106.81	111.12	167.21	166.85	83.37	**1,535.93**
11	**01-462-NA**	TV 1	Latif Rexhepi	221.12	125.58	95.22	168.51	154.51	182.94	104.19	82.33	157.65	190.32	67.42	104.72	**1,654.51**
12	**01-463-NA**	TV 1	Shishmek	78.93	102.24	68.33	113.04	126.23	77.53	117.91	76.75	114.60	81.00	71.32	107.08	**1,134.96**
13	**01-465-NA**	TV 1	Neki Mustafa	116.13	116.28	86.68	65.53	79.89	96.29	132.77	98.70	149.72	153.23	162.49	148.50	**1,406.21**
14	**01-474-NA**	TV 1	Bardh Bekteshi	39.01	41.17	0.00	0.00	41.81	120.80	0.00	43.41	40.83	0.00	35.72	68.25	**431.00**
15	**01-476-NA**	TV 1	Zymber Leci	142.68	99.77	70.66	68.38	83.44	97.96	124.58	92.63	139.54	178.11	150.03	115.66	**1,363.44**
16	**01-895-CE**	TV 1	ngarkuar	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	39.68	39.68	0.00	**79.36**
17	**01-577-AH**	TV 1	ngarkuar	0.00	0.00	0.00	70.92	0.00	0.00	0.00	0.00	49.12	39.68	0.00	0.00	**159.72**
18	**01-745-EP**	TV 1	ngarkuar	0.00	60.82	49.20	0.00	47.33	0.00	0.00	0.00	0.00	62.29	0.00	63.60	**283.24**
19	**01-668-AH**	TV 1	Islam Haaxhiu	115.98	114.22	113.64	119.85	123.96	121.10	117.50	118.74	120.00	120.98	117.52	116.89	**1,420.38**
20	**05-534-AT**	TV 1	Ramadani	61.96	37.59	37.59	78.38	40.98	37.88	38.10	38.76	39.68	39.68	38.46	61.90	**550.96**

VI.Përdorimi Total i Karburantit:

Tabela përmban sasitë e litrave të karburantit për totalin vjetor. Një total vjetor është llogaritur përdorimi total të karburantit për nxemje dhe gjenerator/agregatin për vitin 2025.

Kuponi	Data	Tipi	Emri dhe mbiemri	Përshkrimi	Sasia/Liter
01313	03/02/2025	Nxemje	Fitim Avdullahu	Nafte Eurodiezel 10 PPM	4800
01974	09/10/2025	Nxemje	Fitim Avdullahu	Nafte Eurodiezel 10 PPM	2600
03837	12/12/2025	Nxemje	Fitim Avdullahu	Nafte Eurodiezel 10 PPM	1950
01973	09/10/2025	Gjenerator	Fejsal Shashivari	Nafte Eurodizel 10 PPM	2000
01368	06/11/2025	Generator	Ilir Vula	Nafte Eurodizel 10 PPM	910
03836	12/12/2025	Gjenerator	Ilir Vula	Nafte Eurodizel 10 PPM	2001
				Total Litra	14261

MBROJTJA DHE SHPËTIMI – RAPORT VJETOR 2025

Njësia e Mbrojtjes dhe Shpëtimit, në bashkëpunim me kompaninë e sigurimit fizik “Skyfterat-Live” (deri më datë 18.06.2025, kur ka përfunduar kontrata) dhe me kompaninë “Jaguar Security” (e cila ka filluar kontratën nga data 01.10.2025), gjatë vitit 2025 ka kryer detyrat duke u kujdesur për sigurinë në të gjitha hapësirat e RTK-TV. Kemi pasur bashkëpunim të mirë me producentët, të cilët rregullisht kanë njoftuar për të ftuarit në RTK.

Sipas Njësisë së Mbrojtjes dhe Shpëtimit, gjatë vitit 2025 në RTK kanë hyrë gjithsej 5300 persona: 3380 mysafirë të ftuar në emisione, 1400 mysafirë në zyra dhe për vizita në objekt, si dhe 520 mysafirë në bufe.

Në këtë raport vjetor paraqes një përmbledhje të raporteve mujore gjatë vitit 2025.

Edhe gjatë vitit 2025 kemi pasur probleme teknike dhe teknologjike me pajisjet me të cilat punojmë në recepsion, duke filluar nga kompjuterët ku mbajmë evidencat, të cilët janë të një teknologjie të vjetër dhe nuk funksionojnë mirë, si dhe me sistemin e alarmit kundër zjarrit dhe sistemin e kamerave të sigurisë, i cili funksionon vetëm pjesërisht dhe është i një cilësie shumë të dobët.

Sa i përket aparateve kundër zjarrit dhe hidrantëve, ato janë servisuar vetëm një herë gjatë vitit 2025 (16.01.2025) nga kompania e kontraktuar “Besarti-KZ”, e cila ka përfunduar kontratën më 16.07.2025. Kam bërë kërkesë në prokurim për angazhimin e një kompanie tjetër, por sipas zyrtarëve të prokurimit, për shkak të mungesës së buxhetit, kërkesa nuk ka kaluar. Momentalisht, aparatet kundër zjarrit janë pa servisim dhe të stërvjetruara.

Sektori i Mbrojtjes dhe Shpëtimit, prej datës 18.06.2025 deri më datë 01.10.2025, për tre muaj rresht ka funksionuar me një numër të kufizuar të punëtorëve të brendshëm të RTK-së. Për një muaj, punën në dy pika e kemi mbajtur unë (Elez Hajzeri), Nazmi Gashi, Ahmet Islami dhe Lulzim Shala. Më pas kemi angazhuar edhe tre punëtorë me kontrata për shërbime (nga jashtë): Muhamet Istogu, Nebi Bekteshi dhe Bastri

Bajraktari – punëtorë që kanë punuar edhe më herët në RTK. Ndërsa nga data 01.10.2025 kemi lidhur kontratë njëvjeçare me kompaninë e sigurimit fizik “Jaguar Security”.

Gjatë vitit 2025 veçoj disa raste problematike: kërcënime, tentim për sulm fizik ndaj drejtorit të RTK-TV-së, z. Rilind Gërvalla, si dhe një zjarr.

Më 10.01.2025, shoferi Lorik Gjoci përmes një SMS-i ka ofenduar dhe sharë në telefonin e drejtorit Gërvalla. Menjëherë janë marrë masa disiplinore ndaj tij.

Më 13.10.2025, gazetari Korab Lecaj ka kërcënuar ushtruesin e detyrës së drejtorit të përgjithshëm, z. Hysen Hundozi, me SMS. Gjithashtu, ai ka tentuar ta sulmojë fizikisht drejtorin Gërvalla në shkallët e koridorit, në prezencën time. Korab Lecaj i është vërsulur drejtorit, duke përdorur ton të lartë dhe fjalë banale, sharje dhe kërcënime të ndryshme. Unë kam reaguar menjëherë duke e parandaluar sulmin fizik dhe e kam larguar gazetarin Lecaj nga objekti, duke e shoqëruar deri jashtë portës. Edhe për këtë rast janë marrë masa disiplinore dhe është njoftuar policia, ku edhe unë kam dhënë deklaratë.

Më 25.06.2025 ka shpërthyer një zjarr në kuzhinën e bufesë së RTK-së, me pronar Rexhep Zeka, si pasojë e moskujdesit të kuzhinierit, i cili e kishte lënë vajin të digjej për një kohë të gjatë. Zjarri është përhapur dhe bufeja është përfshirë nga tymi dhe flakët. Menjëherë kemi telefonuar zjarrfikësit dhe policinë dhe kemi intervenuar shpejt, së bashku edhe me shumë kolegë të tjerë, duke arritur ta shuajmë zjarrin. Nuk kanë vonuar shumë dhe në RTK kanë mbërritur zjarrfikësit, policia dhe KEDS-i. Ata kanë kontrolluar bufenë në detaje dhe kanë zbuluar se ku ishte problemi. Kuzhinieri është shoqëruar në stacion policor për të dhënë deklaratë.

Ndryshe, vitin 2025 e kanë karakterizuar edhe disa probleme që na kanë sjellë vështirësi si institucion. Së pari, rrëzimi i drunjve në rrugën “Xhemajl Prishtina”, që ka shkaktuar dëmtime në rrjetin e energjisë elektrike dhe ka bllokuar rrugën për orë të tëra. Së dyti, djegia e dhjetëra lokaleve afër RTK-së, në rrugën “Ilaz Agushi”, rast që përsëri ka bllokuar rrugën, kësaj here totalisht, duke ua pamundësuar kalimin edhe punëtorëve të RTK-së.

Gjatë vitit 2025 në RTK dy herë kemi lajmëruar ambulancën, pasi dy kolege nga RTK-1 dhe RTK-2 nuk janë ndjerë mirë me shëndet. Atyre u kemi ofruar ndihmë dhe i kemi shoqëruar deri te ambulanca.

Prej datës 13.10.2025, ekipi i Festivalit të Këngës ka filluar provat në RTK-Aneks, në studion 3. Nga data 02.11.2025 deri më datë 09.11.2025, sektori i Mbrojtjes dhe Shpëtimit ka qenë i angazhuar në Pallatin e Rinisë, ku është mbajtur Festivali i Këngës. Për shtatë netë radhazi jemi kujdesur deri në mëngjes për pajisjet teknike të transmetimit, të cilat kanë qenë të vendosura në parkingun prapa Pallatit. Në datat 06, 07 dhe 08 kemi qenë të angazhuar maksimalisht në hyrje-dalje dhe në sallë, duke bashkëpunuar me Policinë e Kosovës, e cila na ka përkrahur dhe ndihmuar në të gjitha aspektet, sidomos në atë të sigurisë.

Në vitin 2025, Kosova ka mbajtur tri palë zgjedhje. Gjatë kësaj periudhe RTK ka pasur numër të konsiderueshëm mysafirësh të ftuar nëpër debate televizive. Ne, si sektor, i kemi pritur, shoqëruar dhe jemi kujdesur për sigurinë gjatë mbajtjes së debateve, duke bashkëpunuar ngushtë me producenten Afërdita Peci. Vlen të theksohet se falë angazhimit dhe bashkëpunimit nuk kemi pasur asnjë problem.

Në nëntor të vitit 2025, SPERTK ka organizuar disa protesta për shkak të mosndarjes së mjeteve buxhetore për RTK-në. Ndërsa për katër ditë rresht punëtorët e RTK-së kanë qenë në grevë për disa orë gjatë ditës. Gjatë kësaj kohe jemi kujdesur të identifikojmë portalet dhe mediat e tjera që kanë qenë prezente sa herë ka pasur protestë dhe grevë.

RTK-në gjatë vitit 2025 e kanë vizituar 11 shkolla (nga niveli fillor, i mesëm dhe universitar), me rreth 424 nxënës dhe studentë dhe 28 mësimdhënës.

Gjithashtu, në RTK kemi pritur dhe përcjellë në mënyrë profesionale një numër të madh vizitash të rëndësishme, duke përfshirë delegacione të ndryshme, kryetarë komunash, ministra, deputetë, zëvendëskryeministren e Kosovës, ambasadorë të vendeve mike të Kosovës, drejtorin e Policisë së Kosovës, Avokatin e Popullit, zëvendëskryeministrin e Maqedonisë së Veriut, komandantin e KFOR-it Ozkan Ulutaş dhe kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti.

Përveç hyrje-daljeve, gjatë vitit 2025 kemi mbajtur evidencë edhe për veturat zyrtare që lëvizin pas orës 16:00. Të gjitha evidentohen nga sigurimi në detyrë.

Objektivat për vitin pasues

Sektori i Mbrojtjes dhe Shpëtimit, në bashkëpunim me sigurimin privat "Jaguar Security", edhe për vitin 2026 ka planifikuar të kryejë të gjitha shërbimet e recepsionit, pritjen e palëve, mysafirëve dhe delegacioneve të ndryshme, kujdesin për parkingun zyrtar, mbajtjen e evidencave, hartimin e raporteve, inspektimet nëpër objekte dhe, si pikë kryesore, çështjen e sigurisë.

Shpresojmë që gjatë vitit 2026, në bazë të buxhetit të planifikuar për sektorin tonë, të përmirësohen disa kushte të punës, me prioritet blerjen e sistemeve të reja të kamerave të sigurisë dhe aparateve kundër zjarrit. Gjithashtu shpresojmë të bëhet edhe instalimi i sistemit të ri të lajmërimit në rast zjarri.

Duke marrë parasysh interesin institucional dhe stabilitetin afatgjatë të RTK-së, kërkoj që gjatë vitit 2026 të shqyrtohet dhe të realizohet kalimi i shërbimit të sigurimit nga kompanitë e jashtme private në sigurim të organizuar nga stafi i brendshëm i RTK-së. Sigurimi i brendshëm do të garantonte vazhdimësi, përgjegjësi më të madhe dhe njohje më të mirë të institucionit, duke evituar problemet që vijnë nga kontratat afatshkurtra.

4.6 RTK4

Bazuar në skemën programore, raportet e punës, vijueshmërisë dhe pranisë në punë, ky vit mund të karakterizohet si një vit i mirë për kanalin RTK4 Art, edhe përkundër mungesës së burimeve njerëzore nga gjysma e vitit, çka ka ndikuar drejtpërdrejt në konkretizimin e plotë të punëve tona.

Krahasuar me vitin 2024, gjatë vitit 2025 ka pasur më shumë magazina kulturore dhe më shumë të ftuar, por është shënuar rënie e numrit të ngjarjeve nga fusha e muzikës dhe sportit.

Gjatë këtij viti, magazina informative kulturore "@RTKulturë", e realizuar nga redaksia e kanalit RTK4 dhe që transmetohet çdo ditë pune në RTK4 dhe RTK3, ka filluar të transmetohet në të njëjtën kohë edhe në RTK1.

Sipas raporteve mujore të punës, janë transmetuar 223 edicione të magazinës informative kulturore "@RTKulturë", me kohëzgjatje deri në 25 minuta, ku janë trajtuar ngjarjet ditore kulturore në vend, rajon dhe diasporë.

Të ftuar në "@RTKulturë" kanë qenë gjithsej 236 mysafirë, në studio dhe përmes videolidhjes. Prej tyre, 130 kanë qenë burra dhe 106 gra, të cilëve u është dhënë mundësia që, përmes kësaj magazine informative kulturore, të pasqyrojnë dhe promovojnë punën dhe veten e tyre në fusha përkatëse si kultura, arti, muzika dhe fusha të tjera me interes për publikun.

Magazina informative kulturore “@RTKulturë”

Emisione	Të ftuar	Burra	Gra
223	236	130	106

Më poshtë janë të listuara të gjitha ngjarjet nga kultura, arti, muzika dhe sporti, të transmetuara drejtpërdrejt në RTK4:

Festivale (4)

Netët e Klipit Shqiptar

Festivali Gjithëkombëtar “Eshkë e Ndezur mbi Shkëlzen”

Festivali “Kosovarja Këndon”

Festivali i Këngës në RTSH – Netët 1, 2, 3 dhe nata finale

Koncerte (1)

Mbrëmja artistike “Të zbardhi fytyrën”

Përurimi i librit / promovime (3)

Promovimi i monografisë “Riza Bicaj – Jeta dhe vepra e tij”

Promovimi i librit “Bjeshkëtaria në Kosovë”

Ndarja e çmimeve për teatër

Festat fetare (3) dhe 28 emisione fetare

Mesha festive në Katedrale – Krishtlindjet

Bajrami i Madh

Bajrami i Vogël

28 emisione me rastin e festës së Ramazanit

Një vend të rëndësishëm në skemën programore kanë zënë edhe ngjarjet sportive, megjithëse gjatë këtij viti kemi pasur më pak ngjarje sportive të transmetuara drejtpërdrejt në RTK4, krahasuar me vitin 2024.

Janë transmetuar drejtpërdrejt 24 ngjarje sportive me karakter nacional, kombëtar dhe ndërkombëtar.

Në kuadër të këtyre ngjarjeve janë transmetuar: shtatë (7) ndeshje futbolli, katër (4) ndeshje volejbolli, pesë (5) ndeshje hendbolli, katër (4) duele në futsall, dy (2) ngjarje në atletikë, një (1) në ragbi dhe një (1) në boks.

Më poshtë janë të listuara të gjitha ngjarjet sportive:

Futboll (7)

Futboll: Maqedonia e Veriut – Kosova (F)

Futboll: Norvegji – Itali (F)

Futboll: Angli – Spanjë (F), finalja

Magazina UEFA Champions League

Magazina e Conference League

Futboll: Shelburn – Drita

Futboll: Letoni – Kosovë (F)

Volejboll (4)

Volejboll: Ferizaj – Drita (M)

Volejboll: Fer Volley – Skenderaj (F)

Volejboll: Drita – Ferizaji

Volejboll: Ferizaji – Drita (M)

Hendboll (5)

Hendboll: Kosova – Ukraina

Hendboll: Suedia – Kosova

Hendboll: Kastrioti – Besa, finalja (M)

Hendboll: Istogu – Vushtrria, finalja (F)

Hendboll: Kosova – Ishujt Faroe

Futsall (4)

Futsall: Shqipëri – Danimarkë

Futsall: Kosovë – Bullgari

Futsall: Prishtina – Drenica, finalja

Futsall U19, gjysmëfinalja e dytë

Atletikë (2)

Kampionati Botëror i Atletikës

KOK – Laureatët 2024

Boks (1)

Boks: Meç ndërkombëtar

Ragbi (1)

Ragbi – Kampionati Evropian

Po ashtu, gjatë këtij viti, varësisht nga implikimet në skemën programore të RTK1, në RTK4 janë transmetuar edhe ngjarje nga aktualiteti, si:

Akademi përkujtimore (1)

Përvjetori i lindjes së Nënë Terezës

Përveç këtyre ngjarjeve të transmetuara drejtpërdrejt në RTK4, ne kemi vazhduar me mbulimin e pjesës tjetër të programit në kuadër të skemës programore, me produkte kryesisht të RTK1, si dhe materiale nga arkiva e RTK-së dhe RTP-së.

Objektivat dhe nevojat për vitin 2025

Të mundësohet përcjellja dhe transmetimi i drejtpërdrejtë i sa më shumë ngjarjeve nga kultura, arti, muzika dhe sporti, të cilat janë bazamenti i strukturës programore mbi të cilën është ndërtuar kanali.

Rritja e numrit të emisioneve javore me karakter kulturor nga fusha e artit, muzikës dhe kinematografisë.

Prodhimi i dokumentarëve që trajtojnë diversitetin kulturor, e në veçanti kulturën në trojet shqiptare.

Magazina kulturore të ketë studion e saj dhe të mos vazhdojë të xhirohet në studion e lajmeve.

Blerja e filmave artistikë për të gjitha grupmoshat, e në veçanti filmave të animuar dhe aventurë moderne për fëmijë.

Shtim i stafit, si gazetar/e, producent dhe përpilues të skemës programore, si dhe mbështetje teknike dhe teknologjike, në mënyrë që të realizohen kronika nga terreni për nevojat e magazinës informative ditore "@RTKulturë", pasi numri aktual i të angazhuarve në RTK4 është i pamjaftueshëm për të përmbushur nevojat programore.

4.7 Radio Kosova

Gjatë vitit 2025, dy kanalet e Radio Kosovës kanë zhvilluar një veprimtari intensive programore, informative, kulturore dhe digjitale, duke përmbushur rolin e saj si medium publik me shtrirje të gjerë dhe ndikim shoqëror.

Programi informativ dhe zgjedhor

Në fillim të vitit, redaksitë në gjuhën shqipe dhe të komuniteteve kanë mbuluar në mënyrë profesionale, objektive dhe të balancuar fushatën zgjedhore të janar-shkurtit, si dhe procesin e votimit. Gjatë vitit, Radio Kosova ka trajtuar vazhdimisht tema me interes publik, përfshirë çështje sociale, ekonomike dhe të grupeve të ndjeshme. Një fokus i veçantë i është kushtuar edhe zgjedhjeve parlamentare të 28 dhjetorit 2025, përmes kronikave, debateve, emisioneve speciale, lidhjeve të drejtpërdrejta nga terreni dhe angazhimit të redaksive në gjuhët e komuniteteve.

Programet speciale dhe përkujtimore

Radio Kosova ka realizuar programe të posaçme për data dhe ngjarje me rëndësi kombëtare e ndërkombëtare, si Dita Ndërkombëtare e Radios, Dita e Pavarësisë së Kosovës, Epopeja e UÇK-së, Dita e Mësuesit, Dita Ndërkombëtare e Gruas dhe Dita e Evropës. Program i veçantë tërëditor është realizuar edhe për 28 Nëntorin – Ditën e Flamurit, me angazhim të gazetarëve në terren në Kosovë dhe Shqipëri, duke sjellë diskutime, reflektime dhe analiza me të ftuar nga fusha të ndryshme.

Kultura, muzika dhe arti

Gjatë vitit 2025, Radio Kosova ka shtuar angazhimin në promovimin e muzikës, kulturës dhe artit. Një moment i rëndësishëm ishte nisja e transmetimit të këngëve të digjitalizuara nga shiritat magnetikë, duke rikthyer në eter një trashëgimi të çmuar muzikore. Po ashtu, janë mbuluar nga afër ngjarje të rëndësishme kulturore në vend.

Festivali i Këngës në RTK u transmetua më 6-8 nëntor, me intervista, analiza dhe mbulim të plotë të artistëve pjesëmarrës.

Festivali i Këngës në RTSH u mbulua në dhjetor nga një ekip special, duke përfshirë transmetime të drejtpërdrejta, intervista dhe raportime nga terreni.

Emisioni special për Eurovision 2025 u transmetua nga 12-16 maj, me disa ditë transmetim dhe dhjetëra intervista me artistë dhe njohës të muzikës.

Programi veror
Gjatë muajve korrik dhe gusht, në RK1 me “Vera me Radio Kosovën” dhe në RK2 me “Summertime” u realizua projekti veror me emisione të dedikuara, frymë verore dhe mysafirë nga muzika, arti dhe kultura. U

zhvilluan edhe transmetime të drejtpërdrejta nga ngjarje kulturore dhe festivale, duke ruajtur gjallërinë programore gjatë sezonit veror.

Zhvillime teknike dhe digjitale

Gjatë vitit 2025 u ndërmorën hapa konkretë në modernizimin teknik dhe digjital. Në shtator u finalizua lidhja përmes platformës Cleanfeed për bashkëpunim ndërkombëtar mes Radio Kosovës, Radio Tiranës dhe Radio Shkupit, duke përmirësuar cilësinë e transmetimit dhe ulur kostot operative. Në tetor u hap llogaria zyrtare e RTK Radios në Instagram, ndërsa në nëntor nisën hapat e parë për prezencë zyrtare në Spotify. Po ashtu, u renovuan tri studio të produksionit me përmirësime akustike dhe infrastrukturë të re.

Programi festiv i fundvitit

Në fund të vitit, Radio Kosova realizoi program të zgjeruar festiv për Vitin e Ri 2026, me emisione foljore, koncerte, intervista speciale, reportazhe retrospektive dhe përmbajtje për fëmijë. Programi përfshiu artistë të njohur, koncerte vendore e ndërkombëtare dhe materiale reflektuese për zhvillimet kryesore të vitit 2025, duke forcuar rolin e Radio Kosovës si platformë kulturore, informuese dhe gjithëpërfshirëse.

Përmbajtja programore e RTK-Radios, që transmetohet në dy kanalet Radio Kosova 1 dhe Radio Kosova 2 përmes valëve FM, publikohet edhe në medie online. Radio-dokumentarët, reportazhet, emisionet dhe intervistat e realizuara nga gazetarët e Radios, janë të qasshme për audiencën 24 orë në 7 ditë të javës. Në këtë mënyrë, Radio Kosova si Transmetues Publik, ka zgjeruar dhe ka rritur audiencen, duke u përshtatur me trendet e reja teknologjike.

ARRITJET KRYESORE DIGJITALE

Viti 2025 ishte një vit rekord për prezencën digjitale të Radio Kosovës. **Faqja në Facebook** pati një performancë të jashtëzakonshme: nga 3 milionë shikime në vitin 2024, ajo arriti **29.4 milionë shikime** gjatë vitit 2025, me **7,148 postime** që përfshinin foto, video, story dhe live. Ndërkohë, **ndjekësit e rinj u rritën me 22,2 mijë**, ndërsa vizitat në profil arritën 269,4 mijë. Ky sukses tregon qartësisht rritjen e angazhimit të audiencës dhe forcimin e prezencës së Radio Kosovës në rrjetet sociale.

Në YouTube, gjatë vitit janë postuar **566 video**, me **121 mijë shikime** dhe **6,060 mijë orë të shikuara**, ndërsa janë fituar **683 abonues të rinj**. Audienca kryesore vinte nga Shqipëria, Gjermania, Zvicra dhe Maqedonia e Veriut, me përqindje më të lartë meshkujsh (70.5%) dhe grupmoshën 25–44 vjeç.

Instagrami, i hapur në tetor, regjistroi 2,219,069 shikime, me 1,343 ndjekës dhe një reach prej 640,201. Audienca më aktive ishte nga Kosova dhe Gjermania, ndërsa mosha kryesore 35–44 vjeç dhe meshkujt përbënin 51.5% të ndjekësve.

Më poshtë është raporti i detajuar

Radio Kosova - Youtube

Në kanalin e Radio Kosovës në youtube gjatë vitit 2025 janë postuar 566 video.

Gjatë periudhës kohore 01.01.2025 -31.12.2025, në total janë regjistruar **121.011 mijë** shikime në youtube.

Gjithsej, janë regjistruar **6.060 mijë** orë të shikuara në youtube.

Në youtube, në vitin 2025, kemi patur **683** abonues të rinj

Vendet dhe audienca:Shqipëria **20.6%**, Gjermania **8.5%**, Zvicra **3.3**%, Maqedonia e Veriut **2.3%**, SHBA **1.7%**
Gjinia: Female **29.5%**, Male **70.5%**

Mosha **18-24 vjeç** 3.7 %, **25-34 vjeç** 30.3% **35-44 vjeç** 21.2%, **45-54 vjeç** 13.8%, **55-64 vjeç** 15.5%

Radio Kosova - Facebook

Në vitin 2025, në faqen e Radio Kosovës në FB janë postuar 7,148 materiale. Views ka rritje të jashtëzakonshme, duke arritur shifrën **29.4 milionë** gjatë vitit 2025 krahasuar me vitin paraprak që ishte 3 milionë. (shënim: Gjatë këtij këtij viti është hequr metrika "Reach" nga Meta)

Postime totale: 7,148 (foto, video, story dhe live)

Shikime totale (views): 29.4 milionë

Ndjekës të rinj (New Followers): 22,2K

Vizita në profil: 269.4K

Postimet më të suksesshme:

- **Postimi me më shumë shikime (views):**
  "Qeni Pitbull ma ka çu fëmijën për herë të parë në këmbë" – BimBimma në Pawcast
  Data e postimit: 26.05.2025

  https://facebook.com/reel/1201109998692409/

Postimi me më shumë reagime (Like, Love, Ëoë, etj.):
"A ke qenë nojherë e re?" kënga që flet me humor e mall për rininë!
Data e postimit: 22.07.2025

https://fb.watch/EExrGoHYq8/

Postimi më i komentuar:
Përkujtojmë legjendën e skenës shqiptare, Ndrek Luca (1927-1993)
Data e postimit: 13.01.2025

https://facebook.com/reel/1162435945243951/

Performanca e Videove

Videot më të shikuara (TOP VIDEOS):

"A ke qenë nojherë e re?" kënga që flet me humor e mall për rininë!"
Data e postimit: 22.07.2025, Minuta të shikuara: 233,940 mijë

https://fb.watch/EExrGoHYq8/

Tani thonë qeni s'din... çuditesh çka din!" Bim Bimma në Pawcast
Data e postimit: 26.05.2025, Minuta të shikuara: 174,180

https://facebook.com/reel/1226613402531353/

"Qeni Pitbull ma ka çu fëmijën për herë të parë në këmbë" – BimBimma në Pawcast
Data e postimit: 26.05.2024, Minuta të shikuara: 173,760 minuta
https://facebook.com/reel/1201109998692409/

Demografia e Audiencës

Shtetet kryesore : Kosova: 44.9%, Gjermania: 11.0%, Maqedonia: 5.6%, Zvicra: 4.9%

Gjinia: Meshkuj: 67.0%, Femra: 33.0%

Mosha: 25-34 vjeç: 17.7%, 35-44 vjeç: 28.9%, 45-54 vjeç: 26.2%

Radio Kosova - Instagram

Më poshtë mund ti gjeni të dhënat e faqes së Radio Kosovës në Instagram, që nga hapja e saj në tetor.

Reach 640,201

Views 2,219,069

Numri i postimeve 590

Numri i ndjekesve total 1,343

Shtetet më aktive:

Kosova 51.6%

Gjermania 11.1%

Shqiperia 7.6%

Maqedonia e Veriut 5%

Zvicra 4.7%

Aktiviteti në baza gjinore

Femra: 48.5%

Meshkuj: 51.5%

Koha më aktive e ndjekësve:

E shtunë - ora 18:00

E premte - ora 15:00

E diel - ora 21:00

Mosha më aktive:

- 35-44 vjeç: **37.9%**
- 25-34 vjeç: **18.0%**
- 45-54 vjeç: **25.8%**
- 55-64 vjeç: **10.8%**

Redaksia e Informacionit në Radio Kosova 1

Redaksia e informacionit në Radio Kosovë gjatë vitit 2025 ka qenë e angazhuar në përcjelljen e të gjitha ngjarjeve politike në vend. Në këtë kuadër edicioneve informative kanë mbuluar gjitha ngjarjet e rendësishme në vend duke mos përjashtuar edhe ato në fusha të tjera si arsim, ekonomi, fusha e mirëqenies sociale, shëndetësia kultura e arti. Radio Kosova Programi i parë gjatë ditës fillon edicionet informative nga ora 6 e mëngjesit deri në mesnatë, ku përvec edicioneve të shkurta transmetohen edhe edicionet e zgjeruara si ai i Mëngjesit, Mesditës, Edicioni Qendror, i Mbrëmjes dhe Mesnatës. Gazetarët dhe redaktoret e dhomës së lajmeve gjatë vitit 2025 kanë realizuar rreth **347** tema, mbi një mijë raporte gjatë tërë vitit.
Radio Kosova ka përcjellë edhe katër proceze zgjedhore, me rast ka rezultuar me raportim të saktë, të balancuar dhe të paanshëm.

Në tabelën më posht kemi veçuar disa nga temat më të rëndësishme që janë realizuar nga dhoma e lajmeve

Viti 2025		
Muajt:	Numri i temave:	Temat e veçuara:
JANAR	35	Rastet Sociale Shtëpia e të moshuarve 1 vjet liberalizimi i vizave Rënia e numrit të nxënësve Plakja Aktive Shëndetësia, Ekonomia gjatë vitit 2024 Dialogu Asistenca për fëmijët me nevoja Gripi sezonal Gripi sezonal - Myrvete Gashi dhe qytetarë Të pa gjeturit Faturimi I mbeturinave në Komunën e Prishtinës Zbulimi i insektit të ri

SHKURT	30	Fillimi I fushatës së imunizimit me vaksina Nisma për bojkotimin e marketeve të mëdha Zgjedhjet parlamentare Formimi i Kuvendit dhe Qeverisë Radio dhe ndryshimet klimatike Kosova në arenën ndërkombëtare Çështja e personave të zhdukur Skriningu Neonatal Barnat , çmimet, nivelizimi I tyre ZRRE tarifat-Qytetaret Artistet në grevë
MARS	25	Dhuna në familje Fëmijët me probleme në të folur Trepça rikthen pronat Taksa Ekologjike Zjarret-Tahir Ahmeti Sulmet ndaj gazetarëve Rastet me fruth- Përpunim i intervistës me Jamie Shea Rritja e çmimit të energjisë Testi PISA Vdekjet në vendin e punës
PRILL	33	Kontaminimi I mishit të pulës Digjitalizimi i Shkollave Çmimet e karburanteve Dita e Kushtetutes Përdorimi i armëve pa leje Faturat e mbeturinave Ritja e çmimit te rrymes Ndalimi i Vepave Munges e asistentëve për fëmijët me aftësi të kufizuar

		Braktisja e foshnjave Alergjitë Punimet në sheshin Nëna Terezë
MAJ	31	Rritja e çmimeve Provimi Shtetëror i Maturës Gjithëpërfshirja e fëmijeve me nevoja të veçanta Dëmet vreshta - Habib Dina Kutia e verdhë në komunikacion Kujdesi për prindërim Eurovizioni 2025 Masat e BE-së Ndalimi i mishit Mungesa e autobusëve në kryeqytet Përdorimi I duhanit
QERSHOR	22	Situatat me Rriqërat Liberalizimi i energjisë Temperaturat e larta Panairi i librit Keqtrajtimi i qenve Fruthi apeli për vaksinim Gjendja me uje te pijshëm Pagesat për mbajtjen në paraburgim Prania e sallmoneve mish pule Gjykimi në mungesë
KORRIK	60	Temperaturat e larta brenda pallatit te drejtesisë Pishina e Gërmisë Reduktimet e ujit Siguria në trafik Gjobat e kosovarëve në Shqiperi Gjendja e grurit-korrjeshirjet

		Programi veror ‘Vera me Radio Kosovën”. Vjosa Hysaj dhe Nimetullah Cahani Anëtarësimi në EQAR Kafshimi i gjarpërinjve, serumet nëpër QKMF Paralizimi i autoriteteve të konkurrencës Rënia e interesimit të studenteve për studime në UP Zbatimi i ligjit per qmimet e barnave Vrasjet e paregjistruara të pasluftës në Kosovë Dështimi i sencave për konstituimin e Kuvendit Pasaportat bullgare Motoçikletat ne trafikun rrugor Bujqit e dëmtuar kërkojnë fond për përkrahje Rritja e çmimeve të artikujve bazë për jetesë Sëmundja virale “Gjuha e kaltër”, te kafshet Subvencionimi I teksteve shkollore
GUSHT	62	Bizneset kërkojnë të respektohet vendimi i ZRRE-së Djegia e hamulloreve e dëmshme për tokën dhe mjedisin Rënia e natalitetit në Kosovë Pagat e deputetëve Investimet e huaja në Kosovë Java e gjidhënies Temperaturat e larta, zjarret në vend Vrasjet dhe armët pa leje Faza e pestë e dezinsektimit hapësinor – Izet Sadiku RTK ende pa paga Çkucjet dhe reagimet e bizneseve – biznes shkyqja - Lulëzim Rafuna Pak gra kanditate për kryetare të komunave Vonesat e disa linjave të trafikut urban Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare

		Siguria në hekurudha të Kosovës Përgatitjet e Vitit të i ri shkollor Mësimi tërëditor në disa shkolla të Prishtinës Vaksinimi i fëmijëve Ankesa për çmimin e rrushit
SHTATOR	32	Fillimi I vitit të ri shkollor Vizita në shtëpi për gratë shtatëzëna dhe fëmijë Siguria në rrugë Fushata zgjedhore Hardh Fest Subvensionimi i teksteve shkollore Sfidat e vreshtarëve Banka Qendrore, remitancat nga diaspora Kartela e imunizimit me stemen e UNMIK –ut Gjuha e Qeverisë ndaj gjyqësorit - Melos Kolshi dhe Melazim Koci Numri i lartë i nxënësve në shkolla Viti i ri akademik Ndalimi i përmbatjes TPO nga BE Propaganda e Serbisë në veri Dita Botërore e Pastrimit Dita Ndërkombëtare Pa Makina Gratë në zgjedhje Përdorimi I vepave nëper shkolla
TETOR	46	Dita Ndërkombëtare e të Moshuarve - Sherif Kastrati Vendosja e studenteve ne konvikte Intervistë me dr Ilir Kurtishi- kanceri I gjirit Zgjedhjet në veri Mungesa e terapisë në onkologji Përdorimi internetit nga fëmijët Termokosi filon sezonen e ngrohjes Festivali dhe panairi I librit për femijë

		Vaksinimi me HPV – Faik Hoti 09.10.2025 Balotazhi Zgjedhjet nacionale Mungesa e anesteziologëve Mungesa e skriningut të kancerit të gjirit Policia e Lagjës Java e njeriut me shkop të bardhë Ngritja e çmimit të barnave në vend Mungesa e psikologëve në shkolla Edicioni i 3 i festivalit RTK-së
NËNTOR	24	Të zhdukurit dhe zhvarrimet Qeveria e re apo zgjedhjet Numri I Mamografive të kryera Dita Boterore e Diabeti Trafiku Rrugor Dita e Viktimave Vershimet Problemet me furnizim me ujë Protesta e Trafikut urban
DHJETOR	37	Seancat konstituive të komunave Situata me grip në vend Komisioni per verifikimin e diplomave Listat zgjedhore Ndotja e ajrit Mosfunksionalizimi i objektit të Fakultetit të Bujqësisë Aksidentet Protesta gjithëkombëtare në mbështetje të ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës Cmimi I druve në treg Heqja e masave Vendimi per pensionistet Ngritja e çmimeve në prag të festave

		Reduktimet me energji elektrike në disa komuna të Kosovës Zgjatja e orarit të shërbimeve në Qendrat për Pajisje me Dokumente gjatë festave - Autobusët urban në Prishtinë Mungesa e kopshteve dhe transportit në zonat rurale Viktimat e dhunes seksuale gjatë luftës Gjykimi në Hagë dhe diplomatët
Total:	347	

Programi në Radio Kosova 1

Gjatë vitit 2025, Radio Kosova 1, ka realizuar të gjitha programet sipas skemes së rregullt programore.

Radio Kosova 1, ka realizuar disa projekte të veçanta përveç realizimit ditor të programeve informative, argëtuese, kulturore e arsimore.

Gjatë vitit 2025 janë mbuluar të gjitha ngjarjet e zhvillimet kryesore në vend me lidhje të drejtëperdrejta, transmetime direkte, iniciativa nga ana e stafit të Radios, duke sjellë përmbajtje të veçanta programore, fushata vetëdijsuese e humanitare si dhe koncerte e transmetime të ngjarjeve kulturore si spoznsor medial.

Disa nga projektet që kanë karakterizuar vitin 2025 janë:

Raport kushtuar Eurovizionit në Radio Kosova 1 dhe Radio Kosova 2:

Nga 12-16 maj 2025 nga (ora 11-12), janë realizuar 5 emisione të drejtpërdrejta kushtuar Eurovizionit, me gjithsej 19 intervista, prej tyre 4 ekskluzive dhe një kronikë (nga RTSH). Emisioni është realizuar nga Valentina Kryeziu Nazifi. Edhe në programin e dytë nga data 12 deri me 16 maj është realizuar emision special kushtuar festivalit të këngës evropiane "Eurovizion 2025" Në këtë termin Besa Cakaj dhe Vjosa Husaj kanë pregatitur intervista, materiale, copëza nga atmosfera, këngë nga prapaskenat, etj.

Paraqitja në detaje e përmbajtjes:

E hënë 12 maj:

1. Festivalet, si mundësi për artistët e rinj. I ftuar në studio, fituesi i edicionit të dytë të Festivalit të Këngës në RTK, Endrit Krasniqi.
2. A po e krijon Kosova një identitet të veçantë muzikor, me festivalin e Këngës në RTK? Roli i festivaleve në përgatitjen e artistëve për pjesëmarrje në ngjarje muzikore evropiane dhe jo vetem?! Intervistë me muzikologen kosovare, Kristina Palokaj Përkola.

E marte, 13 maj:

1. Intervistë ekskluzive me një nga zërat më të fuqishëm shqiptarë-Aurela Gaçe, përfaqësuese e Shqipërisë në Eurovision 2011.

2. Intervistë ekskluzive, pak orë para fillimit të gjysmëfinales së parë të Eurovizionit, me menaxherin e Shkodra Elektronike, Olsi Sulejmani.
3. Përmbajtja e këngëve që krijohen sot, si përfaqësim ndërkombëtarë. Në studio Sami Piraj, muzikolog, kompozitor, autor e gazetar shumëvjeçar i kulturës në Kosovë.
4. Në studio, kritiku i artit, Ilir Muharremi-"Zjerm" nga Shkodra Elektronike a është është një kryevepër poetike dhe muzikore?
5. Në studio, Afërdita Rushiti-paralajmërim i Natës së Parë Gjysmëfinale në të dyja kanalet e Radio Kosovës.

E mërkurë, 14 maj:

1. Promovimi që i ka bërë Radio Kosova lansimit të kësaj kënge. Në studio, redaktori i muzikës, Remzi Samakova.
2. Instrumentet tradicionale në muzikën shqiptare sot. Në studio etnomuzikologu kosovar, Visar Munishi.
3. Platforma Eurovision Kosova. Intervistë me Albert Limani.
4. Në studio edhe Nimetullah Cahani-përmbledhje e reagimeve nga mediat ndërkombëtare për Shkodrën Elektronike, pas kualifikimit për në finale të Eurovizionit.
5. Kronikë: Paraqitja skenike dhe ndërthurja e disa elementeve në fustanin e Beatriçes nga dizajnuesja e këtij kreacioni, nëna e saj, Irina Dema. Pjesë nga intervista, marrë nga RTSH.

E enjte, 15 maj:

1. Analizë muzikore e këngës "Zjerm" dhe shpresat për finale. Intervistë me muzikologen, Rreze Kryeziu.
2. Si është pritur kënga "Zjerm" nga shqiptarët në Maqedoninë e Veriut? Intervistë me tekstshkruesin, kompozitorin, gazetarin dhe njohësin e festivaleve Avni Qahili.
3. Në studio Afërdita Rushiti, paralajmërim i Natës së Dytë Gjysmëfinale në të dyja kanalet e Radio Kosovës.

E premte, 16 maj:

1. **Procesi krijues i tekstit të këngës "Zjerm" dhe mesazhi artistik që sjell. Intervistë ekskluzive me Lekë Gjeloshi, bashkëautor i tekstit.**
2. Vlerësimi dhe mbështetja e artistëve shqiptarë për Shqipërinë, për finale Eurovizionit 2025. Intervistë me kantautorin kosovar, Andos për Shkodrën Elektronike.
3. **Magjia që e ofron skena e festivaleve. Intervistë ekskluzive me aktoren Drita Kabashi, njëra nga prezantueset e edicionit të dytë të Festivalit të Këngës në RTK.**
4. **Paralajmërim i emisioneve për Eurovizionin gjatë fundjavës. Në studio, Nimetullah Cahani.**

Emisioni special-Eurovizioni					
Emisione RK1 dhe RK2	Intervista ekskluzive	Intervista (total)	Kronika	M	F
10	4	31	1	20	11
Temat e emisioneve (të intervistuarit): 1. Intervistë ekskluzive me një nga zërat më të fuqishëm shqiptarë-Aurela Gaçe, përfaqësuese e Shqipërisë në Eurovision 2011.					

2. Intervistë ekskluzive me Lekë Gjeloshi, bashkëautor i tekstit të këngës “Zjerm” .
3. Intervistë ekskluzive, pak orë para fillimit të gjysmëfinales së parë të Eurovizionit, me menaxherin e Shkodra Elektronike, Olsi Sulejmani.
4. Intervistë ekskluzive me aktoren Drita Kabashi, njëra nga prezantueset e edicionit të dytë të Festivalit të Këngës në RTK.
5. Endrit Krasniqi, fitues i edicionit të dytë të festivalit të RTK-së.
6. Kristina Palokaj Përkola, muzikologe
7. Sami Piraj, muzikolog, kompozitor, autor e gazetar shumëvjeçar i kulturës në Kosovë.
8. Ilir Muharremi, kritik i artit
9. Visar Munishi, etnomuzikolog.
10. Albert Limani nga Eurovision Kosova
11. Rreze Kryeziu, muzikologe
12. Avni Qahili, tekstshkrues, kompozitor, gazetar dhe njohës i festivaleve
13. Andos, kantautor kosovar.
14. Aferdita Rushiti
15. Nimetullah Cahani
16. Remzi Samakova

Edhe në programin e dytë nga data 12 deri me 16 maj është realizuar emision special kushtuar festivalit të këngës evropiane “Eurovizion 2025” Në këtë termin Besa Cakaj dhe Vjosa Husaj kanë pregatitur intervista, materiale, copëza nga atmosfera, këngë nga prapaskenat, etj

12 Intervista

4 femra / 8 meshkuj

12.05.2025 – Intervistë me Albert Limanin dhe Gezim Sahitin nga Eurovision Kosova, diskutojmë per traditën, emocionet dhe momentet më ikonike të Eurovisionit

13.05.2025 – Intervistë me kompozitorin Xhevdet Gashi - këngën dhe pikat e forta të Shqipërisë këtë vit

Intervistë me Albina Kelmendi-ish përfaqësuseja e Shqipërisë në Eurovizion / përkrahja e saj për perfaqesimin e ketij viti

Intërvistë me Jozefina Hasani, autore e Fest 64, na sjell atmosferën nga Zvicrra si pjese e ekipit te Shkodrës Elektronike

14.05.2025 – Intervistë me Anton Zefi nga Alb Radio, dreitperdrejt nga Zvicra, na sjell emocionet, atmosferen dhe mbeshtetjen e zjarrte te komunitetit shqiptar

Intervistë me Zanita Halimin, etnologe & antropologe - Veshja dhe prezantimi unik i Shkodres Elektronike, i mbushur me simbolike, tradite dhe detaje kulturore

Intervistë me Arsim Halilin, drejtor ne Radio Kosovë – Raprti i Kosovës dhe përpjekejt e RTK-së për pjesëmarrje ne Eurovizion

15.05.2025 – Intervistë me sociologun Artan Krasniqi - A dim të mobilizohemi si shoqeri per një qellim te perbashkët?

Intervistë me muzikantin Asdren Rrahmani nga Londra, analizojme këngët e giysmëfinales së dytë dhe hitet qe lindin nga kjo garë muzikore.

16.05.2025 – Intervistë me Gëzim Sahiti nga Bazeli sjellin emocionet e giysmefinales se dytë

Intervistë me Arnita Kastratin, fituese e "Çmimit të Orkestrës" në edicionin e dytë te festivalit të këngës ne RTK, finalja e madhe dhe mbështetja e saj për Shkodrën Elektronike.

VERA ME RADIO KOSOVEN

Projekti veror "Vera Me radio Kosovën " ka nisur më 14 korrik dhe ka përfunduar me 15 gusht. Ky emision është transmetuar nga e hëna deri të premten, në orarin 11:00 – 14:00. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar 25 edicione të drejtpërdrejta, ku janë realizuar 85 intervista, disa paraqitje të kolegëve nga pika të caktuara për të promovuar turizmin veror në Kosovë dhe në Shqipëri.

Prezantohet repertori i këngëve të festivalit dhe ritrasmetohen intervista nga edicioni i kaluar, të realizuara nga prapaskenat e Radio Kosovës.

27–31 tetor (11:00–12:00) – Pjesa e dytë

Të ftuarit:

- Gentiana Begolli – Koordinatore e Festivalit
- Besim Mikullovci – Krijues i brendimit dhe logos së festivalit
- Dukagjin Podrimaj & Rina Krasniqi – Prezantuesit e festivalit
- Bashkim Tejeci – Mjeshtër i filigranit / Krijues i Okarinës së Artë për "Akordet e Kosovës"
- Valdet Hoti – Punues i Okarinës së Artë për trofeun e këtij edicioni
- Ekipi i Radios nga edicioni i kaluar (prapaskena):

Shpejtim Salihu, Driton Bunjaku, Fatos Preniqi, Valtona Kelmendi, Mentore Murati, Trendelinë Bucolli

Lidhje direkte:

- Laura Kryeziu – Konferenca e Festivalit të Këngës

_____

Zëvendësime

- Gramafon II (Laura Kryeziu) 10:00–11:00

Datat: 3, 6, 16 dhe 17 tetor

- N'Radio (Haki Kika) 12:00–13:00

Datat: 21, 23 dhe 24 tetor

Nëntor

Gramafon II

9 të ftuar (4 femra / 5 meshkuj)

Temat dhe të ftuarit:

- Rozi Kryeziu Mazreku – Java e Filmit në Suharekë
- Petrit Ymeri – Panairi i Librit në Tiranë
- Dea Strica – Pjesëmarrëse në Fest 2
- Arnita Kastrati – Pjesëmarrëse në Fest 2
- Arsi Bako – Fituese e Fest 3 (Emision special Post Festival)
- Rron Haxhiislami – Platforma e re Love and Dance
- Rrezart Galica – Prishtina Poster, Festivali Ndërkombëtar i Posterit, edicioni i 5-të

Zëvendësime:

- 12 nëntor – Pjesa e parë dhe e dytë
- 14 nëntor – Pjesa e parë
- 20 dhe 21 nëntor – Pjesa e parë
- 24 nëntor – Pjesa e parë
- 26 nëntor – Pjesa e parë

_____28 nëntor - Intervistat:

	• Adhurim Grezda – Këngëtar • Besnik Grajqevci – Ansambli i këngëve dhe valleve Shota Dhjetor – Gramafon II Total intervista: 13 Meshkuj: 7 Femra: 6 Zëvendësime: • 02, 09, 24 dhjetor – zëvendësim Laura • 25 dhjetor – Gramafon dhe Mesadita (Nora Fejza) _____ Lista e të ftuarve dhe temat • Sinan Kajtazi – Baleti në Itali, pjesëmarrje historike dhe paraqitjet atje • Gresa Kelmendi – Organizata Trashëgimia Kulturore Pa Kufij, projektet dhe punëtoritë • Olti Vrella – Teknologji, pjesëmarrja në Festivalin e Sigurisë Kibernetike në Varshavë dhe vlerësimet e marra • Sihana Krisulica – Galeria 17, Pop-Up Ëeek Art 2025 • Urta Haziraj – Soprano, koncert festiv “A Jingle of Memories” • Robert Shala – Hapur Decfon Kosova, grup i të rinjve për sigurinë kibernetike • Nita Qahili – Galeria Qahili, ekspozita vjetore “Hijet e Bardha” • Bledion Baraliu – Kryetar i Arkitektëve të Kosovës, 5 çmime ndërkombëtare • Besmir Vokopola – Fondacioni Rame Lahaj, koncerti i fundvitit • Bashkim Ramadani – Regjisor (Mesdita) • Leke Cervadiku – Flossk, iniciativa “Kompjutera për Krejt” • Urtese Murati – Organizata DyVoLab, projektet për riciklim dhe qëndrueshmëri • Anjeze Shahini – Intervistë për Vitin e Ri
N’RADIO	**Disa nga temat e emisioneve** (të intervistuarit) Emisioni N’Radio realizohet nga ora 12:00- 13:00, me autor Haki Kikaj. Z. Kikaj nga prilli deri me 15 shtator ka qenë në pushim pa pagesë. Në këtë kohë emisioni N’radio është mbajtur nga Vjosa Husaj dhe Besa Cakaj. z. Kikaj gjatë vitit 2025 ka mbajtur 141 emisione me 11 Intervista me femra – 7 dhe 4 meshkuj Nga 1 prill deri më 15 shtator ka qenë pushim pa pagesë / Për pjesën e cila është zëvendësuar nga Znj Husaj dhe znj Cakaj, janë dhënë detajet më sipër.

REDAKSIA E PROGRAMIT TË NATËS

Në programin e natës në RTK - Radio 2, në janë realizuar 535 emisione të ndryshme të incizuara. Kështu, gjatë vitit 2025 janë transmetuar emisionet e parapara sipas skemës programore siç janë: **"Bulevardi", "Rock & Blues"**, **"Pilot underground"**, **"Ora 22:00"**, **"Ëorld Music"**, **"Ecim nëpër qytete"**,**"Muzika Jazz"**,**"Rock Forever"**, "**Bulevardi", e "Prapaskena" .**

REDAKSIA E PROGRAMIT TË NATËS							
	EMISIONE	RITRANSMETIME	TEMA	RUBRIKA	INETRVISTA	TË FTUAR	
						M	F
BULEVARDI	52	-	52			-	-
PRAPASKENA	48	-	48			-	-
ROCK & BLUES	48	-	48			-	-
PILOT UNDERGROUND	53	-	53			-	-
EMISIONI 22:00	52	-	52			-	-
ËORLD MUSIC	52	-	52			-	-
ECIM NËPËR QYTETE	49	-	49			-	-
MUZIKA JAZZ	33	-	33		4	2	2
ROCK FOREVER	48	-	48			-	-
JAVA NË 7 DITË	52	-	52			-	
ËARM UP	52	-	52			-	-
TOTAL	**535**		**535**			**-**	**-**
						4	

ROCK&BLUES	Janë transmetuar 48 emisione të "Rock & Blues", duke sjellë këngë dhe interpretime nga zhanret rock dhe blues, me përfaqësim të grupeve dhe artistëve më të spikatur. Emisionet kanë ofruar një pasqyrë të pasur të krijimtarisë muzikore dhe repertorit të këtyre zhanreve për audiencën e tyre, duke e bërë skenën muzikore më të afërt dhe të njohur për dëgjuesit.
ORA 22:00	**Disa nga temat e emisioneve**: ORA 22 (Lorik Sylejmani) Dita e shtune, ora 22 - 24, janë realizuar 52 emisione. Në këtë emision paraqiten më të rejat nga bota e teknologjisë, inteligjencës artificiale, robotikës, rrjeteve sociale, telekomunikacionit etj.
ËORLD MUSIC	**Disa nga temat e emisioneve** (të intervistuarit) - 52 emisione të "Ëorld Music", të dedikuara promovimit të muzikës botërore, diversitetit kulturor dhe artistëve ndërkombëtarë nga zhanre të ndryshme.
PRAPASKENA	Gjatë vitit 2025, Blerim Sopi ka realizuar gjithsej 48 emisione të "Prapaskena", i cili sjell artistë dhe këngët e tyre, duke promovuar muzikën dhe kulturën e zhanreve të ndryshme dhe duke i dhënë publikut mundësinë të njohë më mirë krijimtarinë e tyre.
BULEVARDI	**BULEVARDI (E hënë nga ora 22:00 – 23:00)- Lorik Sylejmani** Gjatë vitit 2025 janë realizuar 52 emisione. Bulevardi është emision në të cilin janë transmetuar hitet më të mëdha të viteve 80-ta dhe 90-ta në muzikën botërore. Njëkohësisht për secilin emision është folur për këto hite ndër vite.

ROCK FOREVER	Gjatë vitit 2025, jane realizuar gjithsej 48 emisione të "Rock Forever", të dedikuara promovimit të muzikës rock dhe artistëve të saj, duke përfshirë këngë nga grupet më të njohura rock dhe klasikët e zhanrit.
Tinguj Jazzi	Disa nga temat e emisioneve (të intervistuarit) -33 emisione te realizuara (nga Ilire Avdiu) Dhjetë emisione ia ka kushtuar këngëtareve që merren me jazz ndërsa tetë meshkujve muzikant të jazit. Në kuadër të këtij emisioni ka realizuar katër (4) intervista 11 kushtuar temave te ndryshme lidhur me muziken jazz
Warm Up	Disa nga temat e emisioneve (të intervistuarit) Gjatë vitit 2025, Dj Floyd (Fitim Ramaj), ka realizuar 52 emisione të parapara me skemën e programit të natës, i cili transmetohet çdo të premte nga ora 22:00-00:00 e ku sjellë sete të ndryshme të muzikës electro, Afrobeet, R&B, House, Hip Hop etj.
PILOT UNDERGROUND	Dita e merkure ora 22 - 24, jane realizuar 53 ensione. Në PilotUnderground gjatë vitit 2025 janë transmetuar 53 emisione. Në kuadër të këtij emisioni lëshohen kryesisht bendet nga skena më e re indie si dhe ato punk, neë ëave, gothik e alternativ. Bendet janë kryesisht botërore, por me raste lëshohen dhe flitet edhe për bendet vendore. Këtë emision e realizon Lorik Sylejmani
Ecim nëpër qytete	Emisioni **"Ecim nëpër qytete"** me autor Blerim Sopi gjatë vitit 2025 është transmetuar 49 herë. Ky emision prezanton qytetet dhe jetën urbane në to. Përmes këtij formati, ai ka sjellë në vëmendje zhvillimet kulturore, sociale dhe turistike, duke pasqyruar trashëgiminë, identitetin lokal, iniciativat qytetare dhe potencialin zhvillimor të secilit qytet. Emisionet janë fokusuar në promovimin e vlerave kulturore dhe turistike, si dhe në evidentimin e ndryshimeve dhe sfidave bashkëkohore të jetës urbane.

Fundjava në RadioKosova 2 Emisionet Top Shqip & Top 10 dhe Retro Shqip dhe Java në 7 ditë

Gjatë vitit 2025, emisionet **Top Shqip** dhe **Top 10**, të cilat përgatiten nga Donjeta Krasniqi dhe Vjosa Husaj, janë realizuar sipas skemës së paraparë në RadioKosova2, duke sjellë prurje dhe hite të reja, si në produksionin vendor, ashtu edhe në atë ndërkombëtar.

"Top Shqip" është realizuar në 52 emisione, duke promovuar muzikën shqipe, artistët vendorë dhe krijimtarinë bashkëkohore në skenën muzikore shqiptare.

Top Ten është një emision muzikor që sjell këngët më të reja dhe më të dëgjuara të javës në RTK Radio, i cili transmetohet në dy kanalet e Radio Kosovës: të shtunën në Radio Kosova 1, ndërsa të dielën i njëjti emision transmetohet në Radio Kosova 2. Emisioni realizohet premierë çdo fundjavë. Nga ky emision realizohet edhe një rubrikë ditore, e cila transmetohet në Radio Kosova 1, me 5 këngët më të dëgjuara të javës. Gjatë vitit 2025 janë realizuar gjithsej 52 edicione të emisionit Top Ten.

Emisioni Retro Shqip realizohet çdo të shtunë nga Nora Meqa. Gjatë vitit 2025, emisioni ka risjellë këngë të këngëtarëve të ndryshëm, të cilët veçohen për pjesëmarrje nëpër festivale të ndryshme. Janë realizuar gjithsej 52 emisione "Retro Shqip", të dedikuara promovimit të këngëve të vjetra shqiptare, duke sjellë krijimtarinë e artistëve vendorë dhe repertorin e tyre më të njohur. Emisionet kanë ofruar dëgjuesve

mundësinë të njohin më mirë muzikën shqiptare, të vlerësojnë talentet vendore. Përmes këtyre emisioneve, audienca ka pasur një pasqyrë të pasur dhe të larmishme të muzikës shqiptare, duke e lidhur traditën me krijimtarinë moderne.

Emisioni Java në 7 ditë është realizuar gjithashtu në kuadër të skemës së rregullt të kanalit të dytë. Autor i emisionit është **Blerim Sopi,** ku çdo të diel, sjellë zhvillimet që kanë karakterizuar vendin, rajonin dhe botën. Në këtë kuadër janë realizuar 52 emisione

Gjithsejt janë realizuar 257 emisione.

EMISIONE	VIKENDI
Top Shqip	Këngët më të dëgjuara shqip 52
Top 10	Këngët më të dëgjuara në produksionin e huaj 52
Retro shqip	E vjetër por e mirë 52
Java ne 7 ditë	Zhvillimet e javës 52
TOTAL	208

REDAKSIA E KOMUNITETEVE

Katër redaksitë e komuniteteve në Radio Kosovë, gjatë vitit 2025 kanë realizuar gjithsej 1 mijë e 53 edicione lajmesh, 1 mijë e 84 tema të ditës**, 781** emisione autoriale, **767** rubrika, **1358** bashkëbisedues**,** nga të cilët 917 burra dhe 441 gra.

Redaksia në gjuhën serbe -RADIO KOSOVA 2

	Viti	Edicione lajmesh	Tema e ditës	Kronika, raporte	Emisione autoriale	Rubrika	Rubrika autoriale
	2025	265	263	318	183	289	26

Redaksia në gjuhën serbe e Radio Kosovës 2 transmeton program çdo ditë nga ora 14:00 deri në 16:00. Gjatë vitit 2025, janë përgatitur 265 edicione të lajmeve, 263 tema të ditës, 318 raporte, 183 emisione autoriale, 289 rubrika, dhe 26 rubrika autoriale, 240 intervista, prej tyre, 96 femra dhe 144 meshkuj. Gjatë fundjavës, të shtunave dhe të dielave, ne transmetojmë vetëm **Lajmet**, pasi programi është i incizuar. Gjatë fundjavës ndërhyjmë me raportime vetëm kur ndodhin ngjarje të rëndësishme në Kosovë, siç janë zgjedhjet, konstituimi i institucioneve apo ndonjë incident i sigurisë.

Gjatë ditëve të punës përgatisim edicione të **"Lajmeve"** me kohëzgjatje prej 15 minutash, më pas rubrikën **"Tema e ditës"** dhe kontribute të tjera për tema të ndryshme nga Kosova, Serbia, rajoni dhe bota.

Emisionet javore:

- **“Kronika komunale”** (të martën),
- **“Magazina arsimoro-kulturore”** (të mërkurën),
- **“Ngjarja e javës”** (të enjten),
- **“Mjekësia”** (të premten).

Rubrika autoriale **“Qëndrimi i qytetarëve”** transmetohej të premten, por është ndërprerë në shtator 2025, kur autori Bojan Tomić shkoi në pushim pa pagesë.

Rubrikat e tjera janë:

- **“Sporti”** (të hënën dhe të enjten),
- **“Bota e filmit”** (të hënën),
- **“Shkenca”** (të mërkurën),
- **“Shoë biz”** (të shtunën),
- **“Ju prezantojmë”** (të martën).

Ndryshimet gjatë vitit 2025

Nga 1 shtatori 2025, gazetari Bojan Tomić ka shkuar në pushim pa pagesë. Që nga ajo kohë, në redaksi janë **Zylfije Jakupi – redaktore e edicionit** dhe **Diana Maliqi – redaktore e programit**.

Planet për vitin 2025 janë realizuar plotësisht, përfshirë edhe realizimin me sukses të tri fushatave parazgjedhore dhe vetë ditëve të zgjedhjeve: zgjedhjet parlamentare më 9 shkurt dhe 28 dhjetor si dhe zgjedhjet lokale më 12 tetor 2025.

Gjatë vitit 2025 kemi filluar incizimin e **video-podkasteve** për emisionin **“Ngjarja e javës”**, me autore Zylfije Jakupi, të cilat i kemi publikuar në rrjetin social Facebook. Janë realizuar gjithsej **11 podkaste** me mysafirë në studio.

Presim që gjatë vitit 2026 të mundësohet punësimi i një gazetari, në mënyrë që të vazhdojmë realizimin e skemës së paraparë në mënyrë profesionale dhe cilësore, si deri më tani.

Redaksia në gjuhën boshnjake RADIO KOSOVA 2

Gjatë vitit kalendarik 2025, redaksia në gjuhën boshnjake ka ndjekur dhe transmetuar gjitha ngjarjet kryesore në Kosovë, por edhe në rajon dhe në botë. Edhe në 2025 redaksia ka funksionur vetëm me tre anëtarë të stafit (një redaktor dhe dy gazetarë).

Gjatë këtij viti janë përgatitur 265 edicione, me 263 tema të ditës, 291 kronika , 101 emisione autoriale, 315 rubrika dhe 865 intervista dhe bashkëbisedime që kanë pasur në kuadër të emisioneve dhe raporteve, prej tyre 623 meshkuj dhe 242 femra.

Gjithashtu, që nga hapja e Zyrës Rajonale të RTK-së në Mitrovicë, në mars 2023, redaktorja Meliha Muriq është pjesë e asaj zyreje, nga ku kontribuon në redaksi, me koordinim të vazhdueshëm me pjesën tjetër të redaksisë në zyrën në Prishtinë, ku shkon sipas nevojës.

Njëkohësisht theksojmë se gjatë vitit 2025 janë realizuar planet e planifikuara të punës së redaksisë, bazuar në skemën programore, e cila përfshin si më poshtë:

- Programi ditor i lajmeve **Vijesti** (e hënë-e premte);

- Rubrika ditore **"Tema e ditës"** (e hënë-e premte);

-**Kronika, intervista për tema aktuale** nga vendi dhe komunitetet boshnjake në Kosovë, rajon dhe botë;

- Emisionet autoriale: **ProKult** (e martë) dhe **Usput rečeno** (e enjte)

- Rubrikat javore: **Sporti, Mjekësia, Ju prezantojmë, Bota e Artit, Shkenca dhe Teknologjija.**

Të gjitha datat e rëndësishme janë shënuar me një program të veçantë, si: 17 shkurti, Dita e Pavarësisë së Kosovës, datat që kanë të bëjnë me festat fetare, 11 korriku, përvjetori i gjenocidit në Srebrenicë.. Është transmetuar program special për Vitin e Ri. Gjithashtu, është përcjellë fushata parazgjedhore për proceset zgjedhore që ishin gjatë vitit (2 palë zgjedhje parlamentare dhe zgjedhje lokale), si dhe procesi I votimit në zgjedhjet e përmendura.

Redaksia në gjuhën boshnjake do të përpiqet t'i kryejë të gjitha detyrat në përputhje me planin programor edhe në vitin 2026. Megjithatë, mbetet sfidë numri i vogël i redaksisë, andaj me krijimi ne kushteve kërkohet shtim I stafit në redaksi meqë edhe kolegu Fadil Rexhepi del në pension në vitin 2026.

Më poshtë është një prezantim tabelor i programit të zbatuar për vitin 2025, i shprehur në shifra:

2025	Edicioni i lajmeve	Tema e ditës	Kronika	Emisione autoriale	Rubrika	Numri i bashkëbiseduesve
Janar	23	23	13	8	25	52/ M 42 F 10
Skurt	21	20	21	7	24	86/ M 54 F 32
Mars	21	21	26	7	24	67/ M 45 F 22
Prill	22	22	30	9	26	63/ M 48 F 15
Maj	22	22	28	9	27	79/ M 56 F 23
Qershor	21	21	24	8	26	63/ M 42 F 21
Korrik	23	23	28	10	30	80/ M 60 F 20

Gusht	21	21	18	8	26	61/ M 51 F 10
Shtator	22	22	24	9	28	80/ M 56 F 24
Tetor	24	23	25	9	27	93/ M 62 F 31
Nëntor	21	20	32	8	24	62/ M 48 F 14
Dhjetor	24	23	22	9	28	79/ M 59 F 20
Gjithsej	**265**	**263**	**291**	**101**	**315**	**865/ M 623 F 242**

Redaksia në gjuhën Turke -Radio Kosova 2

Redaksia Turke e Radio Kosovës gjatë vitit 2025, ka transmetuar program çdo ditë të javës nga ora 16:00 deri në 18:00, me një kohë totale prej 2 orësh në ditë. Ky vit ka qenë jashtëzakonisht sfidues për redaksinë për shkak të daljes në pension të disa anëtarëve të stafit. Gjatë këtij viti janë përgatitur 258 edicione, me 295 tema të ditës, 207 kronika , 166 rubrika dhe 197 të ftuar, prej tyre 114 meshkuj dhe 88 femra.

Që nga muaji qershor, redaksia ka funksionuar për një periudhë me vetëm një person në detyrë, redaktoren e redaksisë, Arzu Ustaibo, ku nga qershori deri në shtator ka kryer edicionet e lajmeve dhe zhvillimet ditore. Ndërkohë, Raif Kırkul në Prizren ka vazhduar transmetimet e tij, duke ndjekur dhe raportuar çështjet më të rëndësishme në Prizren dhe zonat përreth gjatë gjithë sezonit të verës. Redaksia ka raportuar të gjitha zhvillimet e rëndësishme, duke përfshirë proceset zgjedhore, pa ndërprerje të transmetimit.

Pas një procesi të gjatë konkurrimi dhe përzgjedhjeje, dy gazetarë të rinj janë bashkuar me redaksinë që nga muaji shtator. Gjatë muajve të parë të punës, ato janë angazhuar në krijimin e programeve autoriale dhe kronikave, duke kontribuar në rikthimin e ritmit të punës në redaksi. Pas rreth katër muajsh përvojë, gazetarët arritën të zhvillojnë transmetime të drejtpërdrejta nga studioja.

Gjatë gjithë vitit, redaksia ka raportuar mbi zhvillimet më të rëndësishme në Kosovë, Turqi dhe botë, duke përfshirë zgjedhjet dhe ngjarje të tjera politike e shoqërore. Programet kanë përfshirë gjithashtu temat dhe aktivitetet e organizatave si Yunus Emre, TİKA dhe TOB, duke ofruar mbulim të kujdesshëm dhe hapësirë të gjerë për projektet e tyre në Kosovë.

Redaksia ka përgatitur edhe transmetime speciale për ditët e festave, përfshirë ndërrimin e vitit dhe festat fetare, duke përfshirë intervista në studio, anketa me dëgjuesit dhe elementë të tjerë specialë që kanë pasuruar axhendën e transmetimit.

Pavarësisht sfidave të shumta të vitit 2025, Redaksia Turke e Radio Kosovës ka pasur një vit të suksesshëm duke vazhduar transmetimet pa ndërprerje, duke u përshtatur shpejt ndaj ndryshimeve të stafit dhe duke ofruar përmbajtje të pasur, të qartë dhe cilësore për audiencën e saj.

Arzu Ustaibo – Redaktore: Koordinim i buletineve të lajmeve, ndjekje e ngjarjeve ditore dhe menaxhim i detajeve teknike të transmetimit. Ka ndihmuar gjithashtu në adaptimin e gazetarëve të rinj që nga shtatori.

Raif Kırkul – Fokus në çështjet dhe zhvillimet në Prizren dhe Mamusa, duke përgatitur transmetime të detajuara.

Figen Şaban – Përqendrim te temat politike dhe rubrikat e sportit dhe letërsisë.

Umay Süleyman – Përqendrim te temat kulturore dhe artistike, si dhe rubrika shëndeti dhe arkivi muzikor.

Emisioni	Autor	Dita	Ora	Përmbajtja
Reportazhi i Javës (Haftanın Reportajı)	Raif Kırkul	E hënë	17:30 – 17:45	Reportazhe nga fusha të ndryshme
Ngjyrat e Jetës (Yaşamın Renkleri)	Umay Süleyman	E martë	16:30 – 17:00	Aktivitetet kulturo-artistike të komunitetit turk
Tema Jonë, Mysafiri Ynë (Konumuz, Konuğumuz)	Raif Kırkul	E mërkurë	16:30 – 17:00	Tema të ndryshme me mysafirë në studio
Gündem Ötesi	Figen Şaban	E enjte	16:30 – 17:00	Çështje politike dhe institucionale
Rubrika e Sportit (Spor)	Figen Şaban	E hënë	16:30 – 16:45	Ngjarjet sportive në Kosovë, Turqi dhe botë
Edebiyat Saati	Figen Şaban	E martë	17:30 – 17:45	Letërsia turke
Arkivi Muzikor (Müzik Arşivimiz)	Umay Süleyman	E mërkurë	17:30 – 17:45	Transmetime nga arkivi muzikor i RTP-së
Këndi i Shëndetit (Sağlık Köşesi)	Umay Süleyman	E premte	17:00 – 17:15	Tema nga fusha e shëndetësisë

2025	Edicioni i lajmeve	Tema e ditës	Intervista	Emisione autoriale	Rubrika	Numri i bashkëbiseduesve
Janar	22	37	45	45	16	45/ 20 M 25 F
Skurt	20	25	30	27	9	30/ 18 M 12 F
Mars	20	27	9	17	16	9/ M 7 F 2
Prill	22	26	12	17	16	12/ M 8 F 4
Maj	22	18	27	12	16	27/ M 20 F 7
Qershor	20	17	13	6	8	13/ M 8 F 5
Korrik	23	16	7	5	10	7/ M 3 F 4
Gusht	21	10	5	3	9	5/ M 3 F 2
Shtator	22	30	10	11	12	10/ M 6 F 4
Tetor	23	33	17	12	16	7/ M 5 F 2
Nëntor	20	25	15	12	19	15/ M 7 F 8
Dhjetor	23	31	17	12	19	17/ M 9 F 8
Gjithsej	**258**	**295**	**202**	**179**	**166**	**202/ M 114 F 88**

Redaksia në gjuhën rome - Radio Kosova 2

	Viti	Edicione lajmesh	Emisione	Rubrika	Intervista e jave	Kronika	Ritransmetime
	2025	265	156	260	51	269	-

Programi në gjuhën rome në Radio Kosova 2 gjatë vitit 2025 ka pasur: 265 edicione te lajmeve ne gjuhen rome;

269 kronika; 52 emisione autoriale "Romano Avazo - Zeri i Romeve"; 52 emisione autoriale "Romane Standardikane Alavya - Gjuha Standarde Rome"; 52 emisione autoriale "Roma ani Evropa - Romet ne Evrope";

260 rubrika (52 rubrika "Intervista e javes"; 52 rubrika "Kronika sportive"; 52 rubrika "Pro Medika - Pro Mjekesia"; 52 rubrika per femije "Qhavorengi rubrika"; 52 rubrika "Romane muzikake qerenya - Yjet e muzikes rome").

Premiera e emisionit autorial "Romano Avazo – Zeri i Romeve" transmetohet te marteve dhe repriza transmetohet te dieleve.

Premiera e rubrikës "Romane muzikake qerenya - Yjet e muzikes rome" transmetohet të shtuneve dhe repriza transmetohet të mërkureve.

Redaksia rome në RTK-Radio përbëhet nga Redaktori i redaksisë dhe një gazetar. Sfida e redaksisë rome në RTK-Radio mbetet numri i vogel i stafit. Edhe pse redaksia ka vetëm një gazetar, gjatë vitit 2025 ka realizuar të gjitha objektivat për programin në gjuhën rome në RTK-Radio.

Objektivat për vitin 2026 janë përcjellja e ngjarjeve kryesore në interes të komunitetit romë në Republikën e Kosovës dhe më gjerë, përgatitja e lajmeve, kronikave dhe realizimi i rubrikave dhe emisioneve autoriale.

Funksionimi i stafit të redaksisë rome të RTK-Radios në Zyrën Rajonale të RTK-së në Prizren ka lehtësuar punën e redaksisë duke u bërë me efikas dhe më afër komunitetit rom i cili me numër më të madhë jeton në regjionin e Prizrenit.

RADIO KOSOVA

Radio Kosova

RAPORT PËR ANGAZHIMIN E RADIO KOSOVËS NË RTK FEST 3

RTK FEST 3, i mbajtur më 6, 7 dhe 8 nëntor 2025, është përcjellë me skema të veçanta programore nga Radio Kosova 1 dhe Radio Kosova 2. Mbulimi ka përfshirë tri (3) javë programe speciale ditore, nga 20 tetori deri më 9 nëntor 2025.

Objektivi kryesor ka qenë mbulimi i plotë i festivalit në të gjitha fazat e tij. Radio Kosova 2 është fokusuar në prapaskenat dhe procesin organizativ përmes ciklit special të emisioneve **“The Road to the Festival”**, duke pasqyruar punën e ekipeve krijuese dhe teknike. Ndërkohë, Radio Kosova 1 ka ndjekur pjesëmarrësit e festivalit nga provat deri te performancat live, duke i afruar dëgjuesit me artistët garues.

Kjo qasje e koordinuar ka siguruar një mbulim gjithëpërfshirës artistik, kreativ dhe njerëzor të festivalit.

Në kuadër të programeve speciale janë ftuar në studio gjithsej **76 personalitete të muzikës dhe kulturës**, nga breza të ndryshëm, që nga pjesëmarrësit e *Akordeve të Kosovës* deri te skena muzikore e ditëve të sotme (40 meshkuj dhe 36 femra).

Radio Kosova 1: **56 mysafirë** (29 meshkuj, 27 femra)

Radio Kosova 2: **20 mysafirë** (11 meshkuj, 9 femra)

Ditët e provave janë përcjellë intensivisht nga një ekip statik i Radio Kosovës (**Nora Meqa, Driton Bunjaku, Kreshnik Carkagjiu dhe Laura Kryeziu**), i cili ka xhiruar çdo ditë këngët e interpretuara dhe ka realizuar intervista me **20 garuesit**, muzikantët dhe organizatorët e festivalit. Intervistat në formatin video bashkë me materialet e përditshme promovuese, janë përgatitur montuar dhe transmetuar në platformat sociale në format video nga Shpejtim Salihu, Blerim Byqmeti dhe drejtori i RTK Radio, Arsim Halili.

Gjatë tri netëve live janë realizuar gjithashtu incizime video me **20 pjesëmarrës**, **15 anëtarë të ekipit realizues** dhe rreth **15 mysafirë specialë**. Incizimet e provave dhe prapaskenave janë realizuar nga **Nora Meqa, Laura Kryeziu, Vjosa Husaj, Driton Bunjaku, Kreshnik Carkaxhiu dhe Genc Berisha**.

Në tabelën poshtë gjeni të detajuara:

RTK FEST 3				
Programi special RTK 1 (Dy javët e para)	EMISIONE 10	INTERVISTA 29	M 12	F 17
Programi special RTK 2 (Dy javët e para)	10	20	11	9
Programi I përbashkët special RK 1 dhe RK2 (Java finale)	5	11	7	4
Tri netët LIVE	3	10	5	5
Post Festival	1	6	5	1
Intervista gjatë provave/netet live		20 këngëtarë pjesëmarrës, 15 të tjerë të angazhuar, dhe rreth 15 të ftuar specialë		
TOTAL	29	76	40	36

RTK FEST 3- Programi i Parë

E hënë, 20 tetor 2025
Moderim: Nora Fejza & Niki Cahani

Intervistë me këngëtarin Bledi Kaso (Korçë), pjesëmarrës në Festivalin e Këngës

Intervistë me këngëtarin Almir Krraba, pjesëmarrës në Festivalin e Këngës

Intervistë me gazetarin e kulturës/muzikologun Sami Piraj, tekstet e këngëve në festivale

E martë, 21 tetor 2025

Moderim: Nora Fejza & Niki Cahani

Intervistë me këngëtarin Florent Abrashi – pjesëmarrës në Festivalin e Këngës

Intervistë me këngëtaren Klea Dino – pjesëmarrëse në Festivalin e Këngës

Intervistë me këngëtaren turke Sevim Baki – pjesëmarrja në *Akordet e Kosovës*

E mërkurë, 22 tetor 2025
Moderim: Nora Fejza & Niki Cahani

Intervistë me këngëtaren Vjosa Shehu – pjesëmarrëse në Festivalin e Këngës

Intervistë me këngëtaren Vlera Kastrati – pjesëmarrëse në Festivalin e Këngës

Intervistë me kompozitorin Reshat Randobrava – festivali në përgjithësi

E enjte, 23 tetor 2025
Moderim: Nora Fejza & Niki Cahani

Intervistë me këngëtaren Nita Latifi – pjesëmarrëse në Festivalin e Këngës

Intervistë me këngëtarin Egzon Pireci – pjesëmarrës në Festivalin e Këngës

Intervistë me gazetarin e kulturës Fatmir Podrimaj – festivali në përgjithësi

Intervistë me këngëtarin Xuxi – pjesëmarrës në Festivalin e Këngës

E premte, 24 tetor 2025
Moderim: Nora Fejza & Niki Cahani

Intervistë me këngëtaren Elmedinë Ramushi – pjesëmarrëse në Festivalin e Këngës

Intervistë me këngëtaren Dea Berisha – pjesëmarrëse në Festivalin e Këngës

Intervistë me kompozitorin Xhevdet Gashi – festivali në përgjithësi

E hënë, 27 tetor 2025
Moderim: Nora Fejza & Niki Cahani

Intervistë me këngëtaren Teuta Halili – pjesëmarrëse në Festivalin e Këngës

Intervistë me kompozitoren Pranvera Badivuku – festivali në përgjithësi

E martë, 28 tetor 2025
Moderim: Nora Fejza & Niki Cahani

Intervistë me kompozitoren Selvete Krasniqi – festivali në përgjithësi

Intervistë me kitaristin Luan Sapunxhiu – festivali në përgjithësi

E mërkurë, 29 tetor 2025
Moderim: Nora Fejza & Niki Cahani

Intervistë me njohëset e artit dhe kulturës Ardianë Pajaziti dhe Ana Krasniqi – festivali në përgjithësi

Intervistë me këngëtaren Zergjina Hasanaj – pjesëmarrëse në Festivalin e Këngës

Intervistë me këngëtaren Kiara Juba – pjesëmarrëse në Festivalin e Këngës

E enjte, 30 tetor 2025
Moderim: Nora Fejza & Niki Cahani

Intervistë përmes WhatsApp-it nga Tirana me tenorin Kastriot Tusha

Intervistë me këngëtarin Besnik Krajku – *Akordet e Kosovës*

E premte, 31 tetor 2025
Moderim: Niki Cahani & Nora Meqa

Intervistë me kompozitorin Valton Beqiri – rëndësia e festivaleve

Intervistë me kompozitoren dhe redaktoren e muzikës Minire Fetahu

Intervistë përmes WhatsApp-it nga Zvicra me **Nora Fejza** – dy netët e festivalit *Shqip Up Comedy*

E hënë, 3 nëntor 2025
Moderim: Nora Fejza & Niki Cahani

Intervistë me **Albert Limani** – Eurovizion Kosova

Intervistë me kompozitorin **Ilir Berani** – pjesëmarrja në festivale / *Akorde*

Intervistë me këngëtarin **Kamuran Goranci** – pjesëmarrja në festivale / *Akorde*

E martë, 4 nëntor 2025
Moderim: Nora Fejza & Niki Cahani

Intervistë me fituesin e edicionit të kaluar **Endrit Krasniqi – Dhjetori**

Intervistë me këngëtarin arbëresh nga Italia **Santino De Bartolo** – pjesëmarrës në RTK FEST 3

E mërkurë, 5 nëntor 2025
Moderim: Besa Caka & Vjosa Husaj

Intervistë me këngëtaren Arnita Kastrati – ish-pjesëmarrëse në Festivalin e Këngës

Intervistë me këngëtaren Dea Strica – ish-pjesëmarrëse në Festivalin e Këngës

E enjte, 6 nëntor 2025
Moderim: Besa Caka & Niki Cahani

Intervistë me këngëtaren **Adelina Thaçi** – vlerat e festivalit dhe promovimi i të rinjve

Intervistë përmes WhatsApp-it nga Tirana me **Andri Xhahu**, gazetar në RTSH dhe anëtar i këshillit organizativ të Festivalit të Këngës në RTSH

E premte, 7 nëntor 2025
Moderim: Laura Kryeziu & Niki Cahani

Intervistë përmes WhatsApp-it me këngëtaren **Eliza Hoxha**

Intervistë përmes WhatsApp-it nga Finlanda me këngëtarin **Menan Kiseri**

RTK FEST 3 – Programi i Dytë

Periudha e transmetimit: 20–31 tetor 2025

Programi i dytë i RTK FEST 3 është realizuar në dy pjesë. Pjesa e parë (20–24 tetor) ka përfshirë prezantimin e këngëve të festivalit dhe ritransmetimin e intervistave nga edicioni i kaluar, të realizuara në prapaskenat e Radio Kosovës. Pjesa e dytë, e titulluar **"The Road to the Festival"**, është fokusuar në aspektet organizative, kreative dhe teknike të festivalit.

"The Road to the Festival" – Moderim

20–24 tetor 2025: Laura Kryeziu & Haki Kikaj

27–31 tetor 2025: Besa Caka & Vjosa Husaj

20–24 tetor 2025
Moderim: Laura Kryeziu & Haki Kikaj

E hënë, 20 tetor 2025

Intervistë me **Arian Mustafa**, regjisor televiziv i festivalit

E martë, 21 tetor 2025

Intervistë me **Rilind Gërvalla**, drejtor i Festivalit të Këngës në RTK (edicioni III)

E mërkurë, 22 tetor 2025

Intervistë me **Arta Avdiu**, producente ekzekutive e Festivalit të Këngës në RTK

E enjte, 23 tetor 2025

Intervistë me **Arsim Halili**, drejtor i Radio Kosovës

Intervistë me **Premtim Sermaxhaj**, themelues i radios së parë shqipe në Zvicër

E premte, 24 tetor 2025

Intervistë me skenografen **Zana Ramadani**

Intervistë me skenografen **Vesa Kraja**

27–31 tetor 2025

Moderim: Besa Caka & Vjosa Husaj

E hënë, 27 tetor 2025

Gentiana Begolli, koordinatore e Festivalit

E martë, 28 tetor 2025

Besim Mikullovci, krijues i brendimit dhe logos së festivalit

E mërkurë, 29 tetor 2025

Dukagjin Podrimaj dhe **Rina Krasniqi**, prezantues të festivalit

E enjte, 30 tetor 2025

Bashkim Tejeci, mjeshtër i filigranit (autor i Okarinës së Artë në *Akordet e Kosovës*)

Valdet Hoti, autor i Okarinës së Artë për trofeun e këtij edicioni

E premte, 31 tetor 2025

Prezantim i ekipit të Radio Kosovës që ka punuar në prapaskenat e festivalit:
Shpejtim Salihu, Driton Bunjaku, Fatos Preniqi, Valtona Kelmendi, Mentore Murati, Trendelinë Bucolli

Lidhje e drejtpërdrejtë nga Konferenca e Festivalit të Këngës – **Laura Kryeziu**

Pjesa e programit special gjatë tri netëve të Festivalit të III-të

Gjatë programit special të realizuar në tri netët e RTK FEST 3 janë zhvilluar gjithsej **10 intervista** (5 femra dhe 5 meshkuj), si dhe **10 paraqitje të drejtpërdrejta** të kolegeve nga prapaskena.
Pas përfundimit të festivalit, në kuadër të programit postfestival, janë realizuar edhe **6 intervista shtesë** (5 femra dhe 1 mashkull), pa përfshirë materialet e tjera përcjellëse audio-vizuale.

Raport i detajuar

Tri netët e Festivalit të Këngës në RTK
Moderim: Valentina Kryeziu & Lorik Sylejmani

E enjte, 6 nëntor 2025 – Nata e parë e Festivalit

Programi special (20:00–21:00)
Tema: *"Radioja – ura që promovon artistët dhe këngët përpara se t'i njohë publiku në skenë"*

Fokusi i diskutimit ishte roli i radios në promovimin e artistëve dhe muzikës shqiptare, si dhe rëndësia e përcjelljes së ngjarjeve të mëdha muzikore.

Intervista në studio:

Minire Fetahu, gazetare dhe redaktore shumëvjeçare e muzikës – rëndësia e përcjelljes së ngjarjeve të mëdha muzikore

Remzi Samakova, redaktor i muzikës në Radio Kosovë

Paraqitje live nga prapaskena:

Nora Meqa, lidhje e drejtpërdrejtë nga studio mobile, pak minuta para hapjes së festivalit

Komentim i drejtpërdrejtë i festivalit (21:00–23:20)
Paraqitje nga studio mobile në prapaskenë:

Valtona Kelmendi

Trëndelinë Bucolli

E premte, 7 nëntor 2025 – Nata e dytë e Festivalit

Programi special (20:00–21:00)

Intervista:

Kushtrim Jakupi, muzikolog dhe profesor universitar – prurjet e reja dhe tendencat muzikore të edicionit të tretë

Mentor Haziri, kantautor – përvoja në festivalet muzikore

Vjosa Husaj, paraqitje live pak para fillimit të festivalit

Komentim i drejtpërdrejtë i festivalit (21:00–23:20)
Paraqitje nga studio mobile në prapaskenë:

Besa Caka

Laura Kryeziu

Valtona Kelmendi

E shtunë, 8 nëntor 2025 – Nata e tretë e Festivalit

Intervista:

Beatrica Gjergji dhe **Kolë Laca** (*Shkodra Elektronike*) – intervistë ekskluzive

Aurela Gaçe – intervistë ekskluzive

Ilirjana Kuriu, *Trio Engjëjt* – pjesëmarrëse në *Akordet e Kosovës* (1988)

Arjana Grubi, *Trio Engjëjt*

Astrit Mustafa, drejtor i festivalit *"Kosovarja këndon"* – promovimi i talenteve të reja

Vjosa Husaj, paraqitje live pak para fillimit të festivalit

Komentim i drejtpërdrejtë i festivalit (21:00–23:00)
Paraqitje nga studio mobile në prapaskenë:

Trëndelinë Bucolli

Laura Kryeziu

RTK FEST 3 – Postfestivali

Data: E premte, 14 nëntor 2025
Ora: 11:00 – 13:30
Kanalet: Radio Kosova 1 dhe Radio Kosova 2
Moderim: Valentina Kryeziu & Haki Kikaj

Intervistat kryesore në studio dhe përmes lidhjeve të drejtpërdrejta:

Kristina Palokaj-Perkola, muzikologe (në studio)

Eriona Rushiti, kompozitore dhe tekstshkruese

Jeta Dida Bujari, anëtare e jurisë së festivalit (në studio)

Luljeta Bajcinovci, njohëse e të drejtave të autorit dhe pronësisë intelektuale (në studio)

Naim Bunjaku – Xuxi, garues në festival (në studio)

Arsi Bakon, fituese e edicionit të III-të të festivalit (përmes Vjosa Husaj)

Intervista me fituesit dhe mysafirët special:

Art Lokaj – fitues i Çmimit të Orkestrës

Teutë Halili – fituese e Çmimit të Penës së Argjendtë

Arjeta Palushaj – fituese e vendit të tretë në RTK FEST 3

Florent Abrashi – fitues i Çmimit të Dytë

Elvana Gjata

Altuna Sejdiu – Tuna

Dren Abazi

Në kuadër të postfestivalit janë ritransmetuar edhe intervistat ekskluzive me **Shkodra Elektronike** dhe **Aurela Gaçen**.

Menaxhimi dhe përzgjedhja e materialeve për transmetim janë realizuar nga **Nora Meqa** dhe **Vjosa Husaj**.

Të intervistuarit gjatë RTK FEST 3

1. Këngëtarët pjesëmarrës (në vendin e provave dhe prapaskenë)

Almir Kraba

Arjeta Palushaj

Arsi Bako

Art Lokaj

Bledi Kaso

Dea Berisha

Egzon Pireci

Elmedinë Ramushi

Florent Abrashi

Kiara Juba

Klea Dina

Laorjan Ejlli

Nita Latifi & Algert Sala

Santino de Bartolo

Semi Tafaj

Teutë Halili

Vlera Kastrati

Vjosa Shehu

Xuxi

Zergjina Hasanaj

---

2. Muzikantët, organizatorët dhe drejtuesit e festivalit

Alfred Kacinari – dirigjent i orkestrës

Gjergj Kacinari – pianist

Gentiana Begolli – koordinatore e RTK FEST 3

Lindita Isufi – dirigjente

Memli Kelmendi – dirigjent

Festim Fanaj – koncert-mjeshtër

Dardan Beqiri – nga Bordi i RTK-së

Florent Boshnjaku

Dukagjin Podrimaj

Rina Krasniqi

---

3. Të ftuarit specialë gjatë tri netëve të festivalit (intervistuar nga prapaskena)

Elvana Gjata

Altuna Sejdiu – Tuna

Dren Abazi

Hajrullah Ceku

Gjon Tears

Adelina Thaçi

Elton Deda

Gili

BBPoqi

Eneida Tarifa

etj.

Ekipi për realizimin e programit special të RTK FEST 3 – Radio Kosova

1. Pjesa e programit

Nimetullah Cahani

Nora Fejza

Valentina Kryeziu

Vjosa Husaj

Besa Çakaj

Nora Meqa

Laura Kryeziu

Valtona Kelmendi

Trendelinë Bucolli

Rrezarta Zekaj

Haki Kikaj

Lorik Sylejmani

2. Organizatorët

Fatos Preniqi

Edona Grantolli

3. Muzika

Hana Kelmendi

Remzi Samakova

4. Teknikë

Blerim Byqmenti

Shpejtim Salihu

Genc Berisha

Kreshnik Çarkagjiu

Fatlum Ahmedi

Driton Bunjaku

5. Drejtimi, organizimi dhe pjesa e postimeve në rrjete sociale

Arsim Halili, Drejtor i Radio Kosovës

Rrezarta Zekaj, Person i autorizuar nga Kryeredaktorja

Nora Meqa, Udhëheqëse Redaktore e programit të dytë

DEPARTAMENTI I PRODUKSIONIT DHE TEKNOLOGJISË

Ky raport paraqet një pasqyrë të përmbledhur të punëve dhe aktiviteteve kryesore të Departamentit të Produksionit dhe Teknologjisë gjatë vitit 2025, me theks të veçantë në fushat thelbësore si infrastruktura, teknologjia dhe zhvillimi i programeve në Radio Kosovë. Gjatë këtij viti, Departamenti i Produksionit dhe Teknologjisë ka dëshmuar një nivel të lartë përkushtimi ndaj inovacionit dhe përmirësimit të vazhdueshëm, përmes zhvillimit dhe zbatimit të zgjidhjeve bashkëkohore që kanë ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë së transmetimit dhe në forcimin e lidhjes me audiencën, e cila përgjatë gjithë vitit është reflektuar përmes indikatorëve të matshëm.

Pavarësisht kufizimeve buxhetore, përmes aplikimit të teknologjive të reja dhe investimeve strategjike në infrastrukturë, Radio Kosova ka arritur t'u përshtatet kërkesave dinamike të medias moderne, duke ofruar përmbajtje të pasur dhe cilësore për dëgjuesit e saj, si dhe duke dëshmuar një konkurrueshmëri të qëndrueshme në tregun mediatik. Në këtë proces, angazhimi dhe bashkëpunimi i stafit kanë qenë faktorë kyç në arritjen e suksesit të përgjithshëm institucional.

Në këtë kontekst, raporti synon të prezantojë aktivitetet kryesore, përparimet e realizuara, sfidat e evidentuara, si dhe vizionin për të ardhmen, me qëllim rritjen e mëtejshme të efikasitetit dhe cilësisë së punës në shërbim të audiencës sonë.

REALIZIMI I OBJEKTIVAVE

Gjatë vitit 2025, Radio Kosova ka shënuar rezultate të rëndësishme në realizimin e objektivave të saj, pavarësisht sfidave të konsiderueshme, si mungesa e stafit të kualifikuar dhe pamundësia për ndjekjen e trajnimeve adekuate. Falë një vizioni të qartë dhe udhëheqjes efektive të menaxhmentit të lartë, Departamenti i Produksionit ka arritur të tejkalojë pritshmëritë, duke përmbyllur me sukses projekte që më herët konsideroheshin vështirë të realizueshme.

Në sajë të përkushtimit të stafit ekzistues dhe orientimit të duhur profesional, janë realizuar objektivat kryesore, përfshirë:

- Planifikimin, specifikimin, instalimin dhe vënien në funksion të pajisjeve dhe sistemeve të reja teknologjike, çka ka sjellë përmirësime të ndjeshme në infrastrukturën teknike dhe në cilësinë e transmetimit;
- Përmbushjen e plotë të kërkesave programore, duke përfshirë realizimin e programeve Live, incizimin dhe editimin e raporteve, lajmeve, rubrikave, promovimeve, siglave, dokumentarëve, reportazheve, emisioneve dhe materialeve të tjera;
- Prodhimin e materialeve audiovizuale, si podcaste, emisione, rubrika dhe video të ndryshme, duke zgjeruar gamën e përmbajtjeve të ofruara për audiencën.

Viti 2025 përfaqëson gjithashtu një periudhë transformimi për Radio Kosovën, me avancime të rëndësishme në infrastrukturën teknologjike, të cilat e kanë pozicionuar radion në standarde më të larta cilësie dhe profesionalizmi.

Këto arritje dëshmojnë qartë se bashkimi i inovacionit, përkushtimit dhe udhëheqjes së mirë mund t'i shndërrojë edhe sfidat më të mëdha në mundësi zhvillimi. Radio Kosova vazhdon të mbetet shembull i profesionalizmit dhe përkushtimit në shërbim të audiencës së saj, ndaj veçohen këto arritje:

Renovimi i tri (3) studiove në Produksion

Hapësirat e Radio Kosovës, të cilat për një periudhë të gjatë kanë qenë të prekura nga mungesa e investimeve dhe infrastruktura e amortizuar, kanë paraqitur një pengesë të dukshme në përmbushjen e standardeve bashkëkohore mediatike. Me rritjen e kërkesës për produkte të reja, si video, podcaste dhe përmbajtje audiovizuale, u evidentua domosdoshmëria për një transformim të thellë të hapësirave ekzistuese.

Në këtë drejtim, gjatë vitit 2025 u ndërmorën masa konkrete për përmirësimin e infrastrukturës, duke u mbështetur kryesisht në profesionalizmin dhe përkushtimin e stafit të Departamentit të Produksionit dhe Teknologjisë, i cili realizoi edhe punë fizike të konsiderueshme, përfshirë:

- Demolimin e mureve ekzistuese;
- Montimin e paneleve të reja akustike;
- Renovimin e dyshemeve në të tri studiot e radios.

Ky angazhim pasqyron një nivel të lartë gatishmërie dhe aftësie profesionale, i cili meriton vlerësim dhe trajtim si vlerë e qëndrueshme institucionale.

Ky transformim përbën një shembull domethënës të bashkëpunimit dhe përkushtimit institucional, duke krijuar kushte të denja për prodhimin e përmbajtjeve moderne audiovizuale. Rezultatet e arritura janë dëshmi e qartë e rolit dhe rëndësisë së stafit si shtylla kryesore e zhvillimit të vazhdueshëm të Radio Kosovës.

Aktivitetet dhe punimet për përmirësimin e infrastrukturës dhe transmetimit

Janë realizuar vizita të rregullta pune në të gjitha pikat transmetuese në Golesh,Zatriq, Cernushe, Maja e Gjelber dhe Vneshta, me qëllim mirëmbajtjen e transmetuesve, duke përfshirë pastrimin e ventilatorëve dhe hapësirës së kontejnereve.

Janë dizajnuar dhe integruar asete shtesë konfigurimi në miksetat dixhitale, të cilat mundësojnë një nivel më të lartë ndërveprimi dhe cilësie gjatë transmetimeve live.

Gjatë këtij Viti jemi furnizuar me dy **mbajtës mikrofonash dhe një sistem wireless mikrofonash** (të siguruar përmes marrëveshjes me aeroportin e Prishtinës).

Gjithashtu, sipas kontratës me kompensim, jemi furnizuar me **tre iPhone 16 Pro** dhe **pesë televizorë smart,** të cilët janë vendosur në hapësirat e produksionit për promovimin e logos, siglave dhe emisioneve të radios.

Që nga data 11.09.2025 është finalizuar linja me sukses përmes internetit duke përdorur platformën ***Cleanfeed*** për emisionin ***Pa kufij.*** Kjo linjë ofron cilësi shumë të lartë audioje, duke mundësuar lidhjen e pandërprerë ndërmjet tri radiove: *Radio Tirana, Radio Shkupi dhe Radio Kosova.*

Falë kësaj zgjidhjeje, janë eliminuar shpenzimet telefonike ISDN që vetëm për këtë emision kapnin shumën reth 200 euro në muaj, ndërsa prej tani ky komunikim përveç që ofron kualitet të studios realizohet me kosto zero.

Tërë konfigurimin dhe menaxhimin për të tri studiot e realizon ekipi i produksionit të Radio Kosovës.

Festivali i Këngës në RTK

Ekipi i produksionit ka qenë plotësisht i gatshëm dhe u është përgjigjur të gjitha kërkesave programore. Gjatë një muaji rresht janë ndjekur provat, duke u krijuar përmbajtje video nga hapësirat e festivalit si dhe intervista të shumta me të gjithë pjesëmarrësit.

Në hapësirat e **Pallatit të Rinisë**, ku është mbajtur festivali, janë vendosur pajisjet për transmetim direkt, si dhe një baner me logon e festivalit dhe një tjetër me logon e **RTK-Radios**.

Gjatë **tre netëve finale**, festivali i këngës është transmetuar në **të dy kanalet** e RTK-së, bashkë me prapaskenat nga **studioja mobile**.

Janë realizuar **video-incizime në backstage**, të cilat janë edituar dhe publikuar në rrjetet sociale në kohë reale nga studioja mobile.

Është kryer servisimi i logos LED të RTK-së e vendosur në oborrin e radios.

Njësia e Siglave dhe Promove në kuadër të Departamentit tëProduksionit dhe Teknologjisëka realizuar të gjitha promocionet e kërkuara dhe ka vazhduar angazhimin në punët e përditshme të produksionit. Janë përgatitur Jingla të reja, Promo, konkurse,Intro, tranzicione dhe Outro me qëllim tëdinamizimit të mëtejmë tëpërmbajtjes programore.

Materiale të arkivuara nga Njësia e Arkivit

	Arkivi 2025												
Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
Edicione te Lajmeve	98	100	100	112	110	98	104	106	104	104	100	92	1228
Emisione/Programe	40	59	39	41	36	31	30	11	46	51	43	45	472
Kronika Zgjedhore/Round Up	38	24				-			32	26	12	14	146
Intervista	20	26	8	13	11	7	11	13	9	24	19	4	165
Reportazhe/Dokumentare	4	11	5	5	6	4	4	2	4	2	4	3	54
Konferenca		16		-		-	1	1	1	8	4	0	31
Te tjera		7	3	9	17	3		3	4	12	8	22	88
Gjithsej	200	243	155	180	180	143	150	136	200	227	190	180	2184

PLANIFIKIMI DHE SFIDAT PËR TË ARDHMEN

Gjatë vitit 2025, Departamenti i Produksionit në Radio Kosovë është përballur me sfida të shumta teknike dhe infrastrukturore, që kanë kërkuar ndërhyrje dhe optimizim të vazhdueshëm, përkundër mungesës së stafit profesional. Ky angazhim ka qenë i nevojshëm për të ruajtur standardet e cilësisë së transmetimit dhe për të siguruar operacione të pandërprera.

Për vitin 2026, planet përfshijnë vazhdimin e përmirësimeve në cilësinë e transmetimit, zhvillimin e programeve të reja dhe angazhimin për instalimin e pajisjeve të avancuara si: skenografi për podcaste, pajisje teknologjike te avansuara per audio dhe video produksion, pajisje për performanca muzikore, pajisje për terren audio/video, dhe teknologji të tjera të nevojshme të cilat janë të planifikuara edhe me dokumetin e projeksionit buxhetor për vitin 2026.

Një nevojë imediate mbetet rekrutimi i stafit teknik dhe profesional për pozitat : Video montazher (2) dhe Teknik zëri (6) përmes procedurave konkurruese, në mënyrë që të realizohen dhe avancohen objektivat e Radio Kosovës. Ky hap është i domosdoshëm për të siguruar vazhdimësinë e zhvillimit dhe për të qenë në pajtueshmëri me kërkesat ligjore të cilat janë garancë për të drejtat e punonjësve, siç është sigurimi I punës në oraret me ndërrime, realizimi I pushimeve të parapara me ligj, aktet e brendshme dhe kontratat e punës.

SEKTORI I LOGJISTIKËS

Kilometrat dhe litrat në njësin e Autoparkut në RTK-Radio

Pasqyra e shpenzimeve për çdo veturë nga data: 01.01.2025 deri 31.12.2025

Lista e Veturave të RTK-së- Radio Kosova						
	Nr.Tabeles	Tipi i makinës	KM paraprake	KM e tanishme	KM për 2025	Derivate për 2025
1	01-502-BA	Opel Antara	263278	267519	4241	464.75

2	01-459-NA	Peugeot	100648	120477	19829	1028.53
3	01-699-EP	Opel Antara	246564	249354	2790	277.05
				TOTALI	26860	1770.33
				Mesatarja vjetore	6.59 litër për 100 Km	

Tabela e detajuar e shpenzimeve:

2025	Shpenzimet	Litrazhi	Mesatarja në €
Janar	169.94 €	131.43	1.29 €
Shkurt	244.71 €	183.99	1.33 €
Mars	176.46 €	132.67	1.28 €
Prill	183.13 €	144.52	1.26 €
Maj	200.95 €	164.71	1.22 €
Qershor	201.93 €	163.67	1.23 €
Korrik	216.49 €	165.81	1.30 €
Gusht	77.42 €	60.75	1.27 €
Shtator	207.99 €	165.06	1.26 €
Tetor	151.96 €	121.53	1.24 €
Nentor	213.92 €	165.52	1.29 €
Dhjetor	219.21 €	170.67	1.28 €
Totali	**2,264.11 €**	**1770.33**	

Shpenzimet për kontratat komunale për 2025:

2025	Ujesjellesi	Termokos	Pastrimi
Janar	€ 3.87	€ 1,640.86	€ 144.00
Shkurt	€ 5.57	€ 1,977.38	€ 144.00
Mars	€ 23.49	€ 1,367.93	€ 144.00
Prill	€ 9.84	€ 1,473.55	€ 144.00

Maj	€ 15.81		€ 144.00
Qershor	€ 19.22		€ 144.00
Korrik	€ 128.43		€ 144.00
Gusht	€ 4.72		€ 144.00
Shtator	€ 14.95		€ 144.00
Tetor	€ 3.01	€ 1,721.11	€ 144.00
Nentor	€ 6.43	€ 2,268.48	€ 144.00
Dhjetor	€ 29.47	€ 3,291.84	€ 144.00
Totali	**€ 264.81**	**€ 13,741.15**	**€ 1,728.00**

5. SHËRBIMI I ADMINISTRATËS DHE BURIMEVE NJERËZORE

Shërbimi i ABNJ-së ne Radiotelevizionin e Kosovës luan një rol kritik në sigurimin e menaxhimit efektiv të kapitalit njerëzor, shërbimeve administrative dhe pajtueshmërisë institucionale me ligjet dhe rregulloret e brendshme në fuqi.

Gjatë vitit 2025, Shërbimi u përqendrua në forcimin e efikasitetit administrativ, përmirësimin e praktikave të menaxhimit të burimeve njerëzore, mbështetjen e proceseve institucionale dhe sigurimin e administrimit transparent dhe profesional të personelit. Shërbimi i ABNJ-së vazhdoi të mbështesë misionin strategjik të RTK-së duke siguruar që punonjësit të menaxhohen në përputhje me politikat institucionale, legjislacionin e punës dhe praktikat më të mira në administrimin e burimeve njerëzore.

OBJEKTIVAT KRYESORE PËR VITIN 2025

- Forcimi i sistemeve dhe procedurave të menaxhimit të burimeve njerëzore;
- Sigurimi i pajtueshmërisë me legjislacionin e punës dhe rregulloret e brendshme;
- Përmirësimi i menaxhimit dhe dokumentimit të të dhënave të personelit;
- Rritja e efikasitetit administrativ brenda RTK-së;
- Mbështetja e menaxhmentit institucional dhe koordinimit të brendshëm

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË KRYESORE TË PËRMBUSHURA

Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

Në aspektin e menaxhimit të burimeve njerëzore, Shërbimi i ABNJ-së ka kryer detyrat dhe përgjegjësitë në vijim:

- Administrimin dhe mirëmbajtjen e dosjeve dhe të dhënave të personelit të punonjësve;
- Skanimin e dosjeve personale/të dhënave të personelit të punonjësve;
- Përgatitjen dhe publikimin e konkurseve te brendshme dhe te jashtme, duke përfshirë edhe Pakon e Bordit;
- Koordinimin e procedurave të rekrutimit; Verifikimin dhe vlerësimin e dokumentacionit të kandidatëve; Mbështetjen administrative për komisionet e përzgjedhjes;
- Përgatitjen dhe menaxhimin e dokumentacionit të emërimit dhe punësimit, procedurat e rinovimit te kontratave të punësimit;
- Mbajtjen e evidencës për afatet e kontratave, periudhën provuese, komunikimi/korrespodenca me eprorët;
- Në baza mujore:
- mbledhjen e konfirmimeve të pagave lidhur me angazhimin shtesë të të punësuarve dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm ne baza mujore;
- mbledhjen e Formularëve për orët shtesë – për orët e realizuara të natës, në fund javës, festat dhe jashtë orarit; ka bërë verifikimin e saktësisë dhe përputhshmërisë me evidencën e pranisë në punë, pushimet, shujtat, korigjimet e ndryshme etj,
- mbledhjen e të gjitha llojeve të dokumenteve/evidencës në lidhje me pagat mujore;
- kontrollimin e miratimeve dhe nënshkrimeve përkatëse për kalkulimin, evidentimin dhe ekzekutimin e pagave mujore.

- Mirëmbajtjen e bazës së të dhënave të punonjësve dhe sistemin e dokumentimit të Burimeve Njerëzore;
- Menaxhimin e pushimeve të punonjësve (vjetore, mjekësore etj);
- Monitorimin e vijueshmërisë së stafit dhe orarit të punës;
- Administrimin e procesit të vlerësimit të stafit/bisedat vjetore;
- Përgatitjen e vendimeve administrative të Burimeve Njerëzore dhe dokumentacionit zyrtar;
- Përpilimin e listave dhe raporteve të rregullta në lidhje me çështje të ndryshme të ABNJ-së sipas kërkesave/nevojës së Menaxhmentit të RTK-së;
- Përpunimin e ndryshimeve të statusit të punonjësve;
- Procesimin e (24) ndihmave solidare;
- Procesimin e kërkesave për dokumentacion (22), pas Ankesave të deponuara nga të punësuarit dhe/apo ish të punësuarit nga Inspektoratin Qendror të Punës.
- Administrimin e procedurave te brendshme disiplinore;
- Ofrimin e udhëzimeve në lidhje me Burimet Njerëzore për menaxhmentin dhe departamentet e RTK-së;
- Këshillimet dhe zgjidhja e kërkesave apo çështjeve të ndryshme të stafit, me të punësuarit dhe me eprorët;
- Përgatitjen dhe menaxhimin e dokumentacionit të përfundimit të marrëdhënies së punës nga të punësuarit apo RTK, dorëheqjeve, pensionimit etj;
- Monitorimin e pajtueshmërisë me rregulloret dhe politikat e brendshme dhe Ligjin e Punës;
- Mbështetje administrative për të siguruar lehtesimin e operimit te aktiviteteve te punes.

Menaxhimi i Shërbimeve administrative

Në aspektin e menaxhimit të cështjeve administrative për të mbështetur operacionet e përditshme të RTK-së, Shërbimi i ABNJ-së ka kryer detyrat dhe përgjegjësitë në vijim:

- Koordinimin e proceseve të brendshme administrative;
- Menaxhimin e korrespondencës zyrtare dhe rrjedhës së dokumentacionit – Protokollimi;
- Menaxhimi i librave te Protokollit – fizik dhe elektronik;
- Menaxhimi i Protokollit të faturave;
- Mirëmbajtjen e dokumentacionit fizik/regjistratorët vjetorë dhe të përhershëm;
- Qarkullimi i dokumentacionit brenda dhe jashtë institucionit;
- Baza e të dhënave të kontratave dhe marrëveshjeve institucionale;
- Mbështetjen e menaxhmentit të RTK-së dhe departamenteve në çështjet administrative;
